

VJETARI 2016

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

YEAR-BOOK 2016

37



PRISHTINA
2016

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

VJETARI 2016

37



Redaktor

Isuf Krasniqi

Sekretar shkencor
i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRBËRJA E AKADEMISË

A. KRYESIA	7
B. ANËTARËT E AKADEMISË	7
I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	7
II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	7
III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	7
IV. SEKSIONI I ARTEVE	8
V. ANËTARËT IN MEMORIAM	8
VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS	9
VII. ANËTARËT E JASHTËM	9
VIII. ANËTARË NDERI	9
C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE DHE TEKNIKE	10
RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2016	11
I. KUVENDI	13
II. KRYESIA	19
III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË	42
IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE	45
V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS	48
VI. SEKSIONI I ARTEVE	51
VII. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE E TEKNIKE	52
PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2017	63
PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS	85
KRONIKË - 2016	103

A. KRYESIA

Akademik **Hivzi Islami**, kryetar,
Akademik **Ali Aliu**, nënkryetar,
Akademik **Isuf Krasniqi**, sekretar i përgjithshëm,
Akademik **Eqrem Basha**, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
Anëtar korrespondent **Jusuf Bajraktari**, sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore,
Akademik **Fejzullah Krasniqi**, sekretar i Seksionit të Shkencave të Natyrës,
Anëtar korrespondent **Luan Mulliqi**, sekretar i Seksionit të Arteve.

B. ANËTARËT E AKADEMISË

I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

a) *Anëtarët e rregullt (akademikë):*

Ali Aliu (1934), i zgjedhur më 2000,
Eqrem Basha (1948), i zgjedhur më 2004,
Idriz Ajeti (1917), i zgjedhur më 1975,
Mehmet Kraja (1952), i zgjedhur më 2008,
Rexhep Ismajli (1947), i zgjedhur më 1996,
Rexhep Qosja (1936), i zgjedhur më 1975,
Sabri Hamiti (1950), i zgjedhur më 2008.

b) *Anëtarët korrespondentë:*

Mehmet Halimi (1937), i zgjedhur më 2012,
Zejnullah Rrahmani (1952), i zgjedhur më 2012.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

a) *Anëtarët e rregullt (akademikë):*

Ekrem Murtezai (1931), i zgjedhur më 2000,
Hivzi Islami (1946), i zgjedhur më 2000,
Isa Mustafa (1951), i zgjedhur më 2012.

b) *Anëtarët korrespondentë:*

Arsim Bajrami (1960), i zgjedhur më 2012,
Anton K. Berishaj (1954), i zgjedhur më 2012,
Edi Shukriu (1950), e zgjedhur më 2012,
Jusuf Bajraktari (1948), i zgjedhur më 2012.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

a) *Anëtarët e rregullt (akademikë):*

Feriz Krasniqi (1931), i zgjedhur më 2000,
Minir Dushi (1929), i zgjedhur më 1979,
Nexhat Daci (1944), i zgjedhur më 1996,

Fejzullah Krasniqi (1953), i zgjedhur më 2012,

Isuf Krasniqi (1948), i zgjedhur më 2012.

b) Anëtarët korrespondentë:

Arsim Morina (1956), i zgjedhur më 2012,

Qamil Haxhibeqiri (1949), i zgjedhur më 2012,

Salih Gashi (1944), i zgjedhur më 2012.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Rauf Dhomi (1945), i zgjedhur më 1996,

Rexhep Ferri (1937), i zgjedhur më 2000,

Tahir Emra (1938), i zgjedhur më 2008,

Zeqirja Ballata (1943), i zgjedhur më 2000.

b) Anëtarët korrespondentë:

Luan Mulliqi (1953), i zgjedhur më 2012,

Xhevdet Xhafa (1934), i zgjedhur më 2012.

V. ANËTARËT IN MEMORIAM

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Agim Çavdërbasha,

Ali Hadri,

Ali Podrimja,

Besim Bokshi

Dervish Rozhaja,

Engjëll Berisha,

Esat Stavileci,

Enver Gjerqeku,

Esad Mekuli,

Fehmi Agani,

Gazmend Zajmi,

Jashar Rexhepagiq,

Latif Susuri,

Mark Krasniqi,

Muharrem Berisha,

Musa Haxhiu,

Muslim Mulliqi,

Osman Imami,

Pajazit Nushi,

Remzi Bakalli,

Syrja Popovci,

Vladeta Vukoviq,

Vukasin Filipoviq.

b) Anëtarët korrespondentë:

Anton Pashku,
Eshref Ademaj,
Hajredin Hoxha,
Ibrahim Rugova,
Ruzhdi Pllana.

VI. ANËTARËT JASHTË TRUPIT TË PËRHERSHËM TË PUNËS

a) Anëtarët e rregullt (akademikë):

Sinan Hasani (letërsi), Serbi, i zgjedhur më 1986.

b) Anëtarët korrespondentë:

Zef Mirdita (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1991.

VII. ANËTARËT E JASHTËM

Aleksandar Stipçeviq (histori), Kroaci, i zgjedhur më 1983,

Ismail Kadare (letërsi), Shqipëri, i zgjedhur më 1991,

Wilfried Fiedler (gjuhësi), Gjermani, i zgjedhur më 1991,

Eric Hamp (gjuhësi), i zgjedhur më 1991,

Shaban Demiraj (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 1996,

Gunnar Svane (gjuhësi), Danimarkë, i zgjedhur më 1996,

Kristian Gyt (histori e kulturës), Francë, i zgjedhur më 1996,

Gjelosh Gjokaj (art figurativ), Gjermani, i zgjedhur më 1996,

Leonard Newmark (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2000,

Robert Elsie (letërsi), Kanada, i zgjedhur më 2000,

Michel Roux (gjeografi, gjeopolitikë), Francë, i zgjedhur më 2000,

Muhamedin Kullashi (filozofi), Francë, i zgjedhur më 2000,

Tomë Berisha (elektroteknikë), Kroaci, i zgjedhur më 2000,

Noel Malcolm (histori), Angli, i zgjedhur më 2004,

Victor Friedman (gjuhësi), SHBA, i zgjedhur më 2004,

Emin Riza (arkitekturë), Shqipëri, i zgjedhur më 2008,

Françesko Altimari (gjuhësi), Itali, i zgjedhur më 2008,

Muhamet Mufaku (histori), Jordan, i zgjedhur më 2008,

Alajdin Abazi (elektroteknikë), Maqedoni, i zgjedhur më 2012,

Kolec Topalli (gjuhësi), Shqipëri, i zgjedhur më 2012,

Oliver Schmit (histori), Austri, i zgjedhur më 2012,

Radoslav Katicic (gjuhësi), Kroaci, i zgjedhur më 2012.

VIII. ANËTARË NDERI

Ferid Murati, nobelist, jeton në SHBA, i zgjedhur më 2000.

C. SHËRBIMET ADMINISTRATIVE, PROFESIONALE**E TEKNIKE**

Lendita Juniku-PULA, Sekretare e Akademisë

Ali CAKA, Drejtor i Departamentit të Përkrahjes Profesionale dhe Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve

Hilmi ZOGJANI, u.d. i drejtorit të Departamentit të Bibliotekës dhe Arkivit

Vjollca HYKOLLI, Drejtor i Departamentit të Buxhetit dhe Financave

Furtuna NAKA, Udhëheqëse e Prokurimit

Taulant VESELI, Administrator i lartë i sistemeve të TIK-ut

Burim REXHEPI, Zyrtar i lartë i redaktimit teknik

Hasime MALIQI, Zyrtar certifikues

Rron BARAKU, Zyrtar i lartë i TI-së për përkrahje

Rejhane ISLAMI, Zyrtar i Bibliotekës dhe këmbimit

Lirijeta BUNJAKU, Zyrtar i lartë i buxhetit dhe financave

Xhemshit BRAJSHORI, Zyrtar i lartë i komunikimit dhe Përkthyes

Dafina KAVAJA, Asistente ekzekutive

Lidije KELMENDI, Zyrtar i librarisë

Bedri PLLANA, Zyrtar bibliotekar

Avdi GASHI, Zyrtar i logjistikës

Alban BYTYÇI, Vozitës-korrier

Valbona OLLURI, Zyrtar teknik

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2016



I. KUVENDI

Organi më i lartë i qeverisjes - Kuvendi i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vitin 2016 është mbledhur katër herë. Për herë të parë më 16 shkurt (Mbledhja LXXXVII), për herë të dytë më 11 maj (Mbledhja LXXXVIII), për herë të tretë më 30 qershor (Mbledhja LXXXIX) dhe për herë të katërt më 21 dhjetor (Mbledhja XC).

I. Në mbledhjen e parë të këtij viti (Mbledhja LXXXVII), si zakonisht, përveç miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, u shqyrtuan edhe pikat: Raporti mbi punën e Akademisë për vitin 2015; Raporti financiar i Akademisë për vitin 2015 dhe Çështje vijuese.

Mbledhjen e hapi Kryetari Islami, i cili bëri një vështrim të punës së Akademisë për vitin 2016. Fjala e kryetarit është pasqyruar në procesverbalin e mbledhjes së Kuvendit.

Pas fjalës së Kryetarit filloi shqyrtimi i pikave të rendit të ditës.

Kuvendi shqyrtoi Raportin e punës së ASHAK për vitin 2015, me radhë sipas seksioneve. Kryetari Islami tha se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet me kohë dhe i kanë miratuar raportet e tyre. Raporti i kompletuar është shqyrtuar më pas nga Kryesia e Akademisë dhe miratimi përfundimtar i mbetet sot Kuvendit.

Gjatë shqyrtimit të Raportit të Seksionit të Shkencave Natyrore N. Daci në diskutimin e tij shprehu shqetësim lidhur me botimin e revistës Kërkime. Ai tha se nuk ka prurje të

materialeve për revistë dhe vërehet një zbehje e interesimit për të botuar, meqë punimet e botuara në këtë revistë nuk vlerësohen për zgjedhje të stafit akademik në Universitet. R. Ismajli në diskutimin e tij tha se për revista është e nevojshme të merret ISSN-ja. Ai tha se duhet drejtuar Qeverisë dhe dy ministrive përkatëse MASHT dhe MKRS që të ndërmarrin veprimet e nevojshme, ashtu që revistat që botohen në Kosovë të kenë mundësi të marrin ISSN-në.

Pas diskutimeve Kuvendi miratoi Raportin e punës për vitin 2015, i cili do të botohet në Vjetari 2015.

Më pas u shqyrtua edhe Raporti financiar i Akademisë për vitin 2015, i cili u miratua pa vërejtje. Edhe Raporti financiar do të botohet në Vjetari 2015.

II. Në mbledhjen e dytë (LXXXVIII), pas miratimit të Procesverbalit, Kryetari Islami njoftoi Kuvendin se Kryesia e Akademisë në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2016 ka ngritur Grupin punues në përbërje prej: Lendita Pula, sekretare e Akademisë, akademik Isuf Krasniqi, anëtar korrëspondent Arsim Bajrami dhe Ali Caka, drejtor i DPPTIK. Grupi ka punuar në përbërje të plotë, ka mbajtur takimet e rregullta dhe ka hartuar draftin e parë të Statutit të Akademisë dhe të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë. Të dy draftet janë shqyrtuar në mbledhjen e rregullt të Kryesisë mbajtur më 3 mars 2016 dhe më pas u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë. Ai më pas ftoi sekretaren e

Akademisë të njoftojë Kuvendin me rrjedhën e punës së Grupit punues.

L. Pula në fjalën e saj njoftoi se pas ngritjes së Grupit punues për hartimin e Statutit dhe të Rregullores, ka filluar menjëherë puna në hartimin e të dy drafteve. Pas hartimit draftet e para bashkë me Ligjin për ASHAK u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë. Nga 30 anëtarë të Akademisë vërejtje dhe sugjerime me shkrim rreth Statutit kanë paraqitur 9 anëtarë, 6 prej tyre kanë paraqitur vërejtje dhe sugjerime përmbajtjesore, ndërsa tre të tjerë kanë paraqitur vetëm vërejtje për çështje teknike.

Pas mbledhjeve të seksioneve Grupi punues është mbledhur dhe i ka shqyrtuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e pranuar, si dhe gjatë punës i ka shqyrtuar edhe vërejtjet dhe sugjerimet që janë diskutuar nëpër seksione dhe të cilat janë paraqitur në procesverbalet e mbledhjeve të seksioneve. Shumica e tyre janë marrë parasysh dhe janë inkuorporuar në draftet të cilat do të shqyrtohen sot dhe të cilat janë ndarë me kohë. Disa vërejtje dhe sugjerime nuk janë inkuorporuar, meqë ato bien ndesh me Ligjin për ASHAK. Grupi punues e ka njoftuar Kryesinë e Akademisë me ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe të Rregullores dhe Kryesia është pajtuar.

Në fund, në emër të grupit, ajo i falënderoi të gjithë për bashkëpunim!

Në vazhdim Kryetari Islami, në bazë të evidencës së Shërbimit Profesional Administrativ të ASHAK-ut, njoftoi se në sallë janë të pranishëm 27 anëtarë të

Akademisë, kuorum ka dhe se mbledhja mund të vazhdojë. Ai vazhdoi duke thënë se: "dokumentet miratohen me 2/3 e gjithë trupit votues, që do të thotë se për vendimmarrje duhen 19 vota. Në rast të votimit të neneve apo paragrafëve të diskutueshëm, në votim së pari del versioni i Grupit punues. Statuti nuk është i përhershëm, sepse nenet dhe dispozitat e caktuara mund të ndryshohen e plotësohen kur të mendojë Kuvendi se duhet bërë, gjë që nuk është rasti me Ligjin, sepse atë e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dhe e dyta, çështjet që nuk rregullohen me këtë Statut përcaktohen me rregulloret e veçanta të Akademisë (neni 1, paragrafi 2 i Statutit)". Ai propozoi që shqyrtimi i të dy dokumenteve, Statutit dhe Rregullores, të bëhet nen për nen, duke u ndalur vetëm në nenet ku ka vërejtje dhe sugjerime. Kuvendi e pranoi këtë qasje të punës të propozuar nga Kryetari dhe vazhdoi punën.

Diskutuan M. Kraja, N. Daci, M. Dushi, Fejzullah Krasniqi, S. Hamiti, L. Mulliqi, Z. Ballata. Diskutimet u bënë për nenet: 25, 26, 27, 31, 32 dhe 41.

U propozua që:

- Neni 27, paragrafi 2, të bartet te neni 25 dhe të plotësohet: "Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Akademisë pezullohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë për kohën, mbi një vit, që ai nuk jeton dhe nuk vepron në Kosovë";

- Neni 27, nënparagrafi 1.3 të shtohet: "Me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë";

- Neni 31, nën paragrafët 5.1 dhe 5.3, të riformulohen:

5.1. “Anëtarëve të Akademisë që ushtrojnë funksione udhëheqëse ditën që mbushin moshën 75 vjeç u ndërpritet ushtrimi i funksionit udhëheqës”;

5.3. “Anëtarët e Akademisë që zgjidhen në vende udhëheqëse nëpërmjet procedurës së zëvendësimit, në rastet e skadimit të mandatit sipas nënparagrafit 5.1. të këtij neni, ushtrojnë mandatin e mbetur deri në zgjedhjet e reja sipas nënparagrafit 5.2 të këtij neni”;

- Neni 32, nënparagrafi 1.16 të hiqet “akte normative”;

- Neni 41, paragrafi 2 të riformulohet:

“Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë i kryejnë funksionet në të cilat janë zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij statuti, deri më kalimin e mandatit”.

Propozimi i L. Mulliqit për plotësimin e nenit 40 me shënimin që: “mjetet financiare të Akademisë t’u ndahen seksioneve në mënyrë të barabartë” u tha se nuk mund të pranohet, meqë bie ndesh me Ligjin për Akademinë, ndërsa propozimi i Fejzullah Krasniqit që neni 40, paragrafi 2 të plotësohet dhe të përshtatet me paragrafin 3, të nenit 5, u tha se duhet të shikohet përshtatja me Ligjin për ASHAK.

Kuvendi me 26 vota për dhe një kundër miratoi Statutin e Akademisë me plotësim, sipas propozimeve që u dhanë.

Pas miratimit të Statutit, Kuvendi filloi shqyrtimin nen për nen të

Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Lidhur me Rregulloren M. Kraja dha disa vërejtje dhe sugjerime të cilat u pranuan. Kuvendi me 26 vota për dhe një kundër miratoi Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Pas miratimit të Statutit dhe të Rregullores kryetari Islami falënderoi të gjithë anëtarët e Akademisë për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë.

Pas fjalës së Kryetarit, fjalën e kërkoi M. Dushi.

Ai në diskutimin e tij tha se dëshiron edhe një herë të debatojë për botimin e librit “Klima e Kosovës”, me autor Ruzhdi Pllana, tani më i ndjerë. Ai tha se është i hidhëruar meqë nuk i është lejuar që në libër të figurojë një paragraf të cilin ai vetë e ka shkruar.

Me këtë rast ndërhyri Kryetari Islami duke thënë se është në dijeni për rastin, por se kjo çështje nuk është në rend të ditës së mbledhjes së sotme të Kuvendit. Ai tha se çështja e botimit në fjalë është shqyrtuar në Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe se kjo temë konsiderohet e mbyllur, prandaj sot në këtë seancë nuk ka vend për këtë lloj diskutimi. Ai e shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit.

III. Në mbledhjen e tretë (LXXXIX) Para miratimit të procesverbalit të mbledhjes pararendëse, M. Dushi dha disa vërejtje për plotësimin e procesverbalit. Ai tha se pika e fundit: Çështje vijuese, nuk figuron në procesverbal dhe më pas paraqiti vërejtjet e tij duke

thënë se në procesverbal nuk është pasqyruar e gjithë fjala e tij, fjala e Kryetarit dhe rrjedha e diskutimit. Pas fjalës së M. Dushit, Kryetari Islami kërkoi nga Sekretarja e Akademisë, si procesmbajtëse, të ofrojë sqarimet e nevojshme.

Sekretarja e Akademisë tha se pika: Çështje vijuese nuk është përfshirë në procesverbal, meqë diskutimi i akademik Dushit ka pasuar menjëherë pas miratimit të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, pa kaluar fare te pika e fundit e rendit të ditës. Ndërsa sa i përket çështjes së mos përfshirjes së diskutimeve në procesverbal ajo tha se është munduar të përfshijë aq sa ka pasur mundësi kohore, meqë çdo gjë rreth diskutimit ka rrjedhur shpejtë. Sekretarja më pas tha se në raste të tilla, kur ka diskutime më të gjata, është praktikë që diskutuesit t'i sjellin ato me shkrim në administratë, ashtu që tekstet të futen në thonjëza, por nga Kuvendi i kaluar edhe pse ka pasur kohë, ajo tha se nuk ka marrë asgjë me shkrim as nga akademik Dushi dhe as nga Kryetari i Akademisë.

Pas sqarimit të Sekretares u hap diskutimi. Diskutuan N. Daci, R. Ismajli, S. Hamiti. Në diskutimet e tyre ata propozuan që kjo çështje të mbyllet dhe të kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës. Propozimi u përkrah edhe nga anëtarët e tjerë të Akademisë dhe procesverbali u miratua pa plotësime, ashtu siç është dorëzuar me materialet e Kuvendit. U tha se në të ardhmen, kur ka raste të tilla, shkresat të depohen në administratë dhe ato të

futen në procesverbale ashtu siç janë në origjinal.

Më pas Kryetari Islami para fillimit të shqyrtimit të Programit të punës së ASHAK për vitin 2017, tha se Programi i punës për vitin 2017 është shqyrtuar fillimisht në mbledhjet e seksioneve përkatëse të Akademisë dhe më pas edhe në Kryesinë e saj. Ai shtoi se Programi i punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (SGJL) dhe Programi i punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore (SSSH) është mjaft i pasur, ndërsa shtoi se Programi i Seksionit të Shkencave të Natyrës (SSHN) dhe Programi i Seksionit të Arteve (SA) kanë mundësi të jenë më të pasur. Ai sugjeroi sekretarët e këtyre dy seksioneve (SSHN dhe SA) që të bëjnë përpjekje dhe të punojnë edhe në drejtim të organizmit të tubimeve shkencore: konferencave, tryezave e aktiviteteve të tjera. Kryetari apeloj te sekretarët e seksioneve që t'i përcjellin afatet dhe të fillojnë me kohë punën për përgatitjen e programeve të punës. Ai shtoi se secili sekretar duhet t'i dijë detyrat e veta dhe duhet t'i kryejë ato me përgjegjësi dhe në kohë.

Më pas filloi shqyrtimi i Programit të punës së ASHAK me rend sipas seksioneve.

Gjatë shqyrtimit të Programit të punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, R. Ismajli dha disa sqarime për Qendrën për Leksikografi dhe Enciklopedi. Ai tha se pas përfundimit të vizitës studimore në Akademinë Austriake të Shkencave në Vjenë ka përgatitur një raport për vënien në

veprim të Qendrës për Leksikografi dhe Enciklopedi. Raporti në formë aneksi është pjesë e Programit të punës së SGJL. Ai propozoi që të bëhet një ndryshim, ashtu që të fshihet fjala Enciklopedi dhe të mbetet vetëm emërtimi Qendra për Digjitalizim dhe Leksikografi. Propozimi u përkrah.

Më pas filloi shqyrtimi i Programit të Punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore. M. Kraja në diskutimin e tij fillimisht bëri disa vërejtje për formën e hartimit të programeve sipas seksioneve, duke thënë se duhet të ekzistojë një standard i hartimit të programeve. Me këtë rast ndërhyri Kryetari Islami i cili u pajtua me vërejtjen në fjalë dhe apeloi te sekretarët e seksioneve që të ndjekin versionin e SGJL, ashtu siç është thënë edhe në Kryesi. Më pas M. Kraja vazhdoi diskutimin për Programin e punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore, duke u ndalur te pika 3, projekti: “Hasan Prishtina në dokumentet arkivore”. Ai u shpreh se është kundër kësaj pike, përkatësisht është kundër që bartës i projektit të jetë Oliver Schmitt, duke pasur parasysh se ai nuk njihet për shkrime të mira për Kosovën dhe shqiptarët. Pas fjalës së akademik Krajës, për këtë pikë u hap diskutimi. J. Bajraktari, sekretar i SSHSH dhe bartës i projektit nga ana e ASHAK tha se projekti në fjalë është rezultat i bashkëpunimit të Akademisë sonë me Akademinë e Shkencave të Austrisë, propozimi ka dalë nga vetë Akademia Austriake dhe nuk ka arsye të mos pranohet, duke marrë parasysh se Schmitt, njihet si studiues solid në studimet ballkan-

ologjike. N. Daci në diskutimin e tij tha se projekti në fjalë është i rëndësishëm së veçantë, por u shpreh kundër që të ketë bashkautorësi, meqë siç tha ai në Shkencat shoqërore kjo nuk është praktikë. Kryetari Islami në diskutimin e tij sqaroi se ideja e projektit ka dalë nga vizita e fundit (mars 2016) e delegacionit të Akademisë Austriake. Ai tha se në takimin e mbajtur në ASHAK është biseduar gjerësisht për tema që i përkasin të gjitha seksioneve të ASHAK. Ai më pas tha se Profesor Schmitt gjatë qëndrimit në Kosovë është takuar edhe me përfaqësues të institucioneve përkatëse dhe projektin e ka paraqitur me shkrim dhe e ka arsyetuar mirë. Ai është historian i njohur dhe se ASHAK në bashkëpunim me të do të ndriçojë mirë figurën e Hasan Prishtinës. J. Bajraktari edhe një herë e mori fjalën dhe sqaroi se në tërë këtë projekt flitet vetëm për mbledhjen e dokumenteve arkivore, nuk flitet për botim dhe bashkautorësi. Nga ana e Akademisë Austriake duhet një bartës i projektit, meqë ata kanë qasje në shumë arkiva dhe mund të mbledhin më shumë të dokumente. R. Ismajli në diskutimin e tij fillimisht tha se nuk pajtohet me vlerësimin e M. Krajës për O. Schmitt. Ai më pas sqaroi se gjatë kontakteve me Akademinë Austriake është biseduar gjatë për këtë projekt dhe se çështja e bashkautorësisë po keqkuptohet. Fjala është vetëm për hulumtime dhe mbledhje të dokumenteve nga të gjitha arkivat dhe në këtë rast është e nevojshme që edhe nga pala austriake të ketë një përfaqësues, ndërsa shtoi se përgjegjësinë për materialet e

mbledhura do ta ketë bartësi nga ASHAK, përkatësisht SSHSH.

Gjatë shqyrtimit të Programit të punës së Seksionit të Shkencave të Natyrës, M. Kraja diskutoi për botimin: “Regjioni lindor i Kosovës (Veçoritë fiziko-geografike, resurset natyrore dhe problemet gjeomjedisore)”, me autor Valbon Bytyçi. Ai tha se në raste të tilla kur autorët janë jashtë Akademisë do të duhej që dorëshkrimi të jetë i gatshëm e jo vetëm të jepet propozimi. N. Daci tha se çështja e botimit në fjalë është diskutuar gjerë e gjatë në Seksion dhe se është propozuar që dorëshkrimi të ketë edhe një koautor nga ASHAK. Në këtë rast është propozuar që koautor të jetë akademik Hivzi Islami, si njohës i mirë i fushës përkatëse. H. Islami dhe M. Dushi u shprehën kundër këtij propozimi, me arsyetimin se nuk është praktikë t’i pranohet dikujt botimi i veprës dhe t’i caktohet koautori nga ASHAK.

Në fund u shqyrtua edhe Programi i punës i Seksionit të Arteve. Z. Ballata në diskutimin e tij tha se në Program nuk është përfshirë saktë mbajtja e ndonjë programi artistik gjatë vitit dhe propozoi që edhe një pikë si kjo të futet në program. Lidhur me këtë kryetari Islami tha se çështja e organizimit të programeve artistike dhe të tryezave shkencore të të gjitha zhanreve është e hapur dhe se ato mund të organizohen sipas mundësive dhe rasteve.

Pas shqyrtimit të programeve të punës sipas seksioneve, Kuvendi me shumicë votash miratoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2017.

Programi është pjesë përbërëse e procesverbalit.

IV. Mbledhja XC, e katërta dhe e fundit për vitin 2016 u mor me zgjedhjet për anëtarë të rinj.

Pas miratimit të rendit të ditës Kryetari Islami, bazuar në Statutin e Akademisë, neni 29, paragrafi 14, propozoi që në kuorum të mos përfshihet akademik Rexhep Qosja. Propozimi u miratua njëzëri dhe në vazhdim Kryetari kërkoi nga Sekretarja e Akademisë të ofrojë sqarimet e nevojshme.

L. Pula njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 28 anëtarë të Akademisë, nga 30 sa janë gjithsej. Meqë një anëtar nuk përfshihet në kuorum, mund të konstatohet se kuorumi për këtë mbledhje është 29 anëtarë, 18 anëtarë të rregullt dhe 11 anëtarë korrespondentë.

Sipas Ligjit për Akademinë, neni 15 dhe Statutit të Akademisë, neni 24:

“Anëtari i rregullt zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Akademisë”.

“Anëtari korrespondent zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë”.

“Anëtari i jashtëm dhe anëtari i nderit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë”.

Mbi këtë bazë:

- Anëtar i rregullt zgjidhet kandidati që merr së paku 10 vota;
- Anëtar korrespondent zgjidhet

kandidati që merr së paku 15 vota;

- Anëtar i jashtëm zgjidhet kandidati që merr së paku 15 vota.

Pasi u dhanë sqarimet e nevojshme Kuvendi filloi shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

Në vazhdim, Kryetari Islami u paraqit me fjalë rasti, e cila është paraqitur në procesverbalin e kësaj mbledhjeje të Kuvendit.

Kuvendi, më pas emëroi njëzëri Komisionin e zgjedhjeve në përbërje prej akademikëve: Feriz Krasniqi, Zeqirja Ballata dhe Sabri Hamiti.

Para fillimit të procesit të votimit diskutuan R. Dhomi dhe M. Dushi.

Në diskutimin e tij R. Dhomi propozoi që në të ardhmen procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë të kryhet nëpër seksione, ndërsa në Kuvend të bëhet vetëm miratimi i zgjedhjes së tyre, ndërsa M. Dushi propozoi që të gjithë kandidatët e propozuar për anëtarë të Akademisë të shkojnë për votim në Kuvend, por prioritet të kenë anëtarët e votuar nëpër seksionet përkatëse.

Me këtë rast Kryetari Islami sqaroi se të gjitha procedurat deri më tani janë zhvilluar duke u bazuar në Ligjin dhe Statutin e Akademisë dhe propozimet përkatëse nuk mund të implementohen.

Pas diskutimeve u ndanë fletë-votimet. Pas përfundimit të votimit, Komisioni i hapi me radhë kutitë e votimeve, i numëroi fletëvotimet dhe i hartoi raportet përkatëse për rezultatet e votimeve të cilat i paraqiti para Kuvendit.

Rezultatet e votimeve paraqiten në

Procesverbalin e kësaj mbledhjeje të Kuvendit.

Pas komunikimit të rezultateve të votimit, Kryetari i Akademisë konstatoi se procesi zgjedhor është përshkuar me respektimin e procedurave të parapara me Statut dhe me Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë dhe uroi anëtarët e zgjedhur.

II. KRYESIA

Bazuar në kompetencat dhe obligimet e përcaktuara me Ligjin për Akademinë dhe me Statutin e saj, Kryesia e Akademisë në 15 mbledhjet e vitit 2016 është marrë me shqyrtimin e shumë çështjeve.

Në vazhdim në mënyrë kronologjike do të pasqyrohet aktiviteti i Kryesisë së Akademisë.

1. Kryesia në mbledhjen (X) e 14 janarit pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja pararendëse, shqyrtoi kërkesën e Kryeredaktorit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, të datës 14.01.2016 dhe mori vendim që redaktorëve të fushave të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës, në mënyrë lineare t'u paguhet paushalli në vlerë prej 1000€, për punën e kryer deri në këtë fazë, ndërsa u vendos që për disa fusha të bëhen pagesat si në vijim:

a. Për fushën e arteve pamore të paguhen me nga 500 €, Tahir Emra dhe Hivzi Muharremi;

b. Për fushën e gjeografisë fizike të paguhen me nga 500 €, Vahdet Pruthi dhe Valbon Bytyçi;

c. Për fushën e trashëgimisë të paguhen me nga 500 €, Fejaz Drançolli dhe Sadri Fetiu.

Kryesia njëherësh mori vendim për angazhimin e z. Bahri Koskoviku, i cili do të bëjë lekturën (korrekturën) e të gjitha materialeve për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës. Pagesa të lartpërmendurit u tha të bëhet në pajtim me Rregulloren mbi honorarët e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 8, pika a.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se Ligji për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës është miratuar dhe së shpejti pritet të hyjë në fuqi. Ai tha se tani duhet të fillojë puna për përgatitjen e akteve të tjera nënligjore dhe propozoi të ngrihet Grupi punues për hartimin e Statutit dhe të Rregullores mbi propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, me këtë përbërje: Lendita Pula, kryetare dhe Isuf Krasniqi, Arsim Bajrami dhe Ali Caka, anëtarë. Propozimi u përkrah njëzëri nga të gjithë anëtarët e Kryesisë dhe u vendos ngritja e grupit sipas propozimit të lartpërmendur.

Kryesia njëherësh:

a. Vendosi që të shtohet tirazhit i Monografisë Kosova-versioni anglisht në 500 kopje;

b. Vendosi të shënohet 8-vjetori i pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 16 shkurt 2016.

c. Ngriti Komisionin për caktimin e çmimeve të botimeve të Akademisë, në përbërje prej: akademik Eqrem

Basha, Rejhane Islami dhe Burim Rexhepi.

2. Në mbledhjen (XI) e mbajtur më 1 shkurt Kryesia:

Kryesia shqyrtoi Raportin e punës së ASHAK-ut për vitin 2015, me radhë sipas seksioneve. U tha se raportet janë shqyrtuar edhe nëpër seksione. Në diskutimin e tij A. Aliu tha se nga raporti vërehet se programi i punës për vitin 2015 është realizuar në masë të mirë, me përjashtim të disa dorëshkrimeve që nuk kanë arritur të botohen për shkak të shkurtimeve buxhetore. Diskutuan edhe L. Mulliqi, E. Basha dhe pas diskutimeve Kryesia miratoi Raportin e punës për vitin 2015, i cili do t'i dërgohet Kuvendit të Akademisë për miratim përfundimtar.

Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe do të botohet në Vjetari 2015.

Kryesia po ashtu shqyrtoi edhe Raportin financiar të ASHAK-ut për vitin 2015. Raporti u miratua dhe është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Raporti do t'i dërgohet Kuvendit të Akademisë për miratim përfundimtar.

Në kuadër të mbledhjes Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen e LXXXVII të Kuvendit të Akademisë, me këtë rend dite: miratimi i procesverballit të mbledhjes LXXXVI të Kuvendit; miratimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2015; miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2015 dhe çështje vijuese.

Kryesia njëherësh diskutoi për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2016.

Sekretari shkencor njoftoi Kryesinë se mjetet financiare janë të siguruara nga donatori Marigona Residence edhe për këtë vit dhe se duhet të shpallet konkursi, ashtu që shpërblimi të ndahet në muajt e parë të vitit. Diskutuan edhe A. Aliu, F. Krasniqi dhe pas diskutimeve Kryesia vendosi të shpallë konkursin publik për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2016, me kriter: Për kandidatin e moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit. U tha që konkursi të shpallet në gazetën Koha Ditore, Kosova Sot dhe Zëri.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës L. Mulliqi diskutoi për disa çështje rreth Statutit dhe rregulloreve që janë duke u draftuar. Ai tha se Seksioni i Arteve ka disa propozime të reja për aktet e reja. Diskutuan A. Aliu, E. Basha, J. Bajraktari, I. Krasniqi dhe pas diskutimeve nën-kryetari Aliu tha se Grupi punues i ngritur nga Kryesia e ASHAK, do të hartojë një draft i cili më pas do të shqyrtohet nëpër seksione dhe në Kryesi dhe me këtë rast të gjithë do të kenë mundësi të paraqesin propozimet e tyre, të cilat më pas do të përfshihen në Statut dhe në rregulloret e tjera.

3. Kryesia në Mbledhjen e dt.3 mars (XII) pas miratimit, si zakonisht të procesverbalit nga mbledhja pararendëse shqyrtoi aplikacionet për konkursin publik për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2016, që kanë arritur në Akademi, brenda afatit të paraparë. Kryetari Islami njoftoi se të gjithë kandidatët i përkasin fushës së

shkencave të natyrës dhe se për këtë fushë deri më tani është ndarë dy herë radhazi shpërblimi mbështetës (2014 dhe 2015). Diskutuan edhe A. Aliu, E. Basha, L. Mulliqi dhe pas diskutimeve Kryesia vendosi të rishpallë konkursin edhe për 15 ditë të tjera, me shpresë se do të paraqiten edhe kandidatë të fushave të tjera.

Më pas Kryetari Islami njoftoi anëtarët e Kryesisë se grupi punues për hartimin e Statutit dhe të Rregullores mbi propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë ka hartuar draftin e parë të Statutit dhe Rregullores. Ai propozoi që të dy draftet t'ju përcillen anëtarëve të Akademisë përmes sekretarëve të seksioneve. Sekretarët e seksioneve do të caktojnë mbledhjet e seksioneve ku do të shqyrtohen draftet. Pas shqyrtimit të draftit të Statutit dhe të Rregullores nëpër seksione sekretarët e seksioneve të ASHAK, vërejtjet dhe sugjerimet eventuale të seksioneve do t'ia paraqesin me shkrim dhe të nënshkruara, Kryesisë së Akademisë, më së voni deri më 1 prill 2016.

Po ashtu në këtë mbledhje Kryesia diskutoi për kërkesën e Seksionit të Arteve drejtuar Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës për nominim e akademik Rauf Dhomi për Medaljen Presidenciale të Meritave. Kryetari Islami tha se kërkesa ka shkuar në emër të Seksionit të Arteve pa u konsultuar fare Kryesia. Kërkesa është e protokolluar dhe e vulosur me vulë të ASHAK. Kjo mënyrë e komunikimit nuk është e mirë. ASHAK-u nuk ka asgjë kundër për ndarjen e Medaljes

akademik Dhomit, por meqë kërkesa ka shkuar nga ASHAK-u, atëherë kjo çështje do të duhej të shtrohej në Kryesinë e Akademisë dhe në raste të tilla do të propozoheshin anëtarët e Akademisë duke i dhënë prioritet moshës. Diskutuan edhe A. Aliu, E. Basha, I. Krasniqi dhe pas diskutimeve u tha se seksionet mund të propozojnë kandidatë nga radhët e tyre, por vendimin duhet ta marrë Kryesia e Akademisë.

4. Në mbledhjen (XIII) e mbajtur më 19 prill Kryesia:

1. Mori vendim për ngritjen e Komisionit për vlerësimin e kandidatit për ndarjen e Shpërblimit mbështetës 2016 në përbërje prej akademikëve Hivzi Islami, Feriz Krasniqi dhe anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari. U tha se Komisioni të fillojë menjëherë me punë, ashtu që deri të premtën, më 22 prill të ndahet shpërblimi në fjalë.

2. Vendosi të thërrasë mbledhjen e LXXXVIII të Kuvendit të Akademisë, më 11.05.2016, ora 11:00, me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXVII të Kuvendit; shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës; dhe çështje vijuese.

3. Vendosi që z. Zeni Ballazhi t'i paguhet paushalli në shumën bruto prej 500.00€ për punën që ka bërë në cilësinë e dizajnerit grafik të veprës Ibrahim Kodra - Monografi, botim i Akademisë së Shkencave dhe të

Arteve të Kosovës.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia miratoi propozimin e Seksionit të Shkencave të Natyrës për ngritjen e Redaksisë së re për revistën Kërkime, me këtë përbërje:

1. Akademik Fejzullah Krasniqi, kryeredaktor
2. Anëtar korrespondent Qamil Haxhibeqiri, sekretar
3. Anëtar korrespondent Salih Gashi, anëtar
4. Anëtar korrespondent Arsim Morina, anëtar
5. Prof. dr. Enver Hamiti, anëtar nga lëmi i shkencave teknike
6. Prof. dr. Fetah Podvorica, anëtar nga lëmi kimi dhe teknologji
7. Prof. dr. Shukri Fetahu, anëtar nga lëmi i shkencave biologjike dhe agrikulturës.

Kryesia po ashtu miratoi:

- Raportin e akademik Rexhep Ismajli për pjesëmarrjen e tij në Konferencën shkencore ndërkombetare "Tomor Osmani: një jetë me Albanologjinë" në Shkodër, më 26-27 janar 2016;

- Raportin e akademikëve Ali Aliu dhe Eqrem Basha, për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin për realizimin e projektit të antologjive respektive të të dy akademive, të parapara në kuadër të Marrëveshjes së bashkëpunimit ASHAK-ASHAM, më 28 janar 2016;

- Raportin e akademik Ali Aliu për

qëndrimin në Tiranë, më 3-6 shkurt 2016, me qëllim të pjesëmarrjes në varrimin e akademik Kristo Frashëri dhe në ceremoninë e organizuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bujar Nishani, si dhe të anëtarit korrespondent Jusuf Bajraktari, për pjesëmarrjen në varrimin e akademik Kristo Frashëri, më 3-4 shkurt 2016;

- Raportin e Grupit punues për hartimin e Statutit dhe të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, për qëndrimin e tyre në Durrës, më 5-7 shkurt 2016, me qëllim të realizimit të punëtorisë për hartimin e drafteve të dokumenteve të lartcekura;

- Raportin e akademik Rexhep Ismajli për pjesëmarrjen e tij në Konferencën shkencore "Ismail Kadare: leximi dhe interpretimi", më 11-12 shkurt 2016;

- Raportin e akademikëve Ali Aliu dhe Eqrem Basha për qëndrimin e tyre në Tiranë, më 24-25 shkurt 2016, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin e Këshillit organizues të Konferencës shkencore për shënimin e 80-vjetorit të lindjes së Ismail Kadesë. Konferenca është pjesë e Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, 2015-2017;

- Raportin e akademik Rexhep Ismajli për vizitën dhe bisedat e delegacionit të Akademisë së Shkencave të Austrisë me Kryetarin dhe përfaqësuesit e ASHAK;

- Raportin e akademik Rexhep Ferri për qëndrimin e tij në Tiranë, më 4-5 mars 2016;

- Raportin e akademik Hivzi Islami për qëndrimin e tij në Gjermani, me qëllim të pjesëmarrjes në takimet për

migrimet, më 6-9 mars 2016; dhe

- Raportin e akademik Zeqirja Ballata dhe anëtarit korrespondent Luan Mulliqi, për qëndrimin e tyre në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin me ASHSH, për realizimin e pikave të Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, për fushën e arteve, më 18-19 mars 2016. Por lidhur me këtë raport u tha se në të janë përfshirë pika që nuk janë paraparë në Protokollin ASHAK-ASHSH, prandaj Seksioni duhet t'i përmbahet pikës 7 të Protokollit.

5. Mbledhja (XIV) e Kryesisë mbajtur më 26 maj, Kryesia shqyrtoi një varg çështjesh.

Fillimisht Kryetari Islami njoftoi Kryesinë se puna rreth Statutit dhe Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë ka përfunduar. Ai më pas kërkoi nga znj. Pula, kryesuese e grupit punues, të njoftojë Kryesinë për rrjedhën e punës. L. Pula në fjalën e saj tha se grupi punues është mbledhur më 23 maj dhe ka shqyrtuar nen për nen draftet e të dy dokumenteve duke i plotësuar ato me propozimet që u dhanë në mbledhjen e Kuvendit të Akademisë, më 11 maj 2016. Propozimet janë inkorporuar të gjitha në drafte, me përjashtim të propozimit të akademik Fejzullah Krasniqit për plotësimin e nenit 40 të Statutit duke i shtuar paragrafin 3 të nenit 5. Lidhur me këtë pikë ajo tha se grupi ka konstatuar se nuk ka bazë ligjore meqë çështjet financiare janë kompetencë vetëm e Kryesisë së Akademisë dhe vetëm Kryesia mund të bëjë

destinimin e mjeteve financiare. Ajo po ashtu njoftoi se grupi ka biseduar edhe me F. Krasniqin dhe se janë pajtuar që këto nene të mos ndryshohen. Grupi njëzëri ka miratuar draftin përfundimtar të Statutit dhe Rregullores dhe se kopjet e nënshkuara nga anëtarët e grupit i janë dorëzuar arkivit të ASHAK.

Më pas Kryesia ngriti grupin punues për hartimin e rregulloreve të ASHAK: Rregullorja për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e veprimtarisë botuese, me këtë përbërje: Znj. Lendita Pula, kryesuese, akademik Isuf Krasniqi, anëtar, akademik Mehmet Kraja, anëtar, akademik Eqrem Basha, anëtar, akademik Rauf Dhomi, anëtar, anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, anëtar, dhe Z. Ali Caka, anëtar për mbështetje teknike.

Në kuadër të pikës së katërt të rendit të ditës Kryesia diskutoi për uebfaqen e ASHAK-ut. U tha se biografite dhe bibliografitë e anëtarëve të Akademisë duhen freskuar.

Kryetari Islami në diskutimin e tij tha: "Nevoja për freskim të UEB-faqes së Akademisë ndjehej kaherë. Kam biseduar me nënkryetarin dhe sekretarin shkencor të merren biografite dhe bibliografitë e anëtarëve nga monografia e 40-vjetorit të Akademisë, me historikun e plotë të institucionit, meqë aty janë të dhënat më të reja të biobibliografive, të përgatitura nga redaksia, të redaktuara e të lekturuara, të ekuilibruara në vëllim

sa i përket biografive dhe reklamime nuk ka pasur deri sot, përveç te biografia e prof. Ballatës ku është përvjedhur një gabim (viti i pranimit).

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit dhe mori vendim që të bëhet përditësimi i të dhënave në uebfaqen e ASHAK si:

a. Standardizimi i plotë i biografive dhe bibliografive, bazuar në monografinë 40 - vjet ASHAK;

b. Versioneve elektronike të botimeve të ASHAK.

U tha që Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe Teknologjisë së Informacionit të fillojë menjëherë për zbatimin e vendimit.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia shqyrtoi shkresën e akademik Minir Dushit drejtuar Kryesisë së ASHAK, nr.460, dt 16.05.2016. Diskutuan H. Islami, A. Aliu, J. Bajraktari, L. Mulliqi dhe pas diskutimeve u tha se kjo çështje është diskutuar në Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe konsiderohet e mbyllur.

Kryesia po ashtu:

- mori vendim për vazhdimin e angazhimit të Prof. dr. Nebi Caka, për punët në QLE, deri më 31.12.2016, dhe miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare:

- raportin e akademik Rexhep Ismajli për pjesëmarrjen e tij në Kuvendin vjetor të Akademisë Austriake të Shkencave në Vjenë, më 18-19 prill 2016;

- raportin e akademikëve Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe Eqrem Basha, për pjesëmarrjen e tyre në konferencën

shkencore “Shekulli i Kadaresë” organizuar nga ASHSH dhe ASHAK, në Tiranë, më 12-15 maj 2016;

- raportin e akademik Eqrem Basha për vizitën e tij në Akademinë e Shkencave të Austrisë me qëllim të pjesëmarrjes në programin “Feierliche Sitzung 2016”, më 19-22 maj 2016;

- raportin e znj. Lendita Pula, znj. Vjollca Hykolli, znj. Lirijeta Bunjaku dhe znj. Hasime Maliqi, për pjesëmarrjen e tyre në trajnimin “Analizimi, menaxhimi, raportimi dhe auditimi i transaksioneve financiare në institucionet publike, më 14-17 maj 2016, dhe

- raportin e akademik Rexhep Ismajli për qëndrimin studiues në Vjenë, më 22 prill-21 maj 2016.

6. Kryesia (XV) e dt. 15 qershor shqyrtoi Programin e punës së ASHAK për vitin 2017.

Para fillimit të Programit të punës, Kryetari Islami në fjalën e tij tha se Programi i punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë është mjaft i pasur, ndërsa shtoi se programi i Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe i Seksionit të Arteve është më i varfër. Ai sugjeroi sekretarët e këtyre dy seksioneve (SHSN dhe SA) që të bëjnë përpjekje dhe të punojnë edhe në drejtim të organizimit të tubimeve shkencore: konferencave, tryezave e aktiviteteve të tjera. Kryetari apeloi te sekretarët e seksioneve që t’i përcjellin afatet dhe të fillojnë me kohë punën për përgatitjen e programeve të punës. Ai shtoi se secili sekretar duhet t’i dijë detyrat e veta dhe duhet t’i kryejë ato me përgjegjësi dhe në kohë.

Kryesia më pas filloi shqyrtimin e

Programin e punës së ASHAK për vitin 2017, me radhë sipas seksioneve.

Pas shqyrtimit të Programit të punës së SGJL, E. Basha njoftoi Kryesinë se akademik Rexhep Ismajli pas përfundimit të vizitës studimore në Akademinë Austriake të Shkencave, në Vjenë ka përgatitur një raport për vënien në veprim të Qendrës për Leksikografi dhe Enciklopedi. Raporti është paraqitur në formë aneksi dhe gjendet bashkëlidhur Programit të punës. Kryesia e shqyrtoi aneksin dhe vendosi që ai t’i përcillet Kuvendit të Akademisë, bashkë me Programin e punës.

Më pas u shqyrtuan edhe programet e seksioneve të tjera (SSHSH, SSHN dhe SA).

Lidhur me pikën Aktivitetet artistike të Seksionit të Arteve u tha se nuk mund të miratohet si e tillë, meqë kjo pikë i përket Protokollit të bashkëpunimit ASHAK-ASHSH, dhe duhet të realizohet ashtu siç është e paraparë në Protokoll.

U tha se Programi i punës për vitin 2017 do t’i dërgohet për miratim Kuvendit të Akademisë.

Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen e LXXXIX të Kuvendit të Akademisë, më 30 qershor 2016, ora 11:00, me këtë rend dite: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXVIII të Kuvendit; miratimi i Programit të punës së Akademisë për vitin 2017; dhe çështje vijuese.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia diskutoi për mbledhjen e parë të Grupit punues për hartimin e rregulloreve të ASHAK. Kryetari Islami

njoftoi se mbledhja e parë e Grupit punues nuk është mbajtur meqë akademik Mehmet Kraja ka kërkuar të mos jetë pjesë e Grupit punues. Kryesia njëzëri u pajtua që përbërja e Grupit të mbetet e njëjtë me përjashtim të akademik Krajës.

Kryesia më pas diskutoi për uebfaqen e ASHAK-ut dhe u tha se faqja duhet të freskohet me shënime të reja. Kryesia ngriti Redaksinë e re për uebfaqen e ASHAK-ut, në përbërje:

- Akademik Isuf Krasniqi
- Akademik Eqrem Basha
- Anëtar korrespondent Anton K. Berishaj
- Anëtar korrespondent Luan Mulliqi

U tha se Redaksia ka për detyrë të bëjë popullimin e faqes ueb të ASHAK, duke e freskuar dhe plotësuar në vazhdimësi me të dhëna përkatëse, si dhe duke e mbikëqyrur atë.

Kryesia më pas diskutoi edhe për planin e shfrytëzimit të pushimeve vjetore. L. Pula njoftoi Kryesinë se pjesa më e madhe e stafit do të shkojnë në pushim vjetor gjatë muajit gusht, meqë në këtë kohë aktivitetet në Akademi janë më të pakta dhe secili udhëheqës në departamentin e tij do të kujdeset që pikat kyçe të mos mbeten pa punonjës.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesia diskutoi për disa çështje të punëve të përditshme në administratën e ASHAK. Kryetari Islami në fjalë e tij tha se viteve të fundit, me rritjen e buxhetit është rritur edhe vëllimi i punëve dhe është shtuar numri i botimeve. Me rregulloren për

veprimtari botuese të ASHAK është e rregulluar çështja e rrjedhës së punës për botimin e një dorëshkrimi, por përkundër kësaj nganjëherë ndodh të ketë paqartësi. Ai sqaroi se në administratë kryhen vetëm punët që kanë të bëjnë me programin e punës së Akademisë.

Departamenti i përkrahjes profesionale e i teknologjisë së informacionit dhe komunikimeve (DPPTIK) në kuadër të administratës është përgjegjës për përgatitjen përfundimtare për shtyp të dorëshkrimeve të cilat janë në programin e punës së ASHAK-ut dhe nuk merret me dorëshkrime të tjera. Ai diskutoi edhe çështjen e dorëzimit të dorëshkrimit, kërkesat për kryerjen e punëve jashtë programit të punës të anëtarëve të Akademisë, mënyrën e punës së redaksive të revistave të ASHAK-ut etj.

Diskutuan edhe E. Basha, F. Krasniqi dhe pas diskutimeve Kryesia mori vendim:

1. Për veprimtarinë botuese të Akademisë kujdeset Këshilli redaktues i Kryesisë, në krye me Sekretarin Shkencor;
2. Çdo botim të Akademisë e redakton redaktori i caktuar;
3. Sipas rregullit, Sekretari shkencor është kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i botimeve të Kryesisë, ndërsa sekretarët e seksioneve, respektivisht udhëheqësit e këshillave dhe të komisioneve janë redaktorë të botimeve që i përgatisin ato;
4. Dorëshkrimet e përgatitura përfundimisht për shtyp, i paraqiten Akademisë në CD të radhitura në kompjuter në njërin nga versionet e

MS-WORD me radhor përkatës e në faqe të plotë, të pajisura, patjetër, me të gjitha shtojcat (fotografitë, hartat, skicat, grafikët, tabelat, treguesin e emrave-indeksin etj.). Fotografitë, hartat, skicat dhe grafikët duhen të jenë punuar në formatet përkatëse jpg ose png me rezolucion të mjaftueshëm për hedhje në shtyp (rezolucioni final për shtyp i imazheve: fotografi, harta, skica dhe grafikë duhet të jetë 300 dpi, e i imazheve që përmbajnë tekst duhet të jetë 400dpi);

5. Dorëshkrimet e punimeve, përkatësisht veprave të autorëve, i paraqiten Akademisë përmes administratës në adresë të seksionit përkatës, bashkë me deklaratën e autorit se punimi në fjalë nuk është botuar ose nuk është botuar pjesërisht. Në deklaratën e autorit duhet të saktësohet përqindja e dorëshkrimit të pabotuar;

6. Në Departamentin e Përkrahjes Profesionale e të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve (DPP-TIK) versioni elektronik i dorëshkrimit formatohet sipas standardit të botimeve të ASHAK-ut.

7. DPPTIK-u është përgjegjës për përgatitjen përfundimtare për shtyp të dorëshkrimeve të cilat janë në Programin e punës së ASHAK-ut.

8. DPPTIK-u nuk i lejonet të merrret me dorëshkrimet që nuk janë pjesë e Programit të punës së ASHAK.

9. Stafi profesional i DPPTIK-ut nuk mund të punojë pas orarit të rregullt të punës në ambientet e Akademisë, përveç në rastet kur ka vëllim të shtuar të punës për shkak të aktiviteteve të Akademisë dhe vetëm me kërkesë të menaxhmentit;

10. Përkthimi i rezymeve në njërën nga gjuhët botërore (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht) të dorëshkrimeve të miratuara për botim është detyrë e autorit;

11. Botimet e ASHAK-ut merren nëpërmjet të Sekretares teknike të ASHAK-ut;

12. Punët për përgatitjen e revistave të ASHAK-ut (Studime, Studime shoqërore, Kërkime) kryhen nga redaksitë përkatëse, ndërsa sekretarët e redaksive përkujdesen për mbarëvajtjen e punëve.

Kryesia kërkoi nga sekretarja e Akademisë të përcjellë zbatimin e vendimit në fjalë.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia u mor me shqyrtimin e disa çështjeve:

a) E. Basha njoftoi Kryesinë se SGJL në mbledhjen e fundit ka shqyrtuar dy propozime të akademik Rexhep Ismajlit. Ai tha se propozimet janë përkrahur nga Seksioni dhe është kërkuar t'i paraqiten për miratim Kryesisë.

Propozimi i parë ka të bëjë me botimin e Poezisë së Pjeter Budit në pjesën e dytë të këtij viti.

E. Basha sqaroi se sivjet është 460 vjetori i lindjes së Budit. Një arsye më tepër për të rifreskuar krijimtarinë poetike të Budit është se kohët e fundit janë gjetur në Vatikan kopje të reja të këtyre poezive, me një cilësi shumë të mirë, të cilat i kanë rënë në dorë akademik Rexhep Ismajlit me ekskluzivitet për botim.

Propozimi i dytë ka të bëjë me kopjimin e Fjalorit Shqip Gjermanisht

të autorëve Karl Gurakuqi dhe Ndue Palokaj, të cilin akademik Rexhep Ismajli e gjeti në arkivin e Akademisë së Shkencave të Austrisë gjatë qëndrimit njëmuor në Vjenë si pjesë e këmbimeve shkencore me këtë Akademi. Fjalori është në formë skedash, i pabotuar, i porositur nga Akademia austriake, i hartuar diku në fillim të viteve 40. Qëllimi është që në këtë fazë Akademia jonë të shqyrtojë mundësinë e kopjimit të këtij materiali të grumbulluar në disa kutia të fotokopjuara dhe ta ketë si pjesë të arkivit të saj, meqë është i rëndësishë së veçantë.

Propozimi i SGJL u përkrah dhe Kryesia vendosi të botohet dorëshkrimi për Pjetër Budin, ndërsa u tha se dhe për Fjalorin mund të vazhdojë puna;

b) J. Bajraktari propozoi që fondi i librave të ASHAK-ut të pasurohet me libra të rinj. Ai tha se të gjithë duhen bërë përpjekje dhe të gjendet forma e mbledhjes së librave.

Kryetari Islami tha se një gjë e tillë është e hapur dhe se pasurimi i fondit të librave mund të bëhet gjithnjë;

c) U diskutua edhe çështja e lëshimit të Aktemërimit për Sekretarin e Akademisë. Kryetari njoftoi se Ligji i mëparshëm për Akademinë dhe Statuti ka përcaktuar se: "Sekretari i Akademisë zgjidhet me konkurs për katër vjet dhe mund të rizgjidhet". Ligjit i ri për Akademinë nuk parasheh mandat të caktuar për Sekretarin e Akademisë, ndërsa Statuti i ri i Akademisë përcakton se: "Sekretari i Akademisë është udhë-

heqës i administratës së Akademisë, me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara në Akt-emërimin e tij që nënshkruhet nga Kryetari i Akademisë" dhe se: "Mandati i Sekretarit të Akademisë është për kohë të pacaktuar".

Duke u bazuar në ndryshimet e lartshënuara, Kryesia vendosi që Sekretarit të Akademisë t'i lëshohet Aktemërimi nga data 01.07.2016. U tha se përgjegjësitë dhe detyrat e Sekretarit të Akademisë përcaktohen në Statut dhe në formularin e përshkrimit të detyrave të punës.

7. Në Mbledhjen (XVI) të saj mbajtur më 29 qershor, Kryesia shqyrtoi mundësinë për realizimin e disa pagesave për të angazhuarit në projektin Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Kryetari Islami njoftoi se ditë më parë është mbajtur mbledhja e Bordit të Enciklopedisë. Në mbledhje Kryeredaktori ka njoftuar për rrjedhën e punës duke thënë se disa fusha tani më i kanë dorëzuar materialet dhe se për ta mund të bëhen pagesat. Ai më pas tha se në bazë të shënimeve nga Departamenti për buxhet dhe financa, në këtë fazë mund të ndahet një shumë e mjeteve dhe propozoi që kjo shumë që të jetë 25,00.00€. Me propozimin e Kryetarit u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë. U tha se pagesat bëhen pas miratimit të Kryeredaktorit të FEK-ut.

Më pas Kryesia diskutoi për përbërjen e Komisionit për blerjen e veprave artistike. Meqë dy anëtarë të Komisionit, akademikët Pajazit Nushi dhe Engjëll Berisha, kanë ndërruar jetë

duhet të bëhet plotësimi i Komisionit. Kryesia mori vendim për ngritjen e Komisionit të ri, me mandat trevjeçar, me këtë përbërje: Tahir Emra, kryetar, Ali Aliu, Rexhep Ferri, Eqrem Basha dhe Luan Mulliqi, anëtarë.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje u shqyrtua raporti gjashtë mujor i punës (janar-qershor 2016) për projektin “Kadastri i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë të kundërt), si dhe propozimi i akademik Nexhat Daci, bartës i projektit, për realizimin e pagesave të angazhuarve në projekt. U tha se tani e tutje raportet e projekteve të jenë vjetore, ndërsa për pagesat u tha se gjendja financiare nuk është e mirë dhe se nuk ka të holla të mjaftueshme që pagesat të realizohen sipas propozimit të akademik Dacit. Diskutuan H. Islami, F. Krasniqi, I. Krasniqi dhe pas diskutimeve Kryesia miratoi raportin e projektit në fjalë, si dhe mori vendim që pagesat të bëhen me 30% zbritje të vlerës së propozuar, për person.

Në fund, Kryesia miratoi:

- raportin e akademik Nexhat Daci, për qëndrimin e tij në Lubjanë, me qëllim të pjesëmarrjes në 7th Danube Academies Conference (DAC), më 11-14 maj 2016;

- raportin e akademik Nexhat Daci, për qëndrimin e tij në Vjenë, me qëllim të pjesëmarrjes në konferencën: “Western Balkans Process. 2-nd Join Science Conference”, më 22-24 maj 2016;

- raportin e akademikëve Nexhat Daci, Isuf Krasniqi dhe Fejzullah

Krasniqi për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Vizita u realizua në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ASHAK-ASHAM, me qëllim të realizimit të projekteve nga lëmi i mjedisit, resurseve natyrore dhe energjetikës.

8. Në mbledhjen e dt. 30 gusht (XVII) pikë qendrore e rendit të ditës ishte çështja e zgjedhjeve për anëtarë të Akademisë.

Kryesia bazuar në Ligjin dhe Statutin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës mori vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të Akademisë dhe miratoi Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, si më poshtë:

“Në bazë të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Ligji Nr. 05/L-038) neni 19, 20, 21, 22 e 23, dhe të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nr. 446/2, të 11.05.2016, neni 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 e 32 nen paragrafi 1.4, Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në mbledhjen e saj të datës 30.08.2016 vendosi të shpallë

QARKOREN PËR PROPOZIMIN E KANDIDATËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË AKADEMISË

Duke pasur parasysh karakterin dhe rolin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rastin e dhënies së propozimeve është e domosdoshme të merren parasysh posaçërisht këto momente:

1. Në mbledhjet e organeve përkatëse të institucioneve, që me Statutin e ASHAK-ut (www.ashak.org tek Dokumentet) janë të autorizuar të japin propozime, duhet të shqyrtohet në mënyrë të gjithanshme çështja se cilët shkencëtarë, respektivisht artistë i plotësojnë kushtet për t'u propozuar anëtarë të Akademisë, në mënyrë që, në bazë të rezultateve të shqyrtimit dhe të vlerësimit të krijimtarisë shkencore a artistike të kandidatëve, të paraqiten propozimet e arsyetuara për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

2. Në Ligjin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 20, përkatësisht në Statutin e ASHAK-ut neni 20 është precizuar, se:

“Anëtar korrespondent i Akademisë mund të zgjidhet punonjësi i shkencës ose i artit, shtetas i Kosovës, i cili ka krijuar vepra shkencore ose artistike të një rëndësie të veçantë”.

3. Në Statutin e ASHAK-ut, neni 18 paragrafi 4, (4.1, 4.2 dhe 4.3), është precizuar, se:

4. “Anëtarë korrespondentë të Akademisë zgjidhen kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeçare”.

4.1. “Kandidatët të cilët në ditën e mbylljes së afatit për paraqitjen e propozimeve mbushin 65 vjeç nuk mund të hyjnë në procedurën e zgjedhjeve”;

4.2. “Afati i mbylljes së paraqitjes së propozimeve përcaktohet me Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Aka-

demisë (në tekstin e mëtejshëm: Qarkorja)”; dhe

4.3. “Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë afatit të cekur në nënparagrafin 4.1 të këtij neni, nuk do të merren parasysh”.

4. Propozimet e më së paku 2 (dy) recensentëve duhet të jenë të arsyetuara me shkrim dhe duhet të përmbajnë:

- Të dhënat e hollësishme për punën shkencore ose për veprat artistike të kandidatit të propozuar;

- Vlerësimet e plota të propozuesve për rezultatet shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar; dhe

- Të dhënat për recensionet e mëparshme të rezultateve të krijimtarisë shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar.

5. Në procedurën e dhënies së vlerësimeve rreth krijimtarisë së kandidatëve, organet përkatëse të institucioneve, që me Statutin e ASHAK-ut janë të autorizuar të japin propozime për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, mund të angazhojnë edhe punonjës të dalluar të shkencës e të artit dhe institucione jashtë mesit të tyre.

6. Dokumentacioni i nevojshëm i kandidatit që propozohet:

- Propozimet e më së paku 2 (dy) recensentëve, të nënshkruara, të vulosura dhe të protokolluara nga Institucioni që propozon;

- Kopja e letërnjoftimit;

- Ekstrakti lindjes origjinal, jo më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj;

- CV-ja e plotë
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Kosovës, original;
- Bibliografia e saktë e punimeve bashkë me fotokopjen e faqes së parë dhe të fundit të revistës, përmbajtjes dhe punimit ku është publikuar punimi;
- Kopja e librit/librave, ballina, faqet e të dhënave të librit, përmbajtja, faqja e CIP-it, dhe faqja e fundit;

7. Propozimet e arsyetuara bashkë me dokumentacionin e cekur në pikën 6 të kësaj Qarkore duhet të dorëzohen çdo ditë pune prej orës 8:30 deri në orën 15:00, deri më 17 tetor 2016 në Shërbimin Profesional, Administrativ e

Teknik të ASHAK-ut, në adresën: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, rruga Agim Ramadani, nr. 305, Kati I, Zyra nr. 103.

8. Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë këtij afati nuk do të merren parasysh.

9. Baza juridike e ASHAK-ut mund të shihet në faqenub të ASHAK-ut në <http://www.ashak.org>”.

U tha se Qarkorja do t’iu dërgohet të gjitha këshillave të fakulteteve të universiteteve publike dhe këshillave shkencorë të instituteve shkencore që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, më 1 shtator 2016.

Kryesia po ashtu miratoi edhe Agjendën e veprimtarive parazgjedhore:

“AGJENDA E VEPRIMEVE PARAZGJEDHORE 2016

30 gusht 2016	Mbledhja e Kryesisë: Shpallja e zgjedhjeve; Caktimi datës së mbajtjes së zgjedhjeve (mbledhja e Kuvendit zgjedhor), më 21 dhjetor 2016.
1 shtator 2016	Shpallja e zgjedhjeve Dërgimi i Qarkores fakulteteve dhe instituteve publike.
17 tetor 2016	Afati i fundit për paraqitjen e propozimeve.
18 tetor 2016	Pasqyra e propozimeve për anëtarë të rinj.
19 tetor 2016	Mbledhja e Kryesisë: Njoftimi me propozimet që kanë arritur Caktimi i orarit të mbledhjeve të seksioneve, (më 25 dhe 26 tetor); Dërgimi i listave të propozimeve seksioneve për

- kandidatët përkatës;
Kryesia kërkon prej seksioneve të shfaqin mendimin e tyre për secilin kandidat veç e veç (me recension nga së paku 2 anëtarë të vet);
Afati për paraqitjen e recensioneve është 15 ditë (përmbyllur më 11 nëntor 2016).
- 25 - 26 tetor 2016 Mbledhjet e seksioneve:
Shqyrtimi i propozimeve nga jashtë;
Dhënia e propozimeve;
Propozimet për avancimin e anëtarëve korrespondentë të Seksionit;
Caktimi i recensentëve për të gjithë kandidatët e propozuar;
Propozimi i kandidatëve për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit;
Propozimi i numrit të anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga seksioni (përpjesëtimi midis seksioneve).
- 31 tetor 2016 Mbledhja e Kryesisë:
Njoftimi me propozimet e seksioneve;
Analiza e gjendjes;
Përcaktimi i numrit të anëtarëve të rinj që do të zgjidhen – duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve;
Shqyrtimi i propozimeve Kryesia për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi;
Propozimet për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi;
Caktimi i recensentëve për anëtarët e propozuar;
- 11 nëntor 2016 Afati i fundit për dorëzimin e recensioneve të recensentëve bashkë me propozimet nga jashtë.
- 16 nëntor 2016 Përgatitja e materialeve për shikim nga Opinioni publik;
Dërgimi i njoftimit për opinionin publik.

17 – 24 nëntor 2016	Ekspozimi i materialeve në mjediset e Akademisë.
25 nëntor 2016	Mbledhja e Kryesisë: Pranimi dhe shqyrtimi kundërshtimeve eventuale; Caktimi i mbledhjes së seksioneve (29-30 nëntor 2016).
29 – 30 nëntor 2016	Mbledhjet e seksioneve: Shqyrtimi i vërejtjeve eventuale; Votimi për kandidatët e propozuar.
5 dhjetor 2016	Kryesisë i dërgohen propozimet e pranuar në seksione.
9 dhjetor 2016	Anëtarëve të Kuvendit u dërgohen recensionet për të gjithë kandidatët.
21 dhjetor 2016	Kuvendi zgjedhor”.

Kryesia më pas diskutoi dhe shqyrtoi edhe një varg çështjesh.

U diskutua për vazhdimin e pagesave të honorarëve për të angazhuarit në projektin Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Meqë me rishikim të buxhetit për vitin 2016, janë ndarë mjete shtesë, Kryesia mori vendim për realizimin e pagesave sipas disponueshmërisë së mjeteve financiare për vitin 2016. U tha se realizimi i pagesave bëhet pas konfirmimit nga Kryeredaktori i FEK-ut;

U diskutua çështja e hartimit të dokumenteve për Shërbimin profesional, administrativ dhe teknik të ASHAK. L. Pula në diskutimin e saj sqaroi se bazuar në rekomandimet e Auditorit të përgjithshëm, për Shërbimin profesional administrativ dhe teknik të ASHAK ka nevojë të hartohen disa

dokumente (Plani i menaxhimit të rrezikut të ASHAK 2017-2019, Regjistri i rrezikut 2016 dhe Regjistri i rrezikut 2017). Për hartimin e tyre duhet të ngritët një grup punues nga SHPAT që do të merret me çështjen në fjalë dhe me këtë rast është e nevojshme të angazhohet një konsulent nga jashtë institucioni i cili do të mbështesë grupin punues për hartimin e dokumenteve në fjalë.

Kryesia mori vendim për ngritjen e Grupit punues me këtë përbërje: Vjollca Hykolli, kryesuese dhe Ali Caka, Hilmi Zogjani, Furtuna Naka, Dafina Kavaja, anëtarë. Po ashtu u vendos të fillojnë procedurat përkatëse për angazhimin e konsulentit të jashtëm, që do të mbështesë dhe ndihmojë grupin punues të ASHAK-ut. Punët dhe detyrat e punës së

konsulentit do të përcaktohen me marrëveshje për shërbime të veçanta.

Kryesia mori vendim për angazhimin e Znj. Liridona Shehu për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike (QLE) për periudhën nga 23 shtator 2016- 23 dhjetor 2016 dhe vendosi t'i paguhet paushalli në shumë prej 200.00€ bruto, për çdo muaj. Detyrat e punës të të lartpërmendurës do të përcaktohen me kontratë mbi veprë.

Kryesia njëherësh miratoi:

- Raportin e udhëtimit zyrtar të akademik Hivzi Islami dhe anëtarëve korrespondentë Jusuf Bajraktari dhe Anton K. Berishaj, për qëndrimin e tyre në Tuz, më 9-11 gusht 2016, me rastin e promovimit të dy veprave të Anton K. Berishaj: Shoqëria pa shtet dhe Virgjërat e përbetuara, dhe

- Raportin e pjesëmarrjes në trajnim të punonjësve të SHPA-së, në Tiranë, më 30 qershor 2016-3 korrik 2016.

9. Në mbledhjen e dt. 27 shtator (XVIII), Kryesia diskutoi për çështjen e rregullimit të veturës së Akademisë (Peugeot 508 ST). Kryetari Islami njoftoi se gjatë qëndrimit zyrtar në Shqipëri vetura ka pësuar prishje të rëndë dhe deri më tani nuk ka mundur të riparohet për shkak të disa procedurave administrative. Ai më pas kërkoi nga L. Pula të ofrojë sqarimet e nevojshme. L. Pula në fjalën e saj njoftoi Kryesinë se vetura e lartpërmendur nuk mund të përdoret, meqë është bllokuar në tërësi. Mjetet financiare të planifikuara për servisimin e saj nuk mjaftojnë për riparimin e tërësishëm, për shkak të prishjes në

shkallë të lartë. Nëse tejkalohet shuma e mjeteve të planifikuara, atëherë gjatë auditimit mund të ketë rekomandim për mos planifikim të mjeteve financiare. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë. Gjatë diskutimeve u tha se gjatë muajit shtator e deri në dhjetor ka aktivitete të parapara me Programin e punës së ASHAK dhe se vetura është e domosdoshme për kryerjen e punëve. Prandaj u kërkua nga SHPA i ASHAK, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për riparimin sa më të shpejtë të veturës. U tha që Sekretarja e Akademisë të vazhdojë përpjekjet duke kontaktuar edhe me institucionet përkatëse, ashtu që të bëhet një zgjidhje e shpejtë e problemit në fjalë.

10. Në mbledhjen e dt. 19 tetor (XIX) Kryesia u njoftua me propozimet që kanë arritur brenda afatit të paraparë me Qarkoren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, nga institucionet kompetente jashtë Akademisë, si dhe me kërkesën e Prof. dr. Muhamedin Kullashi, anëtar i jashtëm i ASHAK, për pranimin e statusit të anëtarit korrespondent.

L. Pula njoftoi se brenda afatit të paraparë me Qarkoren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë janë propozuar 52 kandidatë. Prej tyre 14 kandidatë nuk i plotësojnë kushtet për të hyrë në procedurën e zgjedhjeve pasi që nuk e kanë sjellë dokumentacionin e kompletuar. Prof. dr. Muhamedin Kullashi, anëtar i jashtëm i ASHAK, i plotëson kushtet për të hyrë në procedurën e zgjedhjeve sipas Ligjit për Akademinë, neni

21 dhe Statutit të Akademisë, neni 21.

Kryesia e miratoi pasqyrën e propozimeve për anëtarë korrespondentë të Akademisë:

**“PASYQRA E PROPOZIMEVE PËR
ANËTARË KORRESPONDENTË TË
AKADEMISË**

Brenda afatit të paraparë me Qarkoren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, nga institucionet kompetente jashtë Akademisë janë propozuar për anëtarë korrespondentë të ASHAK-ut gjithsej 52 kandidatë.

Prof. dr. Muhamedin Kullashi, anëtar i jashtëm i ASHAK, bazuar në Ligjin për Akademinë, neni 21 dhe Statutin e Akademisë, neni 21, brenda afatit të paraparë me Qarkore i ka parashtruar kërkesë Kryesisë së Akademisë për pranimin e statusit të anëtarit korrespondent.

Gjithsej janë propozuar 53 kandidatë

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Janë propozuar 11 kandidatë, 10 kandidatë i kanë sjellë dokumentet sipas Qarkores. Kandidati Begzad Baliu nuk i plotëson kushtet për të hyrë në procedurën e zgjedhjeve pasi që nuk e ka sjellë dokumentacionin e kompletuar, i mungon: CV-ja dhe bibliografia, ndërsa certifikatën e lindjes, të shtetësisë dhe kopjen e letërnjoftimit kandidati i ka sjellë pas afatit të përcaktuar me Qarkore.

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore

Janë propozuar 16 kandidatë, 11 kandidatë i kanë sjellë dokumentet sipas Qarkores. Kandidatët Enver

Hoxhaj, Rexhep Gashi, Nerxhivane Dauti, Hava Ismajli dhe Enver Kutllovci nuk i plotësojnë kushtet për të hyrë në procedurën e zgjedhjeve pasi që nuk e kanë sjellë dokumentacionin e kompletuar. Përveç propozimit u mungojnë të gjitha dokumentet e tjera.

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës

Janë propozuar 20 kandidatë, 15 kandidatë i kanë sjellë dokumentet sipas Qarkores. Kandidatët: Rexhep Gjergji, Faton Berisha, Azem Lajqi, Hasan Ahmeti dhe Jusuf Dedushaj nuk i plotësojnë kushtet për të hyrë në procedurën e zgjedhjeve, pasi që:

1. Kandidatit Rexhep Gjergji i mungojnë: kopja e letërnjoftimit, certifikata e lindjes, certifikata e shtetësisë dhe CV-ja;

2. Kandidatit Faton Berisha i mungojnë: kopja e letërnjoftimit, certifikata e lindjes, certifikata e shtetësisë dhe CV-ja;

3. Kandidatit Azem Lajqi i mungojnë: kopja e letërnjoftimit, certifikata e lindjes dhe certifikata e shtetësisë ;

4. Kandidatit Hasan Ahmeti i mungojnë: certifikata e lindjes dhe certifikata e shtetësisë, dhe

5. Kandidati Jusuf Dedushaj i ka mbushur 65 vjeç, më 10 tetor 2016 dhe sipas Ligjit, dhe Statutit nuk hyn në procedurën e zgjedhjeve.

IV. Seksioni i Arteve

Janë propozuar 6 kandidatë, 3 kandidatë i kanë sjellë dokumentet sipas Qarkores. Kandidatët: Mentor Zyberaj, Emin Halili dhe Agim Salihu nuk i plotësojnë kushtet sipas Ligjit për

Akademisë, neni 20 dhe 23, paragrafi 3.

Nga kjo që u tha më lartë del se nga 53 kandidatë të propozuar, në procedurën e zgjedhjeve hyjnë 38 kandidatë, të cilët janë propozuar nga jashtë dhe 1 kandidat (Muhamedin Kullashi) që ka paraqitur kërkesën, konform Ligjit dhe Statutit të Akademisë.

Në procedurën e zgjedhjeve hyjnë gjithsej 39 kandidatë.

Bashkëngjitur listat me emrat e kandidatëve të propozuar”.

Diskutuan H. Islami, A. Aliu, F. Krasniqi dhe pas diskutimeve u tha se seksioneve u dërgohen listat me emrat e kandidatëve përkatës të cilët i plotësojnë kushtet për të hyrë në procedurën e zgjedhjeve me kërkesë që seksionet të shfaqin mendimin e tyre për secilin kandidat veç e veç (me recension nga së paku 2 anëtarë të vet).

Kryesia po ashtu caktoi orarin e mbajtjes së mbledhjeve të seksioneve si më poshtë:

1. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 25.10.2016, ora 13:00;

2. Seksioni i Shkencave Shoqërore, më 25.10.2016, ora 11:00;

3. Seksioni i Shkencave të Natyrës, më 26.10.2016, dhe

4. Seksioni i Arteve, më 26.10.2016, ora 13:00.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje Kryesinë u njoftua nga L. Pula me rrjedhën e punëve financiare. Ajo tha se pagesat për FEK, kanë filluar të kryhen dhe puna po ecën. Në disa raste ka vonesa, meqë ka bashkëpunëtorë që nuk vijnë për t'i nënshkruar kontratat

dhe disa redaktorë të fushave ende nuk i kanë kompletuar formularët për realizimin e pagesave. Sa i përket veprimtarisë botuese, ajo tha se në këtë kategori ka mjete financiare të pashpenzuara, pasi që ka dorëshkrime të planifikuara në Programin e punës së ASHAK, të cilat ende nuk janë dorëzuar për t'u përgatitur për shtyp. Po ashtu ajo njoftoi se tenderi i parë për shtypjen e librave ka dështuar, meqë komisioni ka pasur dilema për kualitetin e ofruar. Kompanitë që kanë ofruar çmimin më të ulët nuk kanë paraqitur kualitet. Tenderi është rishpallur dhe tani pritet të vazhdojnë procedurat e parapara me ligje përkatëse.

Kryesia më pas miratoi raportet nga udhëtimet zyrtare:

- Raportin e z. Ali Caka, drejtor i DPPTIK dhe znj. Furtuna Naka, udhëheqëse e prokurimit, për qëndrimin e tyre në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë, më 9 shtator 2016;

- Raportin e akademik Rexhep Ismajli, për qëndrimin e tij në Vjenë, në Institutin e Gjuhësisë, në Institutin e Studimeve të Europës Juglindore, në Institutin e Romanistikës dhe në Akademinë e Shkencave të Austrisë, më 26-30 shtator 2016;

- Raportin e akademik Ali Aliu, për qëndrimin e tij në Tiranë, më 29 shtator-1 tetor 2016;

- Raportin e akademik Rexhep Ferri dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, për qëndrimin e tyre në Tuz, me qëllim të pjesëmarrjes në varrimin e maestro Gjelosh Gjokaj, anëtar i jashtëm i ASHAK, më 1- tetor 2016, dhe

-Raportin e znj. Lendita Pula, për qëndrimin e saj në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Sllovenisë, në Lubjanë, më 3-5 tetor 2016.

11. Në mbledhjen e dt. 31 tetor (XX) në kuadër të pikës së parë të rendit të ditës, Kryesia:

a. U njoftua me propozimet e seksioneve të Akademisë, si më poshtë:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë

Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK në mbledhjen e mbajtur më 25.10.2016:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;

2. Nuk ka dhënë propozime nga brenda;

3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë Mehmet Halimi dhe Zejnullah Rrahmani;

4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;

5. Ka propozuar këta kandidatë për anëtarë të jashtëm: Bahri Beci, Matteo Mandala dhe Luan Starova;

6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga seksioni të jetë tre (3).

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore

Seksioni i Shkencave Shoqërore i ASHAK në mbledhjen e mbajtur më 25.10.2016:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;

2. Ka propozuar nga brenda një

kandidat: Prof. dr. Gjyljeta Mushkolaj nga Fakulteti Juridik i UP;

3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Edi Shukriu dhe Jusuf Bajraktari;

4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;

5. Ka propozuar për anëtarë të jashtëm kandidatin: Kristaq Prifti;

6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga seksioni të jetë katër (4).

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës

Seksioni i Shkencave të Natyrës i ASHAK në mbledhjen e mbajtur më 26.10.2016:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga institucionet përkatëse jashtë Akademisë;

2. Nuk ka dhënë propozime nga brenda;

3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë: Arsim Morina, Qamil Haxhibeqiri dhe Salih Gashi;

4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;

5. Nuk ka dhënë propozime për anëtarë të jashtëm;

6. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga seksioni të jetë katër (4).

IV. Seksioni i Arteve

Seksioni i Arteve i ASHAK në mbledhjen e mbajtur më 26.10.2016:

1. Është njoftuar me listën e kandidatëve të propozuar nga insti-

tucionet përkatëse jashtë Akademisë;

2. Nuk ka dhënë propozime nga brenda;

3. Ka propozuar për avancim anëtarët korrespondentë: Luan Mulliqi dhe Xhevdet Xhafa;

4. Ka caktuar recensentët për hartimin e recensioneve për secilin kandidat;

5. Ka propozuar për anëtarë të jashtëm kandidatin: Gëzim Qëndro;

6. Ka propozuar për anëtarë nderi kandidaten: Ermonela Jaho;

7. Ka propozuar që numri i anëtarëve të rinj që mund të zgjidhen nga seksioni të jetë një (1)”.
b. Pas analizimit të gjendjes, Kryesia diskutoi për përcaktimin e numrit të anëtarëve të rinj që do të zgjidhen, duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve. Kryetari Islami, në diskutimin e tij tha se kësaj radhe duhet të bëjmë më shumë përpjekje për pranimin e kandidateve femra. Kjo çështje nuk është e përcaktuar me aktet normative të ASHAK, por në opinion ka reagime të vazhdueshme. Së fundmi edhe nga ALLEA, kemi pranuar një shkresë, e cila mund të konsiderohet si apel akademike anëtare të saj, që në mesin e tyre të kenë anëtare femra. Po ashtu u tha që prioritet të kenë kandidatëve që njohin së paku një gjuhë të huaj. Diskutuan edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë.

c. Pas diskutimeve Kryesia përcaktoi numrin e anëtarëve të rinj që do të zgjidhen - duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve, si:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, tre anëtarë të rinj;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore, tre anëtarë të rinj;

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës, tre anëtarë të rinj;

IV. Seksioni i Arteve, një anëtar të ri.

Për të gjitha seksionet, me përjashtim të Seksionit të Arteve që e kanë kërkuar vetëm një anëtar, u tha se numri i anëtarëve të rinj që do të zgjidhen mund të shkojë deri në tre veta, me vullnet që anëtari i tretë t'i përkasë gjinisë femërore. U tha po ashtu se Prof. dr. Muhamedin Kullashi, anëtar i jashtëm i ASHAK, nuk hyn në kuotën e Seksionit të Shkencave Shoqërore, pasi që ai i ka parashtruar kërkesë Kryesisë së Akademisë për pranimin e statusit të anëtarit korrespondent, sipas Ligjit dhe Statutit të ASHAK.

d. Shqyrtoi propozimeve e seksioneve për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit dhe miratoi propozimet për këta anëtarë të jashtëm:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë: Bahri Beci, Matteo Mandala dhe Luan Starova;

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore: Kristaq Prifti;

III. Seksioni i Arteve: Gëzim Qëndro.

e. Miratoi propozimet për anëtarë të jashtëm Abdylmenaf Bexhetin dhe Mentor Petrelën.

f. Caktoi recensentët për hartimin e recensioneve për anëtarët e jashtëm të propozuar:

1. Mentor Petrela: Feriz Krasniqi dhe Arsim Morina

2. Bahri Beci: Rexhep Ismajli dhe Zejnullah Rrahmani;

3. Matteo Mandala: Eqrem Basha dhe Sabri Hamiti;

4. Luan Starova: Ali Aliu dhe Mehmet Kraja;

5. Kristaq Prifti: Jusuf Bajraktari dhe Hivzi Islami;

6. Abdylmenaf Bexheti: Isa Mustafa dhe Hivzi Islami;

7. Gëzim Qëndro: Luan Mulliqi dhe Rexhep Ferri.

Më pas Kryesia e shqyrtoi shkallën e realizimit të Programit të punës së ASHAK-ut për vitin 2016. U tha se Programi i punës është realizuar relativisht mirë dhe deri në fund të vitit pritet të realizohet në tërësi. Shkalla e realizimit të Programit të punës së ASHAK për vitin 2016 është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje Kryesia miratoi propozimin e Komisionit për blerjen e veprave artistike dhe mori vendim për blerjen e veprave:

1. "Hasjanja", skulpturë e autorit Luan Mulliqi, anëtar korrespondent i ASHAK. Dimensioni 55x15x13, legurë bronzi, 2016, me çmim prej 2.500€;

2. "Autobiografia 105", pikturë në pëlhurë (teknikë e kombinuar), e autorit Xhevdet Xhafa, anëtar korrespondent i ASHAK. Dimensioni 105x100 cm, 2014, me çmim prej 2.500€.

U tha se veprat blihen pas realizimit të ekspozitave të anëtarëve korrespondentë të lartpërmendur, të parapara me Programin e punës së ASHAK dhe i përkasin Fondit të veprave artistike të Akademisë.

12. Në mbledhjen e dt. 17 nëntor (XXI) Kryesia shqyrtoi raportin e përgatitur nga Ali Aliu dhe Eqrem Basha, koordinatore të grupit punues për përgatitjen e botimit të antologjive respektive së letrarëve akademikë, rezultat i bashkëpunimit në mes të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverbalit.

Raporti u miratua dhe Kryesia mori vendim për botimin e dorëshkrimit: Antologjia e poetëve dhe tregimtarëve të ASHAK, si dhe vendosi të paguhen paushallët për personat e angazhuar, si më poshtë:

1. Resul Shabanit i paguhet paushalli në vlerë prej 3,200.00 € bruto, për përkthimin e vargjeve nga gjuha shqipe në gjuhën maqedonase dhe për përkthimin e shënimeve të autorëve me parathënie, dhe

2. Fatbardha Shehut i paguhet paushalli në vlerë prej 880.00€ bruto, për përkthimin e tregimeve.

Më pas Kryesia u njoftua nga L. Pula për ecurinë e pagesave për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës. L. Pula në fjalën e saj tha se deri më tani janë proceduar shumica e pagesave, ditëve në vijim do të procedohen edhe pagesat për tri fusha të cilat pritet t'i dërgojnë shënimet përkatëse.

Diskutuan H. Islami, A. Aliu, E. Basha dhe pas diskutimeve u tha që në këtë fazë krahas hartuesve të zërave të paguhen paushallët edhe për të angazhuarit në punët redaktoriale si më poshtë:

1. Për punët redaktoriale të rishkrimit të zërave për tekstet e fushave të veçanta, akademik Mehmet Krajës i paguhen mjetet financiare në vlerë prej 5,000.00€;

2. Për punët redaktoriale të rishkrimit të zërave për tekstet e fushave të Arteve pamore dhe Artit muzikor, akademik Eqrem Bashës i paguhen mjetet financiare në vlerë prej 2,500.00€;

3. Për punët redaktoriale të rishkrimit të zërave për tekstet e fushës së Albanologjisë, akademik Rexhep Ismajlit i paguhen mjetet financiare në vlerë prej 2,000.00€.

Kryesia po ashtu miratoi për botim dorëshkrimin e QLE-së: Fjalësi shqip i lematizuar i fjalorit serbokroatisht-shqip, të Sokol Dobroshit, të vitit 1953.

Në kuadër të pikës së fundit të rendit të ditës Kryesia:

- mori vendim për mbajtjen e takimit për Fjalorin Enciklopedik të Kosovës, në Durrës, nga data 8-11 dhjetor 2016. U tha se pjesëmarrësve të takimit t'u paguhen shpenzimet e akomodimit, transportit, materialeve të punës, si dhe 20% e mëditjeve ditore për katër ditë, dhe

- miratoi raportin e Ali Aliut për qëndrimin e tij në Gjermani, më 6-12 nëntor 2016, me ftesë të Shoqatës Shqiptaro-Gjermane "Pavarësia".

13. Në mbledhjen e dt. 25 nëntor (XXII) u shqyrtuan kundërshtimet që kanë arritur në Akademi gjatë afatit të paraparë me Qarkore (17-24 nëntor 2016).

L. Pula njoftoi se gjatë afatit të lartcekur kanë arritur kundërshtime për kandidatët e propozuar nga Fakulteti i Mjekësisë dhe një tjetër ka arritur për një kandidat të Fakultetit të Arteve. U tha se kundërshtimet t'u dërgohen seksioneve përkatëse të ASHAK.

Kryesia po ashtu caktoi datat e mbajtjes së mbledhjeve të seksioneve, sipas agjendës së miratuar, më 30 08.2016.

Njëherësh, Kryesia vendosi të thërrasë mbledhjen e XC të Kuvendit të Akademisë, më 21 dhjetor 2016, ora 11:00, me këtë rend dite: miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXIX të Kuvendit; emërimi i Komisionit të zgjedhjeve; paraqitja e arsyetimeve të shkurtra të sekretarëve të seksioneve për secilin kandidat (për anëtarë të rregullt, për anëtarë korrespondentë dhe për anëtarë të jashtëm), si dhe votimi dhe shpallja e rezultateve të votimit.

14. Në mbledhjen e dt. 20 dhjetor (XXIII) Kryesia miratoi raportin gjashtë mujor të punës (korrik-dhjetor 2016) për projektin "Kadastri i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë të kundërt) dhe mori vendim për pagimin e paushallëve personave të angazhuar në projekt, si më poshtë:

1. Akademik Nexhat Daci,
3,220.00€;

2. Anëtar korresp. Salih Gashi, 2,240.00€;
3. Dr. sc. Majlinda Daci Ajvazi, 2,140.00€;
4. Dr. Bashkim Thaqi, 1,360.00€;
5. Mr. Bardh Begolli, 1,300.00€;
6. Dr. Lulzim Zeneli, 390.00€;
7. Ms. Dafina Hoxha, 984.00€;
8. Ms. Arta Rudi, 900.00€.

Në kuadër të kësaj mbledhjeje, Kryesia u njoftua nga L. Pula për rrjedhën e Grupi punues për hartimin e dokumenteve sipas rekomandimit të Auditorit të Përgjithshëm: Planit i menaxhimit të rrezikut të ASHAK 2017-2019, e cila tha se grupi në bashkëpunim me konsulentin e jashtëm kanë kryer punët e parapara dhe kanë finalizuar Planin e menaxhimit të rrezikut të ASHAK 2017-2019. Grupi punues në bashkëpunim me konsulentin e jashtëm po ashtu ka hartuar edhe Regjistrin e rrezikut 2016 dhe 2017, si dhe Rregulloren e brendshme për përkufizim të situatave të konflikteve të interesit. Ajo më pas propozoi anëtarët e Grupit punues për menaxhimin e rrezikut të ASHAK 2017-2019, në përbërje prej: Vjollca Hykolli, koordinatorë dhe Ali Caka, Hilmi Zogjani, Furtuna Naka, Dafina Kavaja, anëtarë.

Kryesia miratoi dokumentet e lartshënuara dhe përbërjen e Grupit punues.

Më pas u diskutua për hartimin e rregulloreve të ASHAK: Rregullorja për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë, Rregullorja për veprimtarinë botuese dhe Rregullorja për honorarët e veprimtarisë botuese. U tha se Grupi punues ka punuar dhe ka hartuar draftet e para të rregulloreve, por ka ende punë dhe se ato duhet të plotësohen. Duke marrë parasysh se gjysma e dytë e vitit ishte e ngarkuar me aktivitete në Akademi, në të cilat ishin të përfshirë disa nga anëtarët e Grupit punues, u vendos që miratimi i rregulloreve në fjalë të shtyhet në afat kohor prej 3 muajsh.

Në kuadër të pikës së fundi të rendit të ditës, Kryesia mori vendim për vazhdimin e angazhimit të Prof. dr. Nebi Caka, për punët në QLE, deri më 30.06.2016, si dhe miratoi raportet e udhëtimeve zyrtare si më poshtë:

- Raportin e punonjësve të Shërbimit profesional administrativ e teknik të ASHAK, për pjesëmarrjen në punëtorinë për hartimin e Planit të menaxhimit të rrezikut të ASHAK 2017-2019, në Tiranë, më 25-28 nëntor 2016;

- Raportin e akademik Hivzi Islami për qëndrimin e tij në Tiranë, me qëllim të pjesëmarrjes në Samitin mbi diasporën dhe mundësinë e investimeve në trojet amë, më 25-27 nëntor 2016;

- Raportin e kryeredaktorit të FEK, për takimin e Redaksisë qendrore me anëtarët e redaksive të fushave të FEK, në Durrës, më 8-11 dhjetor 2016;

- Raportin e akademik Hivzi Islami

me bashkëpunëtorë, për qëndrimin në Akademinë Sllovene, në Lubjanë, më 11-14 dhjetor 2016.

Njëherësh, në fund Kryetari Islami kërkoi nga kryetari dhe anëtarët e Redaksisë për faqen ueb të ASHAK, të përcjellin ndryshimet eventuale në Akademi dhe të përditësojnë faqen ueb sipas nevojës.

15. Në mbledhjen e fundit për vitin 2015, dt. 29 dhjetor (XXIV), Kryesia: vendosi që anëtarët e rregullt dhe anëtarët korrespondentë të Akademisë, të zgjedhur në Kuvendin zgjedhor të saj, më 21 dhjetor 2016, të përfshihen në listat e pagesave të rregullta mujore (shpërblimeve), duke reflektuar të gjitha ndryshimet financiare; Vendosi të fillojnë procedurat përkatëse për angazhimin e punonjësit për punët në Qendrën Leksikografike Enciklopedike (QLE). Punët dhe detyrat e punës së punonjësit do të përcaktohen me marrëveshje për shërbime të veçanta, si dhe vendosi që më 11 janar 2017, ora 11:00 të mbahet ceremonia inauguruese në të cilën anëtarëve të rinj të Akademisë do t'u ndahen Fletë dëshmitë përkatëse.

Në fund u diskutua çështja e akomodimit nëpër kabinete për anëtarët e rinj. U tha që sistemimi të bëhet sipas seksioneve të ASHAK.

AKTIVITETET E REALIZUARA NGA KRYESIA E AKADEMISË

1. Tryezë shkencore: "Trashëgimia Kulturore e Kosovës sot".

Këshilli për Trashëgimi në përbërje prej: anëtare korrespondente Edi

Shukriu, kryetare, akademik Jusuf Bajraktari dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, anëtarë, i caktuar nga Kryesia e Akademisë, më 13 maj 2016 organizoi tryezën shkencore me temë "Trashëgimia Kulturore e Kosovës sot". Në tryezë u fol për gjendjen e trashëgimisë kulturore në nivel të Republikës së Kosovës, përmes referimit të studiueseve dhe diskutimeve të aspekteve të ndryshme të fushës. Në të u trajtuan çështjet e legjislacionit dhe të administrimit të trashëgimisë kulturore, të kategorive të trashëgimisë arkitekturore dhe kishat mesjetare nga aspekti arkeologjik, trashëgimia e artit muzikor, artit pamor dhe të teatrit dhe filmit. Tryeza solli risi dhe trajtimin e kaheve antropologjike të trashëgimisë shpirtërore, të simbiozës mes trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe zhvillimin e turizmit mbështetur në trashëgiminë arkeologjike.

III. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Puna rreth Fjalorit Enciklopedik po shkon drejt finalizimit. Ka përfunduar hartimi i zërave në të gjitha fushat. Janë bashkuar në një dorëshkrim sipas renditjes alfabetike. Ka përfunduar dhe dora e parë e redaktimit. Është kryer lektura e materialit. Një draft prej rreth 2020 faqesh është shtypur dhe shpërndarë redaktorëve të fushave dhe anëtarëve të Akademisë. Në muajin dhjetor është realizuar

takimi i fundit i redaktorëve të fushave me redaksinë qendrore në Durrës ku janë diskutuar vërejtjet dhe janë kërkuar ndërhyrjet finale. Janë zhvilluar edhe diskutimet në seksione me redaksinë qendrore. Në proces janë raportimet e fundit të vërejtjeve e sugjerimeve që kanë anëtarët e Akademisë dhe redaksitë e fushave, diskutohen detajet, mungesat eventuale, bëhen harmonizimet, krahasimet e teksteve ndërmjet fushave të veçanta, për të përafshuar veprimet deri te version final.

2. Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën Shqipe. – Veprimtaria e Këshillit, që është dhe pjesë e Protokollit të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, gjatë vitit 2016 ishte paraparë të zhvillohej në Prishtinë, por në këtë periudhë ai nuk ka realizuar asnjë takim por janë këmbyer raporte dhe materiale të punës. Ende nuk është gjetur mënyra e kompensimit të anëtarëve të grupeve punuese dhe nuk është realizuar riformatimi i pjesës kosovare të Këshillit, e cila humbi anëtarë dhe pat mungesa për shkak të sëmundjeve disa të tjerëve. Synohet të mblidhen dhe të sistemohen materialet e punës së deritashme, diskutimet, propozimet, arritjet sipas fushave e grupeve të punës, që t'i paraqiten akademive si një material përmbledhës i aktivitetit të Këshillit, që shkon drejt përmbjlljes, apo si dorëshkrim, i cili një ditë mund të shohë dritën e botimit.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX – Është kryer dhe ka dalë

nga shtypi fjalësi i lematizuar i Fjalorit të Sokol Dobroshtit. Do të shërbejë si bazë për përpunimin e mëtejshëm të teksteve. Vazhdon puna në skanimin dhe digjitalizimin e revistave të botuara në Kosovë. Është skanuar “Jeta e Re” e plotë (para vitit 1968). Po pritet që brenda vitit të finalizohet i gjithë teksti. Synohet botimi përmbledhës i fjalorit të gjuhës shqipe në Kosovë para Kongresit të Drejtshkrimit (1972). Edhe më tutje evidentohen vështirësitë rreth ngritjes së kapaciteteve dhe aftësimin teknik e profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, sigurimi i skanerëve dhe mjeteve të tjera të sofistikuar teknike, të domosdoshme për punë.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Përgatitja dhe botimi i veprës së albanologut austriak Norbert Jokl ka qenë e paraparë të marrë më shumë kohë. Problemet paraqiten qoftë në mbledhjen e materialit, në përkthimin dhe sistemimin e tij, apo në përgatitjen për botim, që kërkon një kujdes të veçantë për shkak të specifikave, shenjave e grafive, si dhe krahasimeve të domosdoshme të dorëshkrimeve. Gjatë vitit 2016 është realizuar vëllimi 2, që përfshin artikuj, studime, që kanë të bëjnë me historinë e lashtë të shqipes, disa të marra nga arkivi i Institutit të Gjuhësisë në Tiranë dhe një pjesë të përkthyer nga Dr. Skënder Gashi. Vëllimi 3 Hulumtime lingvistike-kulturohistorike në fushë të shqipes është në fazën e përgatitjes dhe pritet të dalë nga fundi i vitit 2017. Ky projekt do të vazhdojë me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributeve të tjera të

Norbert Joklit me qëllim që vepra e tij të dalë sa më e plotë.

TUBIME SHKENCORE

1. Ndre Mjeda - 150 vjetori i lindjes.
- Konferencë shkencore. Përvjetori i lindjes së poetit, klerikut, gjuhëtarit dhe studiuesit Ndre Mjeda (20 nëntor 1866 - 1 gusht 1937) u shënuar në ambientet e ASHAK-ut në Prishtinë me një konferencë shkencore organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si pjesë e Protokollit për bashkëpunim midis tyre, e përgatitur nga Këshilli organizativ, i përbërë nga: Sabri Hamiti, Rexhep Ismajli, Kolec Topalli, Floresha Dado, Shaban Sinani dhe Eqrem Basha. Konferenca u mbajt me 15 shtator 2016 dhe në të u paraqitën me kumtesa 18 pjesëmarrës nga Kosova dhe Shqipëria, sa ishin paraparë me program dhe ishin ftuar. Njëkohësisht u mbledhën të gjithë kontributet e pjesëmarrësve dhe u finalizuan për botim. Konferenca solli kontribute të reja në ndriçimin e personalitetit të Mjedës, krijimtarisë së tij poetike, studimeve letrare e gjuhësore, shkrimeve fetare, etj.

2. 80 vjetori i lindjes së Ismail Kadaresë – Shënimi i përvjetorit të lindjes së Kadaresë, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u organizua në Tiranë, si pjesë e Protokollit të bashkëpunimit midis ASHSH dhe ASHAK. Veprimtaria më shumë kishte karakter ceremonial, por në vazhdim u mbajtën edhe 3-4 kumtesa rreth veprës së tij. Në këtë

pjesë të programit u paraqit dhe akademik Mehmet Kraja, nga ASHAK-u, me kumtesën “Kadare dhe Kosova”. Takimin në emër të ASHAK-ut e përshëndeti nënkryetari, akademik Ali Aliu. Ditën e dytë u organizua një bisedë me përkthyesit e veprës së Kadaresë, në shtëpinë-muze të tij në Gjirokastrë.

3. 100 vjetori i lindjes së Esad Mekulit.- Përvjetori i poetit, përkthyesit, botuesit dhe kryetarit të parë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Esad Mekuli (17 dhjetor 1916 – 6 gusht 1993), i paraparë të shënohet me një tryezë shkencore, u mbajt me datë 6 dhjetor 2016 në ambientet e ASHAK-ut. Këshilli organizues Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe Eqrem Basha kishin ftuar 12 pjesëmarrës, studiues, kritikë letrarë, njohës të veprës së Mekulit, nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Morën pjesë 11 prej tyre. Tryeza u konsiderua e suksesshme, pjesëmarrësit tashmë i kanë dorëzuar versionet për shtyp të kumtesave të tyre, të cilat janë gati për botim dhe do të publikohen në numrin vijues të revistës “Studime”.

BOTIME

1. Studimet albanistike në Amerikë Materialet e Konferencës shkencore, të organizuar nga Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, mbajtur me 25 e 26 shtator, 2015, në ambientet e ASHAK në Prishtinë. Në Konferencë u paraqitën 48 pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, nga SHBA-të, Gjermania, Italia, Polonia, etj., disa dërguan vetëm

kumtesat. U zhvilluan diskutime të gjera, ndërsa në fund të Konferencës u aprovua Ftesa, që pjesëmarrësit ia drejtuan opinionit publik e shkencor, autoriteteve shkencore e universitare të Kosovës dhe Shqipërisë, të SHBA-ve, komunitetit shqiptar në SHBA, që të shtrojnë çështjen e themelimit të një qendre hulumtuese arsimore në një prej qendrave universitare amerikane. Të gjitha këto materiale u përfshinë në botimin voluminoz, rreth 660 faqesh, të përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli, që ishte në krye të organizimit të kësaj Konference.

2. Norbert Jokl: Studime historike krahasuese për gjuhën shqipe. – Vëllimi II i veprës së albanologut austriak ka qenë gati për shtyp në fund të vitit 2016. I përgatitur nga akademik Rexhep Ismajli dhe prof. dr. Heiner Eichner, ai përfshin artikuj, studime, që kanë të bëjnë me historinë e lashtë të shqipes dhe ka një vëllim prej 943 faqesh. Disa prej këtyre teksteve u morën nga arkivi i Institutit të Gjuhësisë në Tiranë, ndërsa një pjesë janë përkthyer nga Dr. Skënder Gashi. Janë mbledhur të gjitha tekstat origjinale, në gjuhën gjermane dhe janë paraqitur të skanuara ose të fotokopjuara me cilësinë e pranueshme për botim. Synohej të dërgohej për shtyp nga fundi i vitit 2016, por u dërgua në janar të 2017-tës për shkak të zvarritjeve në tenderimin e shtypshkronjave.

3. Ndre Mjeda - 150 vjetori i lindjes – Materialet e Konferencës shkencore “Ndre Mjeda - 150 vjetori i lindjes” janë mbledhur në një vëllim prej rreth 250

faqesh, i bërë gati që nga nëntori i vitit 2016. Në të janë 18 kumtesa, të të gjithë pjesëmarrësve në Konferencë. Libri planifikohej të dilte në vitin jubilar, sado që ishte paraparë në fillim të vitit 2017. Por për shkak të vonesave në tenderimin e shtypshkronjës, dorë-shkrimi u dërgua në shtyp në janar, 2017.

4. Revista Studime – Në fillim të 2016-ës doli numri 22 i revistës “Studime” me artikuj e studime të emrave të njohur nga gjuhësia e letërsia, me in memoriamin për Hans Jurgen Sasse, albanologun, arvanitologun e njohur dhe me rubrikat e përhershme me kritika e recensione të botimeve të ndryshme. Një pjesë të revistës zunë materialet e Tryezës shkencore Zhvillimet e reja në letërsinë shqiptare, të organizuar nga SGJL dhe të mbajtur me 15 qershor 2015. Gjatë kësaj kohe janë mbledhur një numër materialesh të tjera, të cilët janë në proces redaktimi për numrin 23 që parashihet të dalë nga muaji shkurt 2017. Në këtë numër do të inkuadrohen edhe materialet e tryezës shkencore kushtuar 100 vjetorit të lindjes së Esad Mekulit, mbajtur me 6 dhjetor 2016.

Sekretar i Seksionit

Akademik Eqrem Basha d.v.

IV. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. –

Puna rreth Fjalorit Enciklopedik po shkon drejt finalizimit. Ka përfunduar hartimi i zërave në të gjitha fushat. Janë bashkuar në një dorëshkrim sipas renditjes alfabetike. Ka përfunduar dhe dora e parë e redaktimit. Është kryer lektura e materialit. Një draft prej rreth 200 faqesh është shtypur dhe u është shpërndarë redaktorëve të fushave dhe anëtarëve të Akademisë. Në muajin dhjetor në Durrës është realizuar takimi i fundit i redaktorëve të fushave me redaksinë qendrore ku janë diskutuar vërejtjet dhe janë kërkuar ndërhyrjet finale. Janë zhvilluar edhe diskutimet në seksione me redaksinë qendrore. Në proces janë raportimet e fundit të vërejtjeve e sugjerimeve që kanë anëtarët e Akademisë dhe redaksitë e fushave, diskutohen detajet, mungesat eventuale, bëhen harmonizimet, krahasimet e teksteve ndërmjet fushave të veçanta, për të përafuar veprimet deri te version final.

TUBIME SHKENCORE

1. Tryezë Shkencore: “100-vjet nga vrasja e Isa Boletinit”. Tryeza Shkencore është organizuar në bazë të Protokollit për bashkëpunim midis ASHAK dhe ASHSH. Është përgatitur dhe realizuar me përkujdesjen e Këshillit Organizues me 25 nëntor 2016. Fjalën e hapjes e mbajti Anton K. Berishaj, ndërsa me kumtesa u paraqiten tetë referues të cilët elaboruan fakte dhe të dhëna historike për veprimtarinë politike e luftarake të kësaj figure të veçantë të historisë tonë kombëtare. Tryeza shqyrtoi

aspekte nga jeta dhe vepra e Isa Boletinit; vendin që zë ai në historinë kombëtare; për rolin e tij në kryengritjen e vitit 1912; për kontributin e tij për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë; për vlerësimet dhe trajtimin e tij në dokumentet arkivore të kohës; për prezencën e tij në tekstet mësimore dhe për shumë aspekte tjera që lidhen me emrin e Isa Boletinit. Pas kumtesave u bënë diskutime të frytshme lidhur me temën bosht, ndërsa në fjalën e mbylljes kryetari i K. Organizues i falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe kërkoi nga ata që kumtesat t'i dërgojnë për botim.

2. Tryezë Shkencore: “Për Migrimet” Tryeza u mbajt më 15 dhjetor 2016. Përveç fjalës së hapjes, mbajtur nga akademik Anton K. Berishaj, kryetari i Këshillit organizativ, tetë referues prezantuan rezultatet e tyre lidhur me këto çështje: faktorët në migrimet e jashtme; aspekte etnografike të migrimit të brendshëm; rolin e diasporës shqiptare në Kosovë; analizën gjeografike të zonave migruese në regjion; migrimet e popullsisë kosovare dhe asaj të Luginës së Preshevës si dhe probleme tjera interesante nga kjo fushë-veprimtari. Pas kumtesave pati edhe diskutime të frytshme për temën bosht. Kryetari i Këshillit organizativ, në mbyllje të tryezës e cilësoi temën e trajtuar me interes të veçantë dhe mjaft të suksesshme. Ai kërkoi nga pjesëmarrësit që t'i përgatisin dhe t'i dërgojnë kumtesat e tyre për botim.

3. Tryezë shkencore:

“Bashkëpunimi ekonomik rajonal: sfidat dhe perspektivat”- Problemet e zhvillimit të strukturës ekonomike të Kosovës shpijnë në domosdoshmërinë e lidhjeve më të forta ekonomike me trojet shqiptare dhe vendet fqinje. Këto lidhje për Republikën e Kosovës kanë rendësi jo vetëm ekonomike, por edhe politike, sepse nëpërmjet tyre do të arriheshin objektivat më të gjera socio-politike. Një tryezë, në këtë temë do të tubonte disa studiues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Presheva e Bujanovci dhe nga Mali i Zi, për të prezantuar pikëpamjet e tyre lidhur me kushtet dhe me mundësitë e integritimeve dhe rritjes së komplementaritetit të ekonomive të këtyre vendeve dhe rajonit. Tryeza do të mbahet në gjysmën e dytë të këtij viti.

BOTIME

1. Anton K. Berishaj: “Virgjërat e përbetuara- Jeta ndërmjet detyrimit dhe vetëfljimit”.- Dorëshkrimi është botuar.

2. Muhamed Mufaku: “Nga historia e shqiptarëve të Egjiptit gjatë shekujve XV-XX”.- Dorëshkrimi është botuar.

3. Muhamedin Kullashi: “Dy gje-analogji të modernitetit”.- Dorëshkrimi është botuar.

4. Tryezë Shkencore: “Investimet e huaja direkte në Kosovë”.- Kontributet autoriale të tryezës në fjalë janë botuar në vëllim të veçantë.

5. Blerim Latifi: “Metafizika e emancipimit-Ideja e emancipimit të njeriut në historinë e mendimit perëndimor”.- Dorëshkrimi është botuar.

6. Arsim Bajrami: “Fjalori me

terminologji kushtetuese dhe parlamentare”.- Pritet të del nga shtypi.

7. Edi Shukriu: “Studimet e Dardanisë-Kulti i Diellit, përkrenarja ilire, monumentet epigrafiqe, shan-donet paleokristiane dhe aspektet e zhvillimeve ekonomike, arkeologjike, letrare dhe të antropologjisë fizike”. Pritet të del nga shtypi.

8. Shemsi Krasniqi: “Ekokultura, natyra në kulturën popullore shqiptare”.- Pritet të del nga shtypi.

9. Jusuf Bajraktari: “Bajram Curri në dokumentet arkivore”.- Vëllimi me dokumente arkivore trajton rolin dhe veprimtarinë politike e ushtarake të Bajram Currit për pavarësinë dhe konsolidimin e shtetit shqiptar dhe çështjen e Kosovës. Është një material me vlerë dhe me interes burimor. Ai paraqet një begati faktografike për njohjen sa më të gjithanshme të ngjarjeve e të personaliteteve që kanë bashkëvepruar me Bajram Currin në periudhën midis viteve 1912 deri më 1925, kur ai u vra. Puna rreth mbarështrimit dhe përkthimit të dokumenteve vazhdon dhe pritet të përgatitet për botim këtë vit.

10. Ferhmi Rexhepi dhe Frashër Demaj: “Çështja shqiptare sipas burimeve britanike dhe austro-hungareze në prag të Luftës së Parë Botërore (1912-1914)”.- Autorët po përgatisin për botim një dorëshkrim i cili trajton periudhën historike pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe copëtimit të trojeve shqiptare. Do të analizojnë kohën e zhvillimit të shumë ngjarjeve, përpjekjeve dhe kryengritjeve shqiptare posaçërisht në

Kosovë, të cilat janë pasqyruar nga burimet diplomatike britanike dhe austro-hungareze. Dorëshkrimi është në përgatitje e sipër dhe pritet të botohet në vitin 2017.

11. Revista Studime Shoqërore 3 është botuar.

Ky numër i revistës është mjaft i pasur. Ka 18 artikuj shkencor të autorëve nga lëmi i kësaj fushë veprimtarie; pesë autorë që prezantojnë promovimet e botimeve të shkencave shoqërore; tre autorë që në vështrimet e tyre trajtojnë tema të përvjetorëve të ndryshme; tre autorë kanë shkruar recensionet për veprat e botuara dhe pesë autorë u kanë kushtuar artikuj përkujtimorë pesë shkençtarëve nga kjo fushë veprimtari.

Sekretar i Seksionit

Akademik Jusuf Bajraktari d.v.

V. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Puna rreth Fjalorit Enciklopedik po shkon drejt finalizimit. Ka përfunduar hartimi i zërave në të gjitha fushat. Janë bashkuar në një dorëshkrim sipas renditjes alfabetike. Ka përfunduar dhe dora e parë e redaktimit. Është kryer lektura e materialit. Një draft prej rreth 2020 faqesh është shtypur dhe shpërndarë redaktorëve të fushave dhe anëtarëve të Akademisë. Në muajin dhjetor është realizuar takimi i fundit i redaktorëve të fushave

me redaksinë qendrore në Durrës ku janë diskutuar vërejtjet dhe janë kërkuar ndërhyrjet finale. Janë zhvilluar edhe diskutimet në seksione me redaksinë qendrore. Në proces janë raportimet e fundit të vërejtjeve e sugjerimeve që kanë anëtarët e Akademisë dhe redaksitë e fushave, diskutohen detajet, mungesat eventuale, bëhen harmonizimet, krahasimet e teksteve ndërmjet fushave të veçanta, për të përafëruar veprimet deri te version final.

2. Kadastro i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë të kundërt). - Ky projekt i takon kimisë së mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Projektin udhëhiqet nga akademik Nexhat Daci. Trajtimi i ujërave mund të ndahet në tri kategori kryesore: Pastrimi për nevojat shtëpiake, trajtimi për përdorime speciale industriale si dhe trajtimi i ujërave hedhurinë për t'i bërë ato të pranueshme për lirim në recipient apo ripërdorim. Trajtimi i ujërave hedhurinë të shkarkimeve industriale gjatë shekullit të kaluar është bërë me metoda kimike, fiziko-kimike dhe biologjike. Substancat e përdorura për këtë qëllim kanë liruara llaçe të cilat kanë paraqitur problem mjedisor për shkak të përmbajtjes së specieve metalike, herbicideve, pesticideve apo fenolëve. Projektin është duke u realizuar sipas dinamikës së paraparë me programin e punës dhe përmbajtjen e aprovuar të projektit. Deri më tani, në vitin 2016 është bërë trajtimi i ujërave kryesisht me absorbent bimor dhe tretësirat standarde të

metaleve të rënda dhe osmozë të kundërt. Lidhur me punën e kryer në vitin e parë, me kohë është dhënë raport i detajuar për punën njëvjeçare. Projekti është dyvjeçar (do të punohet edhe në vitin 2017).

3. Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës. Ky projekt ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Projekti udhëhiqet nga akademik Fejzullah Krasniqi dhe i njëjti realizohet bashkë me ekipin përkatës profesional. Projekti është duke u realizuar sipas dinamikës së paraparë me programin e punës dhe përmbajtjen e projektit. Në kuadër të aktiviteteve të gjertanishme në vitin e parë të punës është bërë: Realizimi i paraparë i të gjitha vizitave të qendrave të vendit që posedojnë të dhënat e nevojshme për parametrat meteorologjik; Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave për parametrat kryesorë të klimës meteorologjike për qytetet e Republikës së Kosovës dhe atë për qytetet: Prishtinë, Prizren, Pejë dhe Ferizaj dhe disa qytete tjera për vite të caktuara. Përpunimi, analizimi dhe sistemimi (në formën elektronike dhe të lidhur-letër) i të dhënave mbi parametrat kryesorë të klimës, siç janë: Temperatura e ajrit të lagësht, Lagështia e ajrit, dhe Shtypja atmosferike. Analiza dhe përcaktimi projektues i parametrave të klimës për këto qytetet të Kosovës do të paraqesin lehtësi për projektuesit e sistemeve termoteknike për dizajnin e klimës së brendshme të ndërtesave, komfortin termik, eficientë e energjisë dhe janë dëshmi e një niveli teknik të një vendi. Lidhur me punën e

kryer në vitin e parë, me kohë është dhënë raport i detajuar për punën njëvjeçare të ekipit punues. Projekti është dyvjeçar (do të punohet edhe në vitin 2017).

4. Përdorimi i teknologjive të reja në studimin e problemeve të mjedisit. Projekti është në kuadër të Protokollit të bashkëpunimit (2015-2017) të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës (ASHAK) me Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë (ASHSH). Nga ASHAK projekti udhëhiqet nga akademik Nexhat Daci ndërsa bashkëpunëtorë të projektit janë të gjithë anëtarët e Seksionit të SHN. Takimi i parë i punës me përfaqësuesit e ASHSH është mbajtur në mjediset e ASHAK në Prishtinë më 27.10.2016. Projekti është në vazhdim.

BOTIME

1. Isuf Krasniqi, Bahri Prebreza: “ Zbrazjet atmosferike.- Kjo vepër ishte e paraparë të botohet në vitin 2016. Zbrazjet atmosferike kanë shkaktuar frikë dhe rrezik të përhershëm për jetën e njeriut. Mënyra se si grumbullohen ngarkesat elektrostatike në hapësirë dhe në sipërfaqe të tokës, si paraqitet ky elektricitet dhe si zhvillohet procesi fizik deri te paraqitja e rrufesë, kahet e zbrazjeve të rrufesë (nga atmosfera në drejtim të tokës apo nga toka në drejtim të hapësirës), janë objekt parësor i veprës. Dorëshkrimi ka rreth 360 faqe, fonti 12, në Times New Roman. Në mbledhjen e datës 26.10.2016 të Seksionit të SHN janë caktuar recensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit në përbërje: akademik

Nexhat Daci dhe akademik Fejzullah Krasniqi. Seksioni i Shkencave të Natyrës në mbledhjen e dt. 30 Nëntor 2016 e ka miratuar dorëshkrimin për botim dhe ai tani ndodhet në procedurë të botimit.

2. Salih Gashi. “Osmoza e kundërt”. Objektivi i kësaj vepre shkencore është ofrimi i njohurive teorike dhe praktike inxhinierëve, shkencëtarëve, operatorëve të procesit, studiuesve dhe të gjithë atyre që merren dhe do të merren me studimin dhe zbatimin osmozës së kundërt në mënyrë që pa vështirësi t’i zbatojnë idetë e tyre në avancimin dhe përsosjes së saj. Kjo vepër ishte e paraparë të botohet në vitin 2015. Për shkak të kompleksitetit të saj, me propozimin e autorit, vepra është shtyrë për botim në vitin 2016. Këtë vit, është dorëzuar dorëshkrimi i përgatitur në rreth 350 faqe, fonti 12, në Times New Roman. Në mbledhjen e datës 26.10.2016 të Seksionit të SHN janë caktuar recensuesit për vlerësimin e dorëshkrimit të kësaj vepre në përbërje: akademik Nexhat Daci dhe akademik Fejzullah Krasniqi. Seksioni i Shkencave të Natyrës në mbledhjen e dt. 30 Nëntor 2016 e ka miratuar recensionin e paraqitur nga recensuesit. Dorëshkrimi ndodhet në procedurë të botimit.

3. Arsim Ejupi: Natyra e luginës së Preshevës-Struktura, determinantet dhe resurset natyrore”: Kjo vepër ofron një pasqyrim të kompletuar mbi kushtet dhe resurset natyrore të regjionit të Luginës së Preshevës. Në të analizohen parametrat e ndryshëm natyrorë siç janë: relievi, ujërat, klima,

toka, ndërtimi gjeologjik, bimësia si komponentë që mundësojnë shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, si dhe mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor. Seksioni i Shkencave të Natyrës në mbledhjen e dt. 12.10.2016 ka caktuar recensuesit në përbërje: akademik Nexhat Daci dhe akademik Hivzi Islami për vlerësimin e dorëshkrimit. Dorëshkrimi është miratuar për botim dhe është në proces të shtypjes.

4. Revista “Kërkime” nr.22- Revista boton tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave tjera fundamentale. Sikur edhe deri më tani, edhe në këtë numër të revistës janë punime shkencore të anëtarëve të seksionit të SHN si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm pas vlerësimit profesional nga recensuesit të cilët i cakton redaksia e revistës. Në këtë numër janë përfshi edhe in memoriam për Akademik Latif Susurin dhe Anëtarin korrespondent Ruzhdi Pllana. Revista “Kërkime” nr.22 është kompletuar dhe tani ndodhet në procedurë të botimit.

LIGJËRATA

Ligjërata të ndërsjella të akademikëve (ASHAK-ASHSH) nuk ka pasur.

PROMOVIME

Promovim të veprave të anëtarëve të Akademisë gjatë vitit 2016 nuk ka pasur.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

VI. SEKSIONI I ARTEVE

PROJEKTE

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës-Projekt i përbashkët i të gjitha seksioneve.

Puna rreth Fjalorit Enciklopedik po shkon drejt finalizimit. Ka përfunduar hartimi i zërave në të gjitha fushat. Janë bashkuar në një dorëshkrim sipas renditjes alfabetike. Ka përfunduar dhe dora e parë e redaktimit. Është kryer lektura e materialit. Një draft prej rreth 2020 faqesh është shtypur dhe shpërndarë redaktorëve të fushave dhe anëtarëve të Akademisë. Në muajin dhjetor është realizuar takimi i fundit i redaktorëve të fushave me redaksinë qendrore në Durrës ku janë diskutuar vërejtjet dhe janë kërkuar ndërhyrjet finale. Janë zhvilluar edhe diskutimet në seksione me redaksinë qendrore. Në proces janë raportimet e fundit të vërejtjeve e sugjerimeve që kanë anëtarët e Akademisë dhe redaksitë e fushave, diskutohen detajet, mungesat eventuale, bëhen harmonizimet, krahasimet e teksteve ndërmjet fushave të veçanta, për të përafuar veprimet deri te version final.

BOTIME

1. Zeqirja Ballata: “Tri vepra orkestrale” (titull pune).

Suita/Passacaglia/Capriccio, kompozuar në fillim të gjysmës së 2-të të viteve 60 (1966-67) në Slloveni, përfaqësojnë një si triptik orkestral, me formë mjaft të qartë e të

qëndrueshme, si dhe me një gjuhë bashkëkohore për kohën kur janë kompozuar.

Sado që janë krijuar (krahas veprave tjera të autorit solistike, vokale, kamerale, vokalo-instrumentale, këngët solo) gjatë periudhës së parë të krijimtarisë së tij, qysh atëherë janë vlerësuar edhe nga kritika profesionale që ngërthejnë më vete një teknikë dhe gjuhë bashkëkohore.

Gjithashtu janë emetuar, ekzekutuar apo prezantuar në koncerte dhe festivale të ndryshme (ndër)kombetare, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipëri, Slloveni, Kroaci...

Dorëshkrimi është dorëzuar, por për shkak të disa ndërhyrjeve të nevojshme në përkrahimin e notave, autori është duke punuar prapë në të. Pritet të dorëzohet së shpejti për botim.

2. Ibrahim Kodra-Monografi. Ka dalë botimi.

EKSPOZITA

1. Ekspozita e anëtarit korrëspondent Luan Mulliqi.

Ekspozita është mbajtur më 17 tetor 2016. Në të autori ka përfshirë rreth 40 vepra skulpturore të realizuara në materiale të ndryshme: bronz, dru, mermer etj. Koncepti artistik i ekspozitës është frymëzuar nga trashëgimia jonë kulturore.

KONCERTE

Më 18 tetor 2016 në Tiranë është mbajtur Koncert i përbashkët veprash kamerale-muzikë dhome i paraparë në

Protokollin e bashkëpunimit ASHAK-ASHSH.

Në orët e paradites është mbajtur “Tribunë muzikologjike” kushtuar jetës dhe krijimtarisë së kompozitorit dhe Akademikut Zeqirja BALLATA dhe “Ekspozitë e botimeve muzikore” të Akademikut Zeqirja BALLATA.” Ndërsa në mbrëmje është mbajtur “Koncert me muzikë dhome” poashtu me vepra të kompozitorit dhe akademikut Zeqirja Ballata.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Luan Mulliqi
d.v.

VII. SHËRBIMI, PROFESIONAL, ADMINISTRATIV E TEKNIK

Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik (SHPAT) i ASHAK, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale, administrative e teknike u angazhua dhe punoi në realizimin e Programit të punës të Akademisë.

Departamenti për buxhet dhe financa –DBF

Gjatë vitit 2016 ka kryer punët financiare që lidhen me aktivitetet e planifikuara me Programin e punës së ASHAK.

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës ishte në vlerë totale prej 1,084,851.00 €, nga të cilat në kategorinë paga e mëditje janë ndarë 754,908.00 €, në kategorinë

mallra e shërbime 324,943.00 € dhe në kategorinë shpenzime komunale 5,000.00 €.

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 ka pasur ndryshime me Rishikimin e Buxhetit për vitin 2016, në vlerë totale prej 110,00.00 €, nga të cilat në kategorinë paga dhe mëditje janë deklaruar si kursime nga ASHAK 40,000.00 €, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime, po ashtu me kërkesë të ASHAK janë aprovuar mjetet shtesë në vlerë prej 150,000.00 € për projektin Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Si rezultat i këtyre ndryshimeve në bazë të Ligjit për rishikimin e buxhetit për vitin 2016, vlera totale e buxhetit ishte 1,194,851.00 €. Kategoria paga e mëditje 714,908.00 €, mallra e shërbime 474,943.00 € dhe shpenzime komunale 5,000.00 €.

Buxheti përfundimtar i alokuar dhe në dispozicion të ASHAK-ut, kishte vlerë totale prej 1,142,501.42 €, prej të cilave në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishin 685,998.50 €, mallra e shërbime 453,321.64 € dhe në shpenzime komunale 3,181.28 €. Buxheti final është rezultat i Vendimit të Qeverisë Nr.1/123 për shkurtime buxhetore në kategoritë ekonomike.

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, ASHAK, ka pasur depozita mjetesh në vitin 2016 nga Marigona Residence në vlerë prej 3,000.00 € dhe nga Salbatring Internacional, në vlerë prej 14,022.32. Mjetet në vlerë prej 3,000.00 € nga Marigona Residence janë shpenzuar për “Shpërblimin

Mbështetës 2016”, ndërsa nga 14,022.32 €, të donacionit nga Salbatring Internacional janë shpenzuar mjetet në vlerë prej 2,392.20 €, për blerjen e veprave shkencore, nga lëmi i shkencave të natyrës.

Nga Buxheti i Akademisë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, në të gjitha kategoritë ekonomike është alokuar shuma në total prej 1,142,501.42 €. Megjithatë as alokimi e as dinamika e shpenzimeve nuk janë bërë sipas planit fillestar të rrjedhjes së parasë, si pasojë e ndryshimeve të bëra përmes rishikimit dhe shkurtimeve buxhetore.

Po ashtu gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2016, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ka grumbulluar të hyra qeveritare, në vlerë totale prej 10,219.70 € (nga shitja e botimeve të saj në vlerë prej 9,557.70 €, dhe nga siguria e ekzekutimit të një tenderi 662.00 €.

Departamenti i Përkrahjes Profesionale dhe i Teknologjisë së Informacionit e Komunikimeve – DPPTIK

DPPTIK-u përgjegjës për ofrimin e shërbimeve profesionale të teknologjisë së informacionit e komunikimeve, dhe të veprimtarisë botuese:

1. Përpunoi rreth 564 tabakë shtypi (8928 faqe), dhe organizoi botimin e 9 titujve të librave, të 1 reviste shkencore me separatë dhe të Vjetarit 2015, me rreth 3400 kopje, si dhe përgatiti për shtyp 10 tituj të tjerë me rreth 4741, si dhe rreth 2100 faqe të maketit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës;

2. Përllogariti tabakët e autorit dhe

tabakët e shtypit për 21 tituj;

3. Përkrahu profesionalisht punën e akademikëve dhe të Administratës. Në bashkërenditje me shërbimet e tjera të ASHAK-ut, DPPTIK-u përkrahu profesionalisht drejtpërsdrejti 18 (tetëmbëdhjetë) aktivitete akademike e shkencore (konferenca, tubime, tryeza shkencore, ekspozita, koncerte, nënshkrime marrëveshjes, takime mes akademive, ndarje shpërblimesh, panairë librash, ligjërata, mbledhje komemorative etj.);

4. Përgatiti specifikimet teknike dhe inicioi 16 aktivitete prokurimi, gjegjësisht 72% të të gjitha kërkesave të prokurimit të ASHAK-ut;

5. Përgatiti, llogariti dhe shtypi 468 kontrata të hartuesve të zërave të Fjalorit enciklopedik;

6. Me përpjekje të vazhdueshme për ndërtimin dhe mbindërtimin e kapaciteteve lokale profesionale zbatoi metodat e përkrahjes së drejtpërdrejtë dhe të bashkëpunimit të ndërsjellët dhe të baraspeshuar me akademikët, dhe me departamentet e tjera, si edhe me Operatorët ekonomikë të jashtëm duke e përmirësuar dhe ngritur vazhdueshëm cilësinë e shërbimeve teknike profesionale dhe të shërbimeve të tjera të përkrahjes profesionale;

7. Vazhdoi me organizimin dhe rregullimin e depos së Librit si dhe të materialit tjetër harxhues të nevojshëm për funksionimin normal të Administratës dhe Akademisë;

8. E mbikëqyri dhe u përkujdes për funksionimin normal të shërbimeve të TIK-ut dhe Multimedive, si dhe për

funksionimin normal të faqes ueb duke e populluar atë me të dhënat e përditësuara. Ja doli të bëjë funksionalizimin e plotë të accesspoint-ve në tërë mjedisin e Akademisë. Organizoi dhe mbikëqyri edhe mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të shërbimeve logjistike për Administratën dhe Akademinë;

9. Vazhdoi të kontribuojë në standardizimin e dizajnit të Librit të ASHAK-ut, dhe përgatiti specifikimet teknike të produkteve të veçanta të nevojshme për punën e ASHAK-ut;

10. Punoi në drejtim të përgatitjes profesionale të shkresave zyrtare duke ndihmuar me gjedhet përkatëse dhe me udhëzimet profesionale;

11. Ndihmoi punën e QLE-së duke bërë skanimin e mijëra faqeve të librave dhe revistave të vjetra të parastandardit të nevojshme për projektin Shqipja e shekullit XX;

12. Mori pjesë në përgatitjen e rregulloreve të reja;

13. Mori pjesë në të gjitha aktivitetet profesionale të Administratës dhe të ASHAK-ut: nëpër komisione profesionale, të rekrutimit, të pranimit të mallit, të përcaktimit të cilësisë etj.

Departamenti i Bibliotekës dhe Arkivit DBA

Gjatë vitit 2016, kanë vazhduar punët rreth mirëmbajtjes dhe riorganizimit të bibliotekës. Është aranzhuar i gjithë fondi bibliotekar dhe ka përfunduar regjistrimi i të gjithë fondit bibliotekar ekzistues. Ka vazhduar regjistrimi dhe rikuperimi i fondit të mbetur të librave, revistave dhe vjetarëve.

Janë lidhur gazetat Koha Ditore dhe Zëri të viteve 2014-2015 dhe janë vendosur në rafte sipas serive përkatëse. Ka vazhduar blerja e shtypit ditor. Përveç gazetës Koha Ditore dhe Zëri, janë blerë edhe gazetat Bota Sot, Epoka e Re, dhe Kosova Sot. Janë regjistruar dhe në shumicën e rasteve janë fotokopjuar shkrimet që lidhen me Akademinë në të gjitha gazetat.

Janë regjistruar dhe riorganizuar të gjithë periodikët dhe revistat -- kopjet e vjetra dhe te rejat.

Gjatë vitit 2016, botimet e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve e Kosovës janë prezantuar në katër panaire -- Panairi i Prishtinës, Panairi i Tiranës, Panairi i Frankfurtit, dhe Panairi i Parisit. Në dy panairët e para, botimet e ASHAK janë prezantuar nga personeli i Akademisë, ndërsa në dy te tjerët, në pamundësi të pjesëmarrjes, ASHAK ka autorizuar Shoqatën e Botuesve të Kosovës dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës (MKRS), të prezantojë botimet e saj.

Nga data 17- 20 mars 2016, në Paris është mbajtur panairi ndërkombëtar i librit "Salon du livre de Paris" -ngjarje kulturore e madhe në Evropë, në të cilin marrin pjesë mbi 1200 botues nga shumë vende të Evropës. Mbështetur nga MKRS, në këtë ngjarje të rëndësishme kulturore janë prezantuar për herë të parë edhe botues kosovarë, përmes Shoqatës së Botuesve të Kosovës. Në mesin e rreth 120 titujve të botuesve më të njohur të Kosovës, janë prezantuar edhe një numër i konsiderueshëm i botimeve të ASHAK.

Nga data 7-12 qershor, ASHAK ka marrë pjesë në panairin tradicional të librit në Prishtinë, "Prishtina 2016." Edhe kësaj here ASHAK ka pasur prezantim të suksesshëm. Interesimi i vizitorëve ka qene i madh dhe janë shitur rreth 450 botime të ASHAK.

Nga data 9 deri 13 nëntor 2016, në Tiranë është mbajtur Panairi i 19-të ndërkombëtar i librit "Tirana 2016." Në mesin e rreh 80 shtëpive botuese, institucioneve shkencore dhe arsimore nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, dhe Mali i Zi, përfshirë qendrat kulturore të disa nga ambasadave të vendeve të akredituara në Tiranë, me botimet e veta është paraqitur edhe ASHAK. Janë shitur rreth 300 kopje të botimeve, shumica të botuara dy vitet e fundit.

Në Panairin Tirana 2016, Bibliotekës së Kongresit Amerikan, përmes personit të autorizuar nga ata, i janë shitur kopjet e të gjitha botimeve të reja të ASHAK.

Po ashtu në këtë panair janë blerë rreth 60 libra dhe një numër revistash, për Bibliotekën e Akademisë, kryesisht botime të reja dhe të tjera që i kanë munguar Bibliotekës së ASHAK.

Nga data 8-deri 18 tetor është mbajtur Panairi Ndërkombëtar i Frankfurtit, me i madhi i këtij lloji ne Evropë. ASHAK është paraqitur në këtë panair me 20 botimeve të reja. Sikurse në vitet e mëhershme, në pamundësi të pjesëmarrjes, ASHAK ka autorizuar Shoqatën e Botuesve të Kosovës që të prezantojë botimet e saj.

Gjatë vitit 2016, biblioteka e ASHAK është pasuruar me një numër të konsiderueshëm të botimeve përmes këmbimit, dhurimit nga autorët, si dhe blerjes. Biblioteka është pasuruar me gjithsej 818 libra të rinj si dhe një numër të revistave.

Ka vazhduar komunikimi me biblioteka të akademive të ndryshme dhe me institucione kosovare dhe të vendeve të ndryshme të rajonit dhe më gjerë.

Në fund të vitit është nënshkruar marrëveshja për këmbimin e botimeve në mes të ASHAK dhe Qendrës për Studime Albanistike (QSA), Tiranë. Sipas kësaj marrëveshjeje, QSA-së i janë dërguar 225 botime të ASHAK, ndërsa ASHAK ka pranuar 160 botime të QSA.

Në përputhje me Rregulloren mbi Veprimtarinë Botuese të ASHAK, dhe sipas kërkesave nga drejtoritë për arsim të disa komunave të Kosovës dhe bibliotekave, institucioneve shkencore e kulturore u janë dhuruar një numër i konsiderueshëm i botimeve të ASHAK.

Në mungesë të personelit të kualifikuar, nuk ka pasur aktivitete që lidhen drejtpërsëdrejti me arkivin. Disa punë bazike që lidhen me këtë fushë janë kryer nga stafi i Bibliotekës.

Sekretare e Akademisë

Lendita Pula d.v.

RAPORTI I PERFORMANCËS FINANCIARE PËR VITIN 2016

Mjetet e ndara dhe të aprovuara sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2016, për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kanë qenë në vlerë prej 1,084,851.00 € si total në të gjitha kategoritë ekonomike. Buxheti me ndryshime gjatë vitit, sipas kategorive ekonomike, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme:

Buxheti me Ligjin e Buxhetit për vitin 2016:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
754,908.00	324,943.00	5,000.00	0.00	0.00	1,084,851.00

Buxheti pas rishikimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2016:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investime kapitale	Subvencione dhe transfere	Gjithsej
714,908.00	474,943.00	5,000.00	0.00	0.00	1,194,851.00

Buxheti i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016 ka pasur ndryshime me Rishikimin e Buxhetit për vitin 2016, në vlerë totale prej 110,00.00 €, nga të cilat 40,000.00 €, në kategorinë paga dhe mëditje, janë deklaruar nga ASHAK si kursime, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime, me kërkesë të Institucionit tone, janë aprovuar mjetet shtesë në vlerë prej 150,000.00 € për projektin rreth Fjalorit Enciklopedik të Kosovës. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, në bazë të Ligjit për rishikimin e buxhetit për vitin 2016, vlera totale e buxhetit është 1,194,851.00 €, ku prej tyre kategoria paga e mëditje 714,908.00 €, mallra e shërbime 474,943.00 € dhe shpenzime komunale 5,000.00 €.

Buxheti përfundimtar i alokuar sipas SIMFK-së:

Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Investimet kapitale	Subvencionet dhe transferet	Gjithsej
685,998.50	453,321.64	3,181.28	0.00	0.00	1,142,501.42

Nga Buxheti i Akademisë, gjatë periudhës janar-dhjetor 2016, në të gjitha kategoritë ekonomike është alokuar shuma në total prej 1,142,501.42 €. Megjithatë as alokimi e as dinamika e shpenzimeve nuk janë bërë sipas planit fillestar të rrjedhjes së parasë, si pasojë e ndryshimeve të bëra përmes procesit të rishikimit dhe shkurtimeve buxhetore.

Shih tabelat e mëposhtme me sqarime shtesë

BUXHETI I APROVUAR PËR 2016
ALOKIMI DHE REALIZIMI PËR PERIU DHËN JANAR - DHJETOR

Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar 2016 (A)	Buxheti me Rishikim (B)	Alokimet Janar - Dhjetor (C)	Realizimet Janar – Dhjetor (D)	% (D/C)
Paga dhe mëditje	754,908.00	714,908.00	685,998.50	685,998.50	100%
Mallra dhe shërbime	324,943.00	474,943.00	453,321.64	453,321.64	100%
Shpenzime komunale	5,000.00	5,000.00	3,181.28	3,181.28	100%
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	1,084,851.00	1,194,851.00	1,142,501.42	1,142,501.42	100%

Vlera fillestare sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2016 ka qenë 1,084,851.00€. Ndryshimet e paraqitura në ndarjet buxhetore, të vlera fillestare krahasuar me ato finale, reflektojnë procesin e rishikimit të Ligjit të Buxhetit për vitin 2016, dhe Vendimin e Qeverisë nr. 1/123 i datës 28.12.2016.

Alokimet e mjeteve nga buxheti i konsoliduar i Kosovës sipas Planit të rrjedhës së parasë për periudhën Janar – Dhjetor 2016

Mjetet e alokuara në total për periudhën janar – dhjetor kanë qenë në vlerë prej **1,142,501.42 €**

Kategoritë ekonomike	Janar-shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Paga dhe mëditje	519,114.21	56,174.01	55,518.47	55,191.81	685,998.50
Mallra dhe shërbime	422,000.00	51,000.00	1,000.00	-20,678.36	453,321.64
Shpenzime komunale	4,000.00	350.00	450.00	-1,618.72	3,181.28
Subvencione dhe transferet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Gjithsej	945,114.21	107,524.01	56,968.47	32,984.73	1,142,501.42

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2016

Realizimi i buxhetit në bazë të alokimit vjetor ka qenë **1,142,501.42 €**, shprehur në përqindje 100 % i buxhetit të alokuar.

Realizimi i buxhetit pasqyrohet si në vijim:

Kategoritë ekonomike	Alokimet Janar – dhjetor (A)	Realizimi Janar – dhjetor (B)	Ndryshimi (C)	% (B/A)
Paga dhe mëditje	685,998.50	685,998.50	0.00	100%
Mallra dhe shërbime	453,321.64	453,321.64	-21,621.36	100%
Shpenzime komunale	3,181.28	3,181.28	-1,818.72	100%
Subvencione dhe transfere	0.00	0.00	0.00	0.00%
Investime kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00%
Gjithsej	1,142,501.42	1,142,501.42	23,440.08	100%

Ndryshime i paraqitur në kolon C është rezultat i Vendimit të Qeverisë nr.1/123 për shkurtime buxhetore në kategoritë ekonomike (21,621.36 € mallra e shërbime dhe 1,818.72 € shpenzime komunale).

Paga dhe mëditje

Mjetet e alokuara për paga dhe mëditje për vitin 2016 janë në vlerë prej 685,998.50 €, ndërsa numri i aprovuar për personelin e ASHAK-ut është 55.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar - shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Paga dhe mëditje	519,114.21	56,174.01	55,518.47	55,191.81	685,998.50	100%

Realizimi

Muaji	Numri i punëtorëve	Buxheti final në SIMFK	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
Janar	55	60,959.27	60,959.27	60,959.27	0.00
Shkurt	55	60,959.27	60,959.27	60,959.27	0.00
Mars	55	58,309.72	58,309.72	58,309.72	0.00
Prill	55	56,717.76	56,717.76	56,717.76	0.00
Maj	55	56,717.76	56,717.76	56,717.76	0.00
Qershor	55	56,646.28	56,646.28	56,646.28	0.00
Korrik	55	56,321.98	56,321.98	56,321.98	0.00
Gusht	55	56,308.16	56,308.16	56,308.16	0.00
Shtator	55	56,174.01	56,174.01	56,174.01	0.00
Tetor	55	56,174.01	56,174.01	56,174.01	0.00
Nëntor	55	55,518.47	55,518.47	55,518.47	0.00
Dhjetor	55	55,191.81	55,191.81	55,191.81	0.00
Gjithsej	55	685,998.50	685,998.50	685,998.50	0.00

Mallra dhe shërbime

Mjetet e alokuar për mallra dhe shërbime për vitin 2016 janë në vlerë prej 453,321.64 €.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar - shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Mallra dhe Shërbime	422,000.00	51,000.00	1,000.00	-20,678.36	453,321.64	100%

Realizimi

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Zotim Obligimet e hapura (C)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	90,000.00	90,000.00	24,409.06	69,624.71	-4,033.77
2	Shkurt	40,000.00	40,000.00	57,662.21	-33730.70	16,068.49
3	Mars	30,000.00	30,000.00	25,352.76	2,979.88	1,667.36
4	Prill	45,000.00	45,000.00	12,201.53	5,576.14	27,222.33
5	Maj	30,000.00	30,000.00	24,660.11	4,518.74	821.15
6	Qershor	26,000.00	26,000.00	20,034.91	18,957.95	-12,992.86
7	Korrik	10,000.00	10,000.00	29,905.14	-10,660.38	-9244.76
8	Gusht	23,000.00	23,000.00	3,020.60	-495.74	20,475.14
9	Shtator	128,000.00	128,000.00	23,609.99	40,717.61	63,672.40
10	Tetor	51,000.00	51,000.00	75,255.30	-46,104.93	21,849.63
11	Nëntor	1,000.00	1,000.00	86,152.04	20,716.29	-105,868.33
12	Dhjetor	943.00	-20,678.36	71,057.99	-72,099.57	-19,636.78
	Total	474,943.00	453,321.64	453,321.64	0.00	0.00

Shpenzimet për shërbimet komunale

Mjetet e alokuar për shpenzime komunale për vitin 2016 kanë qenë në vlerë prej 3,181.28 €.

Alokimi

Kategoria ekonomike	Janar-shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej	%
Shpenzime komunale	4,000.00	350.00	450.00	-1,618.72	3,181.28	100%

Realizimi ¹

Nr.	Muaji	Buxheti	Alokimi (A)	Realizimi (B)	Ndryshimi (A-B)
1	Janar	500.00	500.00	279.12	220.88
2	Shkurt	450.00	450.00	0.00	450.00
3	Mars	450.00	450.00	524.50	(74.50)
4	Prill	450.00	450.00	258.35	191.65
5	Maj	450.00	450.00	0.00	450.00
6	Qershor	450.00	450.00	171.50	278.50
7	Korrik	450.00	450.00	624.69	-174.69
8	Gusht	350.00	350.00	0.00	350.00
9	Shtator	450.00	450.00	485.87	-35.87
10	Tetor	350.00	350.00	0.00	350.00
11	Nëntor	450.00	450.00	559.40	-387.25
12	Dhjetor	200.00	-1618.72	277.85	-1,618.72
	Gjithsej	5,000.00	3,181.28	3,181.28	0.00

Donacionet – Grantet e donatorëve**Alokimi**

Emri i donatorit	Totali i grantit	Alokimi	Realizimi	Mjetet e lira	%
Salbatring International	14,022.32	14,022.32	2,392.20	11,630.12	17.06%
Marigona rezidence	3,000.00	3,000.00	3,000.00	0.000	100.00%
Gjithsej	17,022.32	17,022.32	5,392.20	11,630.12	31.67%

Përpos mjeteve nga Fondi i Buxhetit të Republikës së Kosovës, ASHAK ka pasur depozita mjeteve në vitin 2016 nga Marigona Rezidenc në vlerë prej 3,000.00 € dhe donacionin e bartura nga viti 2015 nga Salbatring Internacional, në vlerë prej 14,022.32, fond i cili për vitin 2016 ka qenë në vlerë totale prej 17,022.32 €. Nga ky fond janë shpenzuar 3,000.00 € (nga Donacioni i pranuar nga Marigona Rezidence) për “Shpërblimin Mbështetës 2016” dhe 2,392.20 € (nga Salbatring internacional) për pasurimin e bibliotekës me vepra shkencore-blerjen e librave.


¹ Shpenzimet e komunaleve nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës janë bërë vetëm në kodin e telefonisë fikse, shpenzimet tjera komunale i mbulon Ministria e Administratës Publike.

Në dispozicion janë edhe 11,630.12 € në kategorinë e subvencioneve nga donacioni i Salbatring Internacional.

ASHAK ka realizuar edhe të hyra jo tatimore nga shitja e botimeve, të cilat janë depozituar drejtpërsëdrejti në llogarinë e Vetme të Thesarit për përdorim sipas paraqitjes së nevojave për paranë publike.

Realizimi i buxhetit për vitin 2016 ishte në një shkallë optimale, duke mbuluar në mënyrë të kënaqshme aktivitetet shkencore dhe artistike të AShAK-ut.

PROGRAMI I PUNËS SË ASHAK-ut PËR VITIN 2017



I. SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

PROJEKTET

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të Akademisë. Pas përfundimit të fazës së parë të punës, që konsistoi në hartimin e fjalësit, në fazën e dytë u punua kryesisht në hartimin e teksteve të zërave, për mbi 6000 njësitë e përcaktuara. Hartimi i teksteve pritet të përmbyllet në qershor-shtator të vitit 2016. Paralelisht me hartimin e teksteve është kryer redaktura e parë dhe lektura e teksteve për disa fusha të caktuara. Gjatë vitit 2016 mbetet të përfundojë edhe kjo fazë e punës, në të cilën përfshihet edhe redaktura e dytë dhe harmonizimi krahasimtar i teksteve ndërmjet fushave të veçanta. Faza e tretë përfshin botimin pilot të Fjalorit, diskutimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve pas botimit pilot dhe botimin përfundimtar. Botimi pilot pritet të bëhet në fund të vitit 2016 ose në fillim të vitit 2017, diskutimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve 3 muaj pas botimit pilot dhe më pas përzgjedhja e fotografive dhe botimi përfundimtar. Sipas dinamikës së paraparë, Fjalori mund të jetë i gatshëm për botimin përfundimtar gjatë vitit 2017.

2. Këshilli Ndërkademiç për Gjuhën shqipe. – Puna e Këshillit, që ka hyrë edhe në Protokollin e ri të Bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH për vitet 2016/2017, ka ecur me ritme të ngadalësuara. Interesi ynë ka qenë dhe mbetet që puna të

vazhdohet edhe më tutje, sepse duket se kanë mbetur shumë çështje për t'u diskutuar. Një nga shkaqet e zvarritjes së punës mund të jetë mungesa e formave të kompensimit të punës së anëtarëve të grupeve, që konsiderohet si shtysë që mund ta intensifikonte aktivitetin e Këshillit. Pjesëmarrja e Kosovës në këtë Këshill, është thënë dhe më herët, në disa takime ka pasur mungesë anëtarësh për arsye shëndetësore, ndaj pritet që sa më shpejt të shihet mundësia e plotësimit të tij me anëtarë të tjerë dhe të bëhet riformatimi i nevojshëm.

3. Shqipja e shkruar në Kosovë në shekullin XX. – Projekti ka paraparë që brenda vitit 2017 të hartohet fjalësi dhe të bëhej gati për botim. Skanimi, digjitalizimi i materialeve dhe puna rreth Korpusit gjithësesi ka kërkuar angazhime të gjera, me specialistë të fushave si dhe kompletimin e kushteve teknike. Vështirësitë rreth ngritjes së kapaciteteve dhe aftësimit teknik dhe profesional të Qendrës Leksikografike Enciklopedike, para së gjithash sigurimi i skanerëve me performansa të sofistikuar, të domosdoshme për punë, ende nuk janë kapërcyer. Nevoja e riformatimit dhe intensifikimit të punës së projektit na shtyri të kërkojmë nga akademik Rexhep Ismajli një platformë të rishikuar, të cilën ai e hartoi me propozime për ndryshimet e nevojshme në këtë fazë, të cilat po i sjellim në Aneks të këtij Programi pune.

4. Vepra e plotë e Norbert Joklit. – Deri tash ka dalë vetëm vepra e parë e albanologut austriak. Ka qenë e

paraparë që gjatë vitit 2016 të botohet vëllimi i dytë “Hulumtime linguistike – kulturo-historike në fushë të shqipës” por ai vonon për shkak se përkthimi i Anton Krajnit ka mungesë pjesësh, ndaj është i domosdoshëm krahasimi me origjinalin dhe plotësimi i tekstit. Problemet paraqiten tek shenjat e grafitë. Andaj ky botim do të përcillet në vitin 2017 duke konsideruar se brenda vitit 2016 do të finalizohet për botim dhe do të përcillet në shtyp një vëllim tjetër, me studime dhe artikuj, duke qenë se përkthyesi Skënder Gashi tashmë ka përfunduar disa pjesë dhe i ka dorëzuar, disa artikuj të tjerë janë radhatur dhe mund të jenë gati më shpejt. Projekti do të vazhdojë edhe me mbledhjen, sistemimin, përkthimin dhe botimin e kontributëve të tjera të Norbert Joklit me qëllim që vepra e tij të dalë sa më e plotë, për çka kemi edhe ndihmën e Akademisë austriake.

TUBIMET SHKENCORE

1. 100 vjetori i lindjes së Idriz Ajetit. – Konferencë shkencore. Në qershor të vitit 2017 akademik Idriz Ajeti mbush 100 vjet. Është një rast i veçantë që Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe ASHAK-u ta shënojë këtë përvjetor të jashtëzakonshëm në praninë e tij. Konsiderojmë se është e nevojshme të organizohet një Konferencë shkencore, në të cilën do të marrin pjesë studiuesit e veprës së njërës nga albanologët më të shquar të kohës sonë. Ky aktivitet është dhe pjesë e Protokollit të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, por bartëse e projektit do të

jetë ASHAK. Gjithashtu do të jetë më se e nevojshme që brenda qershorit të vitit 2016, ose më së largu në fillim të shtatorit, të formohet një Këshill organizues i cili do të propozojë programin e shënimit të këtij përvjetori jo vetëm me Konferencën shkencore por edhe me aktivitetet e tjera eventuale përcjellëse dhe ta paraqesë atë para Seksionit.

2. Studimet për shqipen në vendet gjermanishtfolëse. – Konferencë shkencore. Siç u pa me rastin e konferencës për Studimet albanistike në Amerikë, që rezultoi me një vëllim studimesh me vlerë prej rreth 700 faqesh, është e nevojshme të shqyrtohen në mënyrë komplekse gjendja e studimeve dhe rezultatet e shënuara për hulumtimet për gjuhën shqipe në traditat e ndryshme. Vendet gjermanishtfolëse tradicionalisht kanë qenë vendet dhe kulturat ku albanistika dhe albanologjia në përgjithësi kanë gjetur hapësirën më të madhe të studimit qysh nga shekulli XIX. Në Gjermani, në Austri, më vonë edhe në Zvicër, janë realizuar studime të gjithanshme për gjuhën, për kulturën, për historinë, për etnologjinë dhe për botën shqiptare. Shumë shpesh nëpër institucione dhe nga studiues të specializuar për gjuhët romane, për sllavistikë, për gjuhësi të krahasuar, janë zhvilluar studime të mirëfillta shqiptare, por atje kanë vepruar edhe institucione, katedra dhe sektorë në kuadër të njësive akademike të universiteteve që janë marrë me shqipen dhe shqiptarët. Në shekullin XIX dhe në pjesën e parë të shekullit XX, kur në botën shqiptare

kishte pak mundësi për këto studime, në botën gjermanishtfolëse janë realizuar e botuar studimet më të rëndësishme për gjuhën shqipe, por ato nuk kanë pushuar as pas krijimit të qendrave të mëdha vendore të studimeve albanologjike në Shqipëri e në Kosovë. Sot shtrohet nevoja e bashkërendimit sa më të mirë të këtyre studimeve dhe të punës së studiuesve të kësaj bote me studiuesit dhe institucionet shqiptare. Promovimi i studimeve shqiptare në botën gjermanishtfolëse sa vjen e shtohet edhe për faktin se në dekadat e fundit është shtuar ndjeshëm prania e popullatës shqiptare në ato hapësira dhe interesi për shqiptarët është në rritje.

Për të gjitha këto arsye është menduar të organizohet një konferencë shkencore ndërkombëtare, që është parashikuar edhe në protokollin e bashkëpunimit me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, ndërsa tash jemi në bisedime me Akademinë e Shkencave të Austrisë për përfshirjen eventuale të saj si bashkorganizuese. Konferenca do të mbahet në Prishtinë në tetor ose nëntor të vitit 2017 dhe do të ketë pjesëmarrës nga Kosova, Shqipëria, hapësirat shqiptare në Ballkan dhe bota gjermanishtfolëse. Bartës kryesor i organizimit do të jetë ASHAK-u.

BOTIMET

1. Norbert Jokl, Hulumtime lingvistike-kulturohistorike në fushë të shqipes. - E botuar më 1923, kryevepra e albanologut austriak Norbert

Jokl është me rëndësi të dorës së parë për studimet etimologjike dhe për shumë çështje të tjera të domoshme për studimin e historisë së gjuhës shqipe. Përkthimi në shqip nga Anton Krajni është realizuar në vitet '50 të shekullit XX, në gegërishten e atëhershme letrare. Në tekstin e përkthyer shpesh ka mungesa pjesësh, prandaj është dashur të bëhen krahasimet me origjinalin. Në këtë botim, pranë tekstit shqip, do të jepet edhe teksti gjermanisht i skanuar, në mënyrë që specialistët të mund t'i referohen burimit.

2. Rexhep Ismajli, Studime për shqipen standarde në kontekste të reja (titull pune). - Akademik Rexhep Ismajli ka dorëzuar me shkrim një projektion të veprës që e ka në dorë dhe që pritet ta finalizojë së shpejti. Ai parashihet që dorëshkrimi të ketë rreth 300 faqe dhe në të do të përfshihen diskutimet për hapësirat e përdorimit të shqipes standarde dhe për varietetet e ndryshme të saj, për problemet që dalin në këtë fushë për studimin, por edhe për rregullimin e normave, për raportet midis gjuhës standarde të shkruar dhe të folur. Diskutimi do të marrë në vështrim problemet dhe fenomenet që shfaqen në hapësira të ndryshme të përdorimit të shqipes standarde me një vështrim më parë sociolinguistik, duke mbajtur parasysh në radhë të parë shqyrtimet për mundësitë e harmonizimit dhe të zgjidhjes së tyre. Për këtë arsye pjesë e dorëshkrimit do të jetë shqyrtimi krahasues me situatat e ngjashme në botën frankofone dhe në botën gjermanishtfolëse. Pjesë e dorëshkrim-

it do të jenë dhe studimet për këtë problematikë në revista apo përmbledhje të specializuara ashtu si një historik i KNGJSH-së. Dorëshkrimi parashihet të jetë gati të pranverë të vitit 2017.

3. Ali Aliu, Studime dhe kritika letrare (titull pune). - Libri do të përmbajë studime, artikuj, kritika letrare, të botuara në shtypin e përditshëm dhe periodik apo të paraqitura në aktivitete shkencore, tryeza e konferenca, si dhe studime të papublikuara më parë. Vëmendja e akademik Aliut në këtë vëllim i kushtohet kryesisht autorëve, letrarëve, bashkëkohorë shqiptarë, veprave konkrete të tyre, apo lëvizjeve dhe fenomeneve të reja në letërsinë shqipe. Vëllimi parashihet të ketë rreth 250 faqe dhe mund të jetë gati në pranverën e vitit 2017.

4. Shaban Demiraj Studime për gjuhën shqipe (titull pune). - Në serinë e librave të albanologëve të mëdhenj, ku janë botuar Pedersen, Jokl, Cimohovski, Buda, Çabej, etj. këtë vit planifikojmë një libër me studime të zgjedhura të studiuesit, albanologut Shaban Demiraj, ish kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Përzgjedhjen konsiderojmë se duhet t'ia besojmë Bardhyl Demirajt, profesor i gjuhës shqipe në Universitetin e Mynihut, i biri i autorit, gjithashtu gjuhëtar dhe studiues i shquar që, s'do mend, e njeh më së miri veprën e akademik Demirajt. Libri do të ketë rreth 300-350 faqe dhe

besojmë se do të jetë gati për shtyp në pjesën e parë të vitit 2017.

5. Sabri Hamiti, Lirika shqipe, interpretim dhe lexim i lirikës shqipe të tre shekujve të fundit.- Trajtim i lirikës si përqendrim i artit letrar. Dramatizim i aktit krijues të kalimit të imagjinimit në ligjërim letrar individual. Përqendrim te lirikët dhe kryeveprat e tyre, të paraqitura në rrjedhë të kohës e në transformime të shkrimit poetik duke shprishur rregullat e duke synuar rregulla të reja. Dialog krijues me poetët e veprat e tyre: Pjetër Bogradani, Kangët e Sibilave; Jeronim de Rada, Milosao; Zef Serembe, Vjersha; Naim Frashëri, Lulet e verës; Zef Skiroi, Mino; Ndre Mjedja, Juvenilia; Lasgush Poradeci, Ylli i zemrës; Millosh Gjergj Nikolla, Vargjet e lira; Martin Camaj, Një fyell ndër male; Rrahman Dedaj, Baladë e fshehur; Eqrem Basha, Balada e zezë; etj. Libri do të ketë rreth 200 faqe dhe do të jetë gati për shtyp nga fundi i vitit 2017.

6. Ndre Mjeda në 150 vjetorin e lindjes. - Materialet e konferencës shkencore. Konferenca është e planifikuar të mbahet në gjysmën e shtatorit të vitit 2016 dhe gjykuar sipas interesimit të pjesëmarrësve të ftuar në kohën kur po hartohet ky program, do të sjell materiale të bollshme për një vëllim që do ta rrumubullakësojë gjithë aktivitetin për shënimin e këtij jubileu të rëndësishëm. Materialet do të mbledhen dhe do të sistemohen deri në fund të vitit 2016 dhe mund të jenë të gatshme në muajt e parë të vitit 2017.

7. Revista "Studime" nr. 24. – Edhe

ky numër i revistës “Studime”, që e boton Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, do të realizohet si zakonisht në fund të vitit 2017 dhe do të sjellë kontributet e zakonshme, studime e artikuj nga fusha e gjuhësisë dhe e letërsisë, në shqip dhe në gjuhë të tjera të botës, recensione, kronika dhe paraqitje botimesh të reja. Varësisht nga materialet e konferencave ose tryezave shkencore, revista mund t’i përfshijë edhe kumtesat e paraqitura në to (tryeza e 100 vjetorit të Lindjes së Esad Mekulit, për shembull), nëse ndonjëri nga këta aktivitete nuk kërkon botim të veçantë.

Sekretari i Seksionit

Akademik Eqrem Basha, d.v.

ANEKS

QENDRA PËR DIGJITALIZIM, LEKSIKOGRAFI DHE ENCIKLOPEDI

Pas qëndrimit studimor në Vjenë dhe bisedave në Akademinë Austriake dhe në Qendrën e saj për digjitalizim, korpuse gjuhësore dhe analiza tekstore, dhe pas një vështrimi lidhur me përpjekjet për institucionalizimin dhe vënien në veprim të Qendrës për Leksikografi dhe Enciklopedi, vij me raportimin dhe propozimin vijues:

1. edhe pse pa kuadër institucional dhe të formalizuar, në saje të vullnetit dhe angazhimit të anëtarëve të Seksionit, QLE deri tash ia ka dalë të japë disa rezultate fillestare: është themeluar dhe vënë në realizim projekti për Fjalorin enciklopedik të Kosovës, i cili tashmë është në fazën

përfundimtare; është themeluar projekti për korpusin kombëtar të shqipes dhe, me gjithë mungesat e mëdha teknologjike e të kuadrit, deri tash janë shënuar rezultatet e para të përfshirjes digjitale të botimeve shqip (revista Përparimi e plotë, vepra të ndryshme); është përvijuar pjesa e parë e projektit për shqipen e shkruar të sh. XX dhe pritet që brenda vitit 2017 të përfundojë hartimi i leksikut të përdorur në shqipen e shkruar të sh. XX në Kosovë-ish-Jugosllavi; deri tash janë hartuar leksikët e lematizuar të numrave të parë të revistës Përparimi dhe të Fjalorit shqip-serbokroatisht të S. Dobroshit dhe janë bërë botimet pilot; pritet që brenda vitit 2017 të përfshihet në procesin e digjitalizimit e tërë prodhimtaria shkrimore shqip në ish- Jugosllavi deri në vitet ’90 të sh. XX, etj.

2. për ta çuar më tej vendosjen në këmbë të shëndosha Qendrën dhe përgjithësisht nismën për digjitalizim dhe veprimtari leksikografike, studime tekstore dhe korpuse të shqipes, del e nevojshme që urgjentisht të ndërmerren këta hapa:

a. që qendra të përkufizohet si Qendër për digjitalizim, leksikografi dhe enciklopedi; me këtë krijohet hapësira për trajtimin e gjithanshëm të materialeve për t’u digjitalizuar dhe kuadri më i përshtatshëm për përfshirjen e qendrës në rrjetet e ngjashme në hapësirën europiane;

b. të caktohet një përgjegjës për organizimin e Qendrës brenda Akademisë;

c. të pajiset Qendra me mjetet e

domosdoshme teknologjike brenda këtij viti (2016; skanerë, server, programe përkatëse);

d. të merret në punë të përherëshme një specialist për informatikë me formim elementar gjuhësor, ose gjuhëtar me formim informatik nga fillimi i vitit 2017;

e. të përfundohet skanimi i botimeve deri më 1970 brenda 2017-ës dhe të intensifikohet procesi i rinjohjes, i tagimit (anotimit) të teksteve;

f. të krijohet një rrjet fillestar i bashkëpunëtorëve të jashtëm, sidomos midis studentëve të doktoratës e të masterit.

Në bisedat me drejtorin e Institutit të Akademisë Austriake dr. K. Mörth ramë dakord për një bashkëpunim në këtë fushë. Instituti austriak është i gatshëm ta ndihmojë Qendrën tonë me teknologji softuerike, po edhe me shkëmbim përvojash dhe specializim kuadri. Po hulumtojmë mundësinë e ngritjes së një projekti të përbashkët, çka do ta lehtësonte shumë punën. Del e nevojshme të bëhet marrëveshje e veçantë me ta në kuadër të bashkëpunimit midis dy akademive. Për këtë kemi tashmë pajtimin parimor.

Akademik Rexhep Ismajli, d.v

II. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

PROJEKTET

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. –

Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të Akademisë. Pas përfundimit të fazës së parë të punës, që konsistoi në hartimin e fjalësit, në fazën e dytë u punua kryesisht në hartimin e teksteve të zërave, për mbi 6000 njësitë e përcaktuara. Hartimi i teksteve pritet të përmbyllet në qershor-shtator të vitit 2016. Paralelisht me hartimin e teksteve është kryer redaktura e parë dhe lektura e teksteve për disa fusha të caktuara. Gjatë vitit 2016 mbetet të përfundojë edhe kjo fazë e punës, në të cilën përfshihet edhe redaktura e dytë dhe harmonizimi krahasimtar i teksteve ndërmjet fushave të veçanta. Faza e tretë përfshin botimin pilot të Fjalorit, diskutimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve pas botimit pilot dhe botimin përfundimtar. Botimi pilot pritet të bëhet në fund të vitit 2016 ose në fillim të vitit 2017, diskutimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve 3 muaj pas botimit pilot dhe më pas përzgjedhja e fotografive dhe botimi përfundimtar. Sipas dinamikës së paraparë, Fjalori mund të jetë i gatshëm për botimin përfundimtar gjatë vitit 2017.

2. Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës (Tablloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale).- Projekt afatmesëm. Vendbanimet janë vatra të rëndësishme të jetës së ngulitur, të veprimtarisë së përhershme dhe të transformimit hapësinor dhe kulturor të gjeohapësirës. Në evolucionin e vendbanimeve vërehet qartë lidhja midis përpjekjeve të brezave të kaluara dhe angazhimeve dhe synimeve të brezave të tashëm në ngritjen

dhe zhvillimin e këtyre asociacioneve si organizma të shtrenjtë dhe kompleks. Në literaturën shkencore dhe profesionale në Kosovë dhe në gjithë trojet shqiptare deri në ditët tona ka munguar një botim kompleks shkencor mbi vendbanimet.

Shumë vende, përveç botimit të leksikoneve, të fjalorëve enciklopedikë dhe të enciklopevide, kanë tashmë edhe botime mbi vendbanimet të tipit enciklopedik apo dhe të tjera. Kosova nuk e ka deri më sot asnjë botim të tillë. Mungesa e një botimi të kësaj natyre dhe rëndësia shumëdisiplinare e të dhënave shkencore për vendbanimet, krijimin dhe zhvillimin e tyre hapësinor-fizik, demografik dhe funksional shtrojnë nevojën e realizimit të një ndërmarrjeje dhe botimi të plotë të karakterit monografik për vendbanimet tona të tipit urban dhe rural.

Në këtë arsytim do të prezantohen në pika të shkurtra qëllimet, burimet dhe mbledhja e të dhënave dhe rëndësia shkencore, aplikative dhe teoriko-metodologjike e projektit hulumtues-shkencor mbi vendbanimet. Realizimi i projektit do të plotësojë mungesën e informatave dhe njohurive sistematike për dinamikën e jetës dhe të zhvillimit të vendbanimeve të Kosovës, të kaluarën dhe të tashmen e tyre, duke ndjekur një qasje dhe metodologji bashkëkohore shkencore.

I. QËLLIMET

Disa nga qëllimet kryesore shkencore të këtij projekti afatmesëm janë:

a) Krijimi i një fondi të sistemuar të informatave dhe njohurive gjeohapësinore mbi vendbanimet e

karakterit urban, rural dhe të përzier (as fshat, as qytet);

b) Gjithpërfshirja e të dhënave dhe publikimi për herë të parë i tyre për të gjitha vendbanimet e Kosovës, pa marrë parasysh madhësinë numerike, përmasat hapësinore dhe statusin funksional;

c) Hulumtimi shumëdimensional i vendbanimeve që i tejkalon suazat e të dhënave të ngushta, të përgjithshme gjeohapësinore dhe përmban edhe të dhëna e fakte historike, gjeopolitike, sociologjike, etnologjike, kulturore etj.;

ç) Ndriçimi dhe shpjegimi i aspekteve të ndryshme të krijimit, zhvillimit dhe transformimit të vendbanimeve në kontekst të zhvillimeve historike-ekzistenciale, politike, ekonomike, kulturore dhe mjedisore;

d) Përpilimi i databazës së të dhënave shkencore të cilat do të shërbejnë për hulumtimet e mëvonshme, të hollësishme të vendbanimeve, për tipet, funksionet, sistemin, rrjetin, zgjerimin hapësinor-fizik dhe rritën demografike të tyre etj.;

dh) Mundësia e përdorimit të fondit të të dhënave të mbledhura për qëllime aplikative: për planifikimin hapësinor, urbanistik dhe shoqëror, për mjedisin jetësor, për motivet dhe potencialet turistike, për statistikën dhe administratën, në veçanti për ndërmarrjen e masave për parandalimin e rrjedhave të pavolitshme sociale dhe demografike, siç janë eksodi rural dhe proceset shpopuluese të cilat kanë përfshirë vendbanimet e zonave kodrinore-malore të Kosovës, pastaj për ndër-

marrjen e masave për riorganizimin funksional të vendbanimeve me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe humane, si dhe shpërndarjen më të harmonizuar të objekteve të infrastrukturës shoqërore dhe publike etj.;

e) Popullarizimi i njohurive shkencore mbi vendbanimet e Kosovës dhe tablonë e evolucionit të tërësishëm fizik, shoqëror dhe kulturor të tyre.

II. BURIMET E TË DHËNAVE

Në botimet që do të dalin nga ky projekt do të përfshihen të dhënat sa më të plota, themelore dhe të përgjithshme për evolucionin sasior dhe cilësor të vendbanimeve dhe të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të aspekteve të ndryshme të jetës ekonomike dhe dimensionin funksional të vendbanimeve në përgjithësi në tërë kompleksitetin e tyre. Për tablonë retrospektive historike dhe perspektivën e zhvillimit të vendbanimeve, do të shfrytëzohen të dhënat e defterëve osmanë (regjistrimet kadastrale), të arkivave dhe relacioneve të ndryshme, të dhënat e regjistrimeve zyrtare të popullsisë midis dy luftërave botërore dhe veçanërisht pas Luftës së II Botërore, pastaj statistika vitale-demografike (evidencat e zyrave të ofiçarisë dhe të bashkësive fetare) dhe faktet nga literatura shkencore në dispozicion dhe dokumentacioni (historike, gjeografike, ekonomike, demografike, gjeopolitike etj.), rezultatet e hulumtimeve anketuese nga puna në terren. Hulumtimi anketues do të marrë kohë më tepër, prandaj

në mbledhjen e një sasive të madhe të të dhënave do të angazhohen shumë ekspertë, kryesisht gjeografë, sociologë, historianë, ekonomistë, planerë e administratorë komunalë etj., studentë të dikurshëm të fakulteteve tona që punojnë në vendbanimet dhe komunat e tyre.

III. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

I. Të dhënat për dimensionin fizik: (pozita gjeografike, shtrirja zonale dhe hipsometrike, format morfologjike, rrethanat hidrologjike e klimatike dhe resurset e tjera natyrore etj.).

II. Të dhënat për popullsinë: (komponentët vitalo-demografikë - nataliteti, mortaliteti, shtimi natyror; martesat); të dhënat për strukturat e popullsisë (sipas moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, fetare, gjuhësore, përbërjes arsimore, socioekonomike, për strukturën e ekonomive familjare); të dhënat për migrimet (emigrimi, imigrimi, saldoja migruese; drejtimet e migrimeve, koha, shkaqet, pasojat, niveli i shkollimit dhe i punësimit, adaptimi dhe integrimi i migrantëve të jashtëm, lidhja me familjen dhe vendlindjen, remitancat etj.).

III. Të dhënat për veprimtaritë prodhuese (primare dhe sekondare); për veprimtaritë joprodhuese ose funksionet jobazike: terciare-shërbyese dhe kuartare, çfarë janë administrata publike, arsimi, shëndetësia, komunaliet, institucionet kulturore dhe politike, gjykatat, policia, shërbimet sociale e afariste dhe funksionet e tjera të infrastrukturës shoqërore dhe publike).

IV. Të dhënat për gjendjen e

banimit (fondi i banesave, ndërtimi sipas vitit, materiali i ndërtimit, instalimet, pajimet bashkëkohore për amvisni, aparatet, ujësjellësi, hidroforët, orenditë, inovacionet prodhuese nga sfera e teknologjisë agrare etj.).

IV. QASJA METODOLOGJIKE

Projekti do të sjellë risi edhe në qasjen teoriko-metodologjike, duke iu shmangur karakterit klasik, tipik antropogeojeografik, të ndikuar nga shkolla e J. Cvijiçit, e cila duke pasur për mision arsyetimin dhe propagandimin e aspiratave hegjemoniste serbe në Gadishullin Ballkanik, edhe në rrafshin e studimeve mbi vendbanimet ishte e ngarkuar me premisa ideologjike ekspansioniste, veçanërisht kur bëhej fjalë për aspektin historik të krijimit dhe zhvillimit të vendbanimeve të Kosovës dhe popullsisë shqiptare e prejardhjen e saj në përgjithësi.

Qasja bashkëkohore teorike-metodologjike përfshin vështrimin interaktiv të ekzistimit dhe veprimit të elementëve dhe faktorëve të ndryshëm natyrorë, shoqërorë dhe regionalë që ndikojnë në baraspeshën e brendshme dhe karakteristikat fizike-hapësinore, strukturën morfologjike, transformimet funksionale, pozitën në rrjetin e vendbanimeve etj.

Në kuadër të përgatitjeve për realizimin e hulumtimit do të përpilohet udhëzuesi i qartë për mbledhjen e të dhënave mbi vendbanimet, duke dhënë modelin dhe pyetësin për hulumtim që do të realizohet në terren. Hulumtimi dhe trajtimi i vendbanimeve do të

realizohet duke u mbështetur në tipologjinë e përgjithshme demografike dhe funksionale të vendbanimeve sipas të cilës dallohen qendrat e mëdha regjionale, që i përkasin kategorisë më të lartë funksionale; qendrat komunale; qendrat e bashkësive rurale dhe vendbanimet rurale. Në kuadër të çdo kaptine, që trajton një grup të vendbanimeve, siç janë ato brenda një komune, do të jepet një paraqitje tabelare e cila tregon trendët kryesore të shtrirjes territoriale të popullsisë dhe evolucionit të vendbanimeve, ndryshimet në strukturën dhe funksionin e tyre etj.

Pjesa tekstuale e vendbanimeve do të plotësohet me material ilustrues, çfarë janë hartat tematike, fotografitë, planet dhe skicat e ndryshme të cilat i japin karakter më përmbajtësor dhe e bëjnë më të kuptueshme materien e trajtuar brenda publikimit.

V. TIPIZIMI FUNKSIONAL I VENDBANIMEVE

1. KRYEQYTETI: Prishtina nga kasaba deri te metropoli republikan industrialo-urban (elementet fizike, evolucioni popullativ dhe komponentët bazë demografike, funksionet sekundare, terciare dhe kuartare; ndërtimi "i egër");

2. QENDRAT RAJONALE dhe funksionet e tyre: Prizreni, Peja, Gjakova, Mitrovica, Ferizaj, Gjilani (urbanizimi primar dhe sekundar);

3. URBANITET E VOGLA: vendbanimet e urbanizuara dhe suburbane (selitë komunale dhe vendbanimet pranëqytetëse si "dormitorij" për popullsinë e punësuar; pasojat e luftës);

4. VENDBANIMET RURALE (veprimtaritë primare, institucionet shoqërore dhe grupet dhe strukturat e reja socioprofesionale: fshatarët-punëtorët brenda ose jashtë vendit, fshatarët-jobujqit, nëpunësit, intiligjencia; eksodusi rural, pasojat e luftës);

5. VENDBANIMET AGRARE (sipërfaqet bujqësore dhe të punueshme, dinamika e lëvizjes së popullsisë bujqësore, dendësia agrare, infrastruktura rrugore, izolimi fizik dhe social; dëmet e luftës etj.).

VI. TIPIZIMI MORFOLOGJIK I VENDBANIMEVE: Tipi i dendur, tipi kalimtar, tipi i shpërndarë; shtëpia dhe funksionet e saj; kulla si tip i fortifikuar i shtëpisë dhe dëmtimet nga lufta.

Realizimi i këtij projekti afatmesëm dhe dalja në dritë e botimeve për vendbanimet e Kosovës do të përmbushë një nevojë të kahershme për gjeoshkencat, shkencat sociale dhe opinionin e gjerë lexues dhe shfrytëzues. Hartimi dhe pastaj botimet e tilla pa dyshim do të jenë një trashëgimi e madhe për shkencën dhe kulturën tonë.

Projekti do të jetë vepër kolektive, me redaksi, redaktor dhe rreth 40 bashkëpunëtorë. Për realizimin e tij do të kërkohen edhe donacione.

Udhëheqës i projektit: akademik Hivzi ISLAMI.

3. Hasan Prishtina në prizmin e dokumenteve arkivore.

IDEJA E PROJEKTIT

Grumbullimi i dokumenteve, fakteve, fotografive, gazetave dhe

burimeve tjera arkivore nga arkivat e vendeve të rajonit dhe vendeve perëndimore që trajtojnë figurën e Hasan Prishtinës.

QËLLIMI I PROJEKTIT

Argumentimi shkencor i veprimtarisë politike e diplomatike të Hasan Prishtinës bazuar në burimet arkivore shqiptare jo shqiptare.

Objektivat e projektit:

- Grumbullimi i provave dhe materialeve

- Studimi dhe klasifikimi i tyre

- Organizimi i një Konference Shkencore Ndërkombëtare mbi personalitetin politik e diplomatik të Hasan Prishtinës, sipas propozimit të profesor Oliver Shmitt në Vjenë si një nga qendrat më të rëndësishme të Albanologjisë në Evropë..

- Botimi i një vëllimi të veçantë.

ARSYESHMËRIA E PROJEKTIT

Projekti konsiston në idenë që figura e Hasan Prishtinës të trajtohet në mënyrë të gjithanshme shkencore dhe të studiohet në rrafshin shumëdimensional. Pjesë nga ky projekt do zënë vend të rëndësishëm në Historinë e Kosovës por edhe atë kombëtare. Hulumtimi, faktet e nevojshme, dokumentet, fotot dhe materialet e tjera që do të sigurohen me rastin e hulumtimeve janë bazë e rëndësishme dhe e domosdoshme për të krijuar qëndrueshmëri shkencore mbi personalitetin e Hasan Prishtinës dhe ngjarjeve që janë të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me kontributin e këtij burrështetasi.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti do të ketë disa faza të zhvillimit të tij duke filluar nga grumbullimi i dokumenteve arkivore nëpër arkiva të vendeve të rajonit dhe vendeve perëndimore, seleksionimi, klasifikimi, studimi dhe prezantimi i rezultateve shkencore.

Projekti do të zhvillohet në këto faza:

I. Mbledhja dhe grumbullimi i dokumenteve arkivore;

II. Studimi dhe përpunimi i këtyre materialeve dhe krijimi i një njësie arkivore pranë ASHAK-ut ku do të grumbulloheshin të gjitha materialet që kanë të bëjnë me figurën e Hasan Prishtinës;

III. Prezantimi i studimeve në një Konferencë Ndërkombëtare Shkencore dhe botimi i studimit.

LLOJI I AKTIVITETEVE

- Hulumtimi neper arkiva sipas një ndarje të punës midis studiuesve të angazhuar në projekt.

- Studimi i materialit të mbledhur
- Konferenca shkencore
- Prezantimi i rezultateve

Përshkrimi i aktiviteteve:

Aktivitetet do të zhvillohen sipas projektit që nga puna nëpër terren e deri te prezantimi i tyre. Kjo do të bëhet nga studiues dhe grupe e punuese.

Vendet- lokacionet e realizimit të aktiviteteve:

Arkivi i Vjenës, Arkivi i Sofjes, Arkivi i Londrës (Foreign Office), Arkivi i Kosovës, Arkivi Qendror i Shtetit

Shqiptar në Tiranë, Arkivi i Shkupit.

KOHA E REALIZIMIT

Projekti parashihet të realizohet në periudhën kohore 2016-2019

Partnerët:

Arkivi i Kosovës

Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar

Arkivi i Vjenës

Arkivi i Sofjes

Arkivi i Shkupit

Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë

Instituti Albanologjik i Prishtinës

Institutet e Historisë së vendeve të rajonit

BUXHETI

Pasi që projekti ka rëndësi të veçantë mendojmë të kemi mbështetje buxhetore nga Qeveria e Kosovës dhe nga ndonjë një donator tjetër i mundshëm.

Bartës të projektit:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE ARTEVE E KOSOVËS

AKADEMIA AUSTRIAKE E SHKENCAVE

Përgjegjës të Projektit: Prof. Dr. Jusuf Bajraktari dhe Prof. Dr. Oliver Shmitt.

4. Korpus i monumenteve epigrafike antike të Kosovës.

IDEJA

Në territorin e Kosovës është zbuluar një numër i madh i monumenteve epigrafike përgjatë shekujve, prej të cilave, vetëm një numër i vogël

i tyre sot ndodhen në ambientet e institucioneve të trashëgimisë kulturore. Pjesa me e madhe e tyre vazhdojnë të jenë të shpërndara nëpër Kosovë, në ambiente publike dhe private. Një pjesë e madhe e tyre rrezikohet të humbin përgjithmonë. Prandaj, evidentimi, fotografimi, vizatimi dhe studimi i tyre u bë domosdoshmëri e kohës.

Mbledhja dhe trajtimi i monumenteve epigrafike të zbuluara në Kosovë ka filluar që nga fillimi i shekullit XIX. Disa nga monumentet epigrafike nga Kosova gjenden të publikuara në CIL III (1881) dhe në studimin e A. Evans (1885). Trajtime me të detajizuara gjenden në studimet e A. Premestein dhe N. Vulić (JÖAI VI, 1903), N. Vulić (Spomenik 71, 1931; 75, 1933; 77, 1934; 98, 1941-1948), Z. Mirdita (1981), E. Čerškov (Municipium DD), J. A. Šašel (1978, 1985), N. Ferri (2001), E. Dobruna-Salihi (20005). Kontribut, në publikimin e mbishkrimeve të caktuara kanë dhënë dhe E. Shukriu, F. Peja, M. Parović-Pešikan, S. Dušanić, P. Petrović, M. Gabrićević etj.

QËLLIMI

Projekti ka për qëllim përmbledhjen e të gjitha monumenteve epigrafike në një Korpus të veçantë. Trajtimi i materialit epigrafik është i një rëndësie të veçantë ngase ndihmon në ndriçimin e shumë aspekteve të jetës ekonomike, politike, shoqërore, etnike, të religjionit dhe të veprimtarisë kulturore dhe artistike.

KOHA DHE FAZAT E ZHVILLIMIT

Projekti për hartimin e korpusit të monumenteve epigrafike antike të

Kosovës, parashihet të realizohet në dy faza. Gjatë fazës së parë parashihet të bëhet evidentimi i të gjitha monumenteve epigrafike, fotografimi dhe vizatimi i tyre.

Gjatë fazës së dytë do të bëhet studimi dhe përshkrimi i detajuar i materialit epigrafik të evidentuar gjatë fazës së parë, që nënkupton të dhënat vijuese:

- Vendi i gjetjes
- Vendi i ruajtjes
- Përshkrimi i detajuar i aspektit dekorativ të monumentit
- Gjendja aktuale e monumentit
- Përcaktimin i periudhës kohore
- Leximi i tekstit të mbishkrimit
- Komentimi i tekstit të mbishkrimit

PERSONI PËRGJEGJËS PËR PROJEKTIN

Anëtare korrespondente Edi Shukriu
AUTORË:

Anëtare korrespondente Edi Shukriu
Prof.As. Dr. Arben Hajdari

DOMOSDOSHMËRIA E PROJEKTIT

Dy arsye kryesore shtrojnë domosdoshmërinë për realizimin e projektit:

1. Fakti se monumentet epigrafike përmbajnë në vetë një shumëllojshmëri informatash për ndriçimin fenomeneve të shumta politike, shoqërore, kulturore dhe ekonomike që e kanë karakterizuar Kosovën par gjatë gjithë antikitetit.

2. Gjendja jo e mirë në të cilën ndodhet pjesa me e madhe e monumenteve epigrafike dhe shqetësimi se një pjesë e madhe e tyre mund të humbasin.

Rikujtojmë se një numër jo i vogël i monumenteve epigrafike të zbuluara pas luftës në Kosovë, nuk kanë qenë objekt studimi.

Realizimi i këtij korpusi do të vendoste bazat fundamentale, mbi të cilat më pas do të mund të bëhen studime me specifike mbi jetën politike, ekonomike, kulturore, religjioze, strukturën etnike, artin, procesin e romanizimit dhe rezistencën e të tjera në Dardani gjatë antikitetit.

Kosova deri me tani nuk e ka botuar asnjë korpus të këtij lloj, prandaj realizimi i tij do t'i bënte nder Akademisë së Shkencave dhe të Artëve të Kosovës dhe misionit të tij.

REZULTATET E PRITURA

Realizimi i monografisë KORPUS I MONUMENTEVE EPIGRAFIKE ANTIKE TË KOSOVËS ndihmon në:

- Identifikimin e të gjitha monumenteve epigrafike të zbuluara në Kosovë,

- Korrigjimin e gabimeve eventuale gjatë rileximit të teksteve,

- Ndriçimin e fenomeneve të jetës politike, ekonomike, kulturore, shpirtërore, të artit etj. gjatë antikitetit në Kosovë.

- Vendosjen e bazave të mirëfillta për botën shkencore për thellimin e studimeve specifike të mëtejme.

TUBIMET SHKENCORE

1. "Rruga Drejt Integritimit Ekonomik Evropian e Kosovës".- Konferencë shkencore.

Në faza të ndryshme të ndërtimit,

Kosova është ballafaquar me procese që kanë ndikuar në ndryshime strukturore në ekonominë e saj. Qëllimi i kësaj teme është që të analizohen proceset kryesore të integritimit dhe ndryshimet strukturore nga proceset e integritimit nga pikëpamja e ekonomisë, si dhe rruga përpara në kuadër të proceseve integruese. Integritimi rajonal dhe hapja e ekonomisë është e bazuar në pozicionin e teorisë se ekonomia e hapur është me benefit për të gjithë. Kosova që nga themelimi i institucioneve të saja dhe krijimit të bazës legale është orientuar për ekonomi të hapur si model i vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Si në nivel global, ashtu edhe në Kosovë, debati mbi ekonominë e hapur dhe integritimin ka vëmendje të theksuar lidhur me efektet e tij.

Fillet e para të integritimit ekonomik të Kosovës kanë filluar që nga fillimi i përdorimit të valutës euro, valutë kjo e unionit më të madh ekonomik dhe monetar në botë, Bashkimit Evropian. Përdorimi i EURO-s në Kosovë dhe mungesa e politikës së drejtpërdrejt monetare në vend ka pasur refleksionet e saj edhe në vet ekonominë e Kosovës, por edhe stabiliteti monetar i imponuar nga valuta e fuqishme e EURO-s ka bërë efektin mjaft pozitiv. Ndër marrëveshjet e para për hapjen e tregut të Kosovës ndaj vendeve të tjera ka qenë marrëveshja e CEFTA-s e cila ka hyrë në fuqi për Kosovën që nga vitin 2007. Bizneset vendore me afër 10 vjet pjesë e CEFTA-s, sot janë më të përgatitur për marrëveshjen e MSA-së e cila paraqet një nivel edhe më të lartë të konkurrencës. MSA-ja ka një

pozicion dukshëm më të favorshëm pasi që përmban në vete një nivel të konsiderueshëm të diskriminimit pozitiv për ekonominë e Kosovës si rezultat i mekanizmave për mbrojtjen e produkteve për vite të caktuara dhe kalimit në treg të hapur pa masa doganore në mënyrë graduale.

Kosova ka shënuar hapa të konsiderueshëm edhe në kuadër të procesit të Berlinit, proces ky i cili ka për qëllim të nxisë aktivitetin investiv nga sektori publik në vendet e Ballkanit perëndimorë në mënyrë të koordinuar. Përveç integritimit ekonomik, Kosova vazhdimisht ka punuar që edhe sistemi legjislativ i vendit të jetë në përputhje me direktivat e BE-së, dhe aktualisht mekanizmat janë mirë të definuar në vend për sigurimin e përshtatshmërisë së ligjeve me acquis-comunitte të BE-së.

Nën temat që do të trajtohen në konferencën shkencore janë:

- 1) Euroizimi i Kosovës
- 2) Marrëveshja e CEFTA-s
- 3) Procesi i Berlinit i Vendeve të Ballkanit perëndimor
- 4) Integrimi i Tregut të Energjisë i Kosovës me Rajonin dhe Evropën,
- 5) Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
- 6) Përshtatshmëria e Legjislationit të Kosovës me Acquis-Communitte të Bashkimit Evropian
- 7) Shembujt e Rrugës së Integritimit nga Vendet e Ballkanit

Konferenca do të jetë njëditore.
Koha e mbajtjes: Shtator 2017

Kontributet autoriale të Konferencës do të botohen në vëllim të veçantë.

2. "Sfidat e ndërtimit të shtetit ligjor"- Tryezë shkencore. Procesi i ndërtimit të shtetit ligjor është një proces i gjatë por jo edhe i pamundur, sidomos në ato vende që kanë kaluar në rrugën e ndryshimit të sistemeve politike. I tillë është rasti edhe me procesin e tranzicionit politik në Republikën e Kosovës dhe aq më tepër në ballafaqimin me sfidat e ndërtimit të shtetit ligjor si mungesa e sundimit të ligjit, respektimi i duhur i rendit juridik-kushtetues, korrupsioni, krimi i organizuar, rreziku nga terrorizmi, mungesa e stabilitetit politik, ndrydhja e demokracisë qytetare, moszhvillimi ekonomik etj.

Republika e Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë, vazhdon betejën për konsolidimin dhe ndërtimin e saj, në aspektin e ndërtimit dhe zhvillimit të institucioneve shtetërore, promovimin e demokracisë qytetare dhe kushtetuese, zhvillimin ekonomik social të vendit etj.

Por, njëra ndër sfidat kryesore të ndërtimit të shtetit ligjor, mbetet mungesa e sundimit të ligjit, në shumë raste si rezultat i cenimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të drejtësisë, por edhe institucioneve tjera kushtetuese të pavarura dhe si rezultat i saj, mungesë e zbatimit të ligjit, kushte jo të përshtatshme për punë efikase dhe efektive, të drejt dhe të pavarur nga asnjë ndikim.

Respektimi i mjaftueshëm i punës dhe pavarësisë së institucioneve të

drejtësisë, do të ndikonte drejtpërdrejt, në krijimin e kushteve për luftimin e dukurive negative, zhvillimin ekonomik të vendit, sigurinë juridike, besueshmërinë në institucionet shtetërore, veçanërisht në institucionet e drejtësisë, dhe një proces më të përsheptuar të integritit të vendit në mekanizmat ndërkombëtar.

Andaj, me qëllim të trajtimit sa më të sakët dhe më të arsyeshëm të sfidave të ndërtimit të shtetit ligjor në Republikën e Kosovës, do të ishte nder dhe kënaqësi trajtimi i kësaj çështje nën organizimin e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, përmes një tryeze.

Kontributet autoriale të tryezës do të botohen në vëllim të veçantë.

BOTIMET

1. Emin Riza: “Arkitektura popullore e Gjakovës”.- Në këtë studim monografik autori, mëton t'i prezantojë para opinionit lexues, në veçanti atij të profilit shkencor, vlerat e arkitekturës popullore të Gjakovës, si njëra ndër qendrat më karakteristike të Kosovës. Kjo arkitekturë, siç e thotë edhe autori, e përforcon tezën se kjo qendër urbane ka luajtur një rol me rëndësi, jo vetëm në kulturën e banimit, por edhe në kulturën shpirtërore, përkatësisht të brezave liridashës të entitetit të Gjakovës me rrethinë, në rrafshin e qëndresës së këtij regjioni përballë stuhive të ekspeditave të pushtuesve osmanë, serbë e malazezë, por edhe të pushtuesve të mëvonshëm gjatë historisë.

2. Revista “Studime shoqërore”, nr. 4.- Revistë vjetore që do të botohet gjatë vitit 2017. Në të do të botohen studime dhe artikuj shkencor, tekste ligjëratash inauguruese, vështrime, recensione e kritika, etj. nga disipinat e shkencave shoqërore.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Jusuf Bajraktari, d.v.

III. SEKSIONI I SHKENCAVE TË NATYRËS

PROJEKTET

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të Akademisë. Pas përfundimit të fazës së parë të punës, që konsistoi në hartimin e fjalësit, në fazën e dytë u punua kryesisht në hartimin e teksteve të zërave, për mbi 6000 njësitë e përcaktuara. Hartimi i teksteve pritet të përmbyllet në qershor-shtator të vitit 2016. Paralelisht me hartimin e teksteve është kryer redaktura e parë dhe lektura e teksteve për disa fusha të caktuara. Gjatë vitit 2016 mbetet të përfundojë edhe kjo fazë e punës, në të cilën përfshihet edhe redaktura e dytë dhe harmonizimi krahasimtar i teksteve ndërmjet fushave të veçanta. Faza e tretë përfshin botimin pilot të Fjalorit, diskutimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve pas botimit pilot dhe botimin përfundimtar. Botimi pilot pritet të bëhet në fund të vitit 2016 ose në fillim të vitit 2017, diskutimi i

vërejtjeve dhe sugjerimeve 3 muaj pas botimit pilot dhe më pas përzgjedhja e fotografive dhe botimi përfundimtar. Sipas dinamikës së paraparë, Fjalori mund të jetë i gatshëm për botimin përfundimtar gjatë vitit 2017.

2. Kadastrit i ndotësve të ujërave efluent në recipient dhe trajtimi i tyre (me biosorbent dhe osmozë të kundërt). - Ky projekt i takon kimisë së mjedisit dhe ka karakter hulumtues dhe aplikativ. Trajtimi i ujërave mund të ndahet në tri kategori kryesore: Pastrimi për nevoja shtëpiake, trajtimi për përdorime speciale industriale si dhe trajtimi i ujërave hedhurinë për t'i bërë ato të pranueshme për lirim në recipient apo ripërdorim. Duhet theksuar se pavarësisht trajtimit që i nënshtrohet uji, së pari duhet të krijohet kadastrit (regjistri) i ndotësve të ujërave efluent. Trajtimi i ujërave hedhurinë të shkarkimeve industriale gjatë shekullit të kaluar është bërë me metoda kimike, fiziko-kimike dhe biologjike. Substancat e përdorura për këtë qëllim kanë liruara llaçe të cilat kanë paraqitur problem mjedisor për shkak të përmbajtjes së specieve metalike, herbicideve, pesticideve apo fenoleve.

Shkenca e mjedisit tani është e orientuar kah eliminimi i problemeve të lartpërmendura duke u bazuar në ekonomi të gjelbër dhe në kimi të gjelbër. Teknologjitë konvencionale për largimin e metaleve të rënda toksike, nuk janë komerciale dhe pos kësaj gjenerojnë llaçe toksike kimike, ndërsa hulumtimet kanë bërë biosorbimin si proces në hyrje dhe si

një alternativë të fuqishme të teknologjive konvencionale për mënjanimin ose nxjerrjen e joneve metalike nga tretësirat ujore. Projekti do të jetë i ndarë në dy pjesë:

1. Krijimi i kadastrit të ndotësve të ujërave hedhurinë;

2. Trajtimi komparativ i ujërave hedhurinë me metoda klasike kimike dhe fiziko-kimike duke përdorur material dhe metoda vetanake si dhe përdorimi (për herë të parë të ne) i biosorbventëve.

Ky projekt është propozuar të jetë dyvjeçarë. Realizimi i tij ka filluar në vitin 2016 dhe i njëjti do të vazhdojë edhe në vitin 2017.

3. Parametrat e jashtëm projektues të klimës për disa qytete të Kosovës.- Ky projekt ka karakter hulumtues dhe aplikativ dhe i njëjti bazohet në matjet e vazhdueshme që i kryen Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për temperaturën e ajrit të jashtëm, lagështinë absolute dhe relative të ajrit, shtypjen e ajrit të jashtëm, intensitetin e rrezatimit diellor, etj. Bazuar në rezultatet e matjeve në pikat ku janë realizuar matjet, në mënyrë analitike përcaktohen parametrat e projektuar për të cilët duhet të sigurohet ngrohja e objekteve në stinën e dimrit si dhe ventilimi në stinën e verës. Në përgjithësi pikat matëse të këtyre treguesve në Kosovë janë: Prishtina, Prizreni, Peja dhe Ferizaj. Për këto qytete mund të përcaktohen parametrat projektues të klimës. Llogaritja e këtyre parametrave duhet t'i referohet metodave më të njohura

ndërkombëtare siç është ASHARE, etj.

Analiza dhe përcaktimi projektues i parametrave të klimës për këto qytetet të Kosovës paraqesin lehtësi për projektuesit e sistemeve termoteknike, për dizajnin e klimës së brendshme të ndërtesave, komfortin termik, efikasitetin e energjisë dhe janë dëshmi e një niveli teknik të një vendi. Rezultatet e këtyre analizave në të ardhmen mund të futen edhe në bankën e të dhënave hyrëse të softuerëve aplikativ për termoteknikë. Në shtetet e Bashkimit Evropian, parametrat e cekur janë të normuara dhe janë shënime bazë në softuerët që përdoren për projektimin e sistemeve të ngrohjes, ventilimit dhe të klimatizimit.

Projekti është propozuar të punohet në kohëzgjatje 2 vjet (2016-2017) me një ekip realizues kompetent për këtë lëmi. Realizimi i tij ka filluar në vitin 2016 dhe i njëjti do të vazhdojë edhe në vitin 2017.

BOTIMET

1. Minir Dushi: 'Xeheroret e nikelit dhe të kobaltit të vendit tonë'.- Ky studim merret me problematiken e xeherorëve okside-silikate të Ni-Co të cilat shfaqen përkatësisht shfrytëzohen në vendin tonë. I njëjti mendohet të ndërtohet nga këto tri pjesë: Gjeologjia-shfaqja dhe vendburimet e xeherorëve të Ni- Co; Xehetaria-shfrytëzimit i xeherorëve të Ni- Co dhe Metalurgjia e ferro nikelit në Drenas

Në pjesën e parë do të pasqyrohen të dhëna të numërta nga punimet

kërkimore gjeologe-zbuluese vjetore rajonale. Këto hulumtime janë kryer në zonat masive periodike të Golashit, Dritanit (Dobroshevcit), Rahovecit dhe Gjakovës. Do të jepen përfundimet e punimeve shumëvjeçare: gjeologjike, gjeokimike dhe gjeografike të xeherorëve të Ni-Co në shfaqje dhe vendburime. Nga hulumtimet e deritanishme ka rezultuar se rezervat e këtyre xeherorëve arrijnë shifrën mbi 22 milion tona që e rendisin Republikën e Kosovës në vendet më të pasura të botës me këto xeherore.

Në pjesën e dytë do të studiohet xehetaria përkatësisht shfrytëzimi i xeherorëve të Ni-Co, siq janë minierat në qiell të hapur në Çikatovës dhe Kodrinës së Goleshit. Përveç minierave të cilat janë në punë prodhuese, është identifikuar edhe një numër i madh i vendeve që premtojnë se mund të zbulohen rezerva të reja të këtyre xeherorëve siq janë Llapushniku, Bushati, Ponosheci, Beci, Banjska, Guri i kuq, Baksi, Juniku, Hereçi, etj.

Në pjesën e tretë deri në hollësi do të analizohet metalurgjia e ferro-nikelit në Drenas, meqë nikeli i cili fitohet në metalurgjinë e Ferro nikelit në Drenas ka një përdorim të gjerë për prodhimet industriale dhe proceset teknologjike. Punimet kërkimore gjeologjike të këtyre xeherorëve kanë qenë shoqëruar edhe nga studimet laboratorike eksperimentale dhe gjysmindustriale të përpunimit tekniko-teknologjik të xeherorit (parimi hidrometalurgjik dhe piro-metalurgjik).

2. Valbon Bytyçi: "Regjioni lindor i Kosovës (Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet gjeomjedisore)". -Ky studim propozohet që të përmbajë tri pjesët kryesore siç janë:

- Veçoritë fiziko-gjeografike- Trajtimi i veçorive fiziko-gjeografike, resurseve natyrore dhe problemeve gjeomjedisore në Regionin Lindor të Kosovës deri konsiderohet i pjesshëm dhe i pakët nga fakti se regjioni Lindor i Kosovës shtrihet në pjesën lindore të Kosovës, duke zënë sipërfaqe prej rreth 57,6% të territorit të Republikës së Kosovës. Ky regjion karakterizohet me ndërtim kompleks gjeologjiko-tektonik në të cilin paraqiten lloje të ndryshme të shkëmbinjve si për nga moshën, ashtu edhe nga përbërja. Veçohet me klimë kontinentale të mesme, me dallime jo shumë të mëdha në mes lindjes e perëndimit, dhe në mes jugut e veriut.

- Resurset natyrore - Si rezultat i proceseve natyrore të brendshme dhe të jashtme, janë krijuar resurse natyrore të llojllojshme. Veçohet me pasuri minerale, ku dallohet Plumb-zinku në disa lokalitete, Nikeli, Mangani; si dhe pasuri jometalore të shpërndara në disa pjesë, ku veçohet magneziti, mergelët, bentoniti, kaolina, gëlqerorët; pasuri të madhe energjetike: linjiti, me toka pjellore me sipërfaqe të kufizuar, ujëra të ndryshme termominerale, resurse ujore të kufizuara, etj.

- Problemet gjeomjedisore – Regjioni Lindor i Kosovës si hapësirë e madhe gjeografike i është nënshtruar

degradimit të mjedisit nga dora e njeriut. Ky regjion është mjaft i pasur me resurse natyrore, sidomos resurse minerale dhe energjetike, të cilat për nga lokacioni i vendndodhjes të tyre gjenden në tokat me bonitet të lartë dhe në afërsi të lumenjve. Mirëpo, shfrytëzimi i resurseve natyrore, sidomos lëndëve energjetike, minerale, tokat, etj., ka sjell deri te ndryshimet e shumta në mjedisin natyror. Kështu, shfrytëzimi i resurseve natyrore, në disa pjesë të lindjes së Kosovës është mjaft shqetësuese, duke ndryshuar peizazhin natyror, madje duke rrezikuar edhe sitet e trashëgimisë natyrore.

Bazuar në të dhënat e mësipërme del qëllimi i librit dhe objektivat kryesore:

- Analiza e veçorive të përgjithshme fiziko-gjeografike të Regjionit Lindor të Kosovës, duke përfshirë ndërtimin gjeologjiko-tektonik, relievin dhe format, kushtet hidroklmatike, tokat dhe veçoritë biogjeografike.

- Identifikimi dhe njohja me resurset natyrore në Regjionin Lindor të Kosovës, duke përfshirë mineralet, kushtet klimatike, ujërat, tokat dhe pyjet.

- Paraqitjen e gjendjes aktuale të shfrytëzimit të resurseve natyrore në Regjionin Lindor të Kosovës dhe tendencat e shfrytëzimit në të ardhmen,

- Paraqitja e gjendjes së trashëgimisë natyrore dhe problemet që i kanosen,

- Evidentimi i problemeve gjeomjedisore të cilat rrjedhin si rezultat i

shfrytëzimit të resurseve natyrore në Regjionin Lindor të Kosovës.

3. Revista shkencore “Kërkime” nr. 23.- Pritet të përgatitet dhe të botohet për vitin 2017 Në të do të botohen tekste dhe kontribute shkencore nga fusha e shkencave të natyrës dhe të shkencave të tjera fundamentale. Sikundër edhe deri tash, edhe në këtë numër të revistës do të botohen punime shkencore të anëtarëve të Seksionit të Shkencave të Natyrës të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, si dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm, të tillë tekste që do t’i plotësojnë kriteret shkencore, pas vlerësimit profesional që do t’u bëhet nga redaksia e revistës.

Sekretari i Seksionit

Akademik Fejzullah Krasniqi, d.v.

IV. SEKSIONI I ARTEVE

PROJEKTET

1. Fjalori Enciklopedik i Kosovës. – Projekt i përbashkët i të gjithë seksioneve të Akademisë. Pas përfundimit të fazës së parë të punës, që konsistoi në hartimin e fjalësit, në fazën e dytë u punua kryesisht në hartimin e teksteve të zërave, për mbi 6000 njësitë e përcaktuara. Hartimi i teksteve pritet të përmbillet në qershor-shtator të vitit 2016. Paralelisht me hartimin e teksteve është kryer redaktura e parë dhe lektura e teksteve për disa fusha të caktuara. Gjatë vitit 2016 mbetet të

përfundojë edhe kjo fazë e punës, në të cilën përfshihet edhe redaktura e dytë dhe harmonizimi krahasimtar i teksteve ndërmjet fushave të veçanta. Faza e tretë përfshin botimin pilot të Fjalorit, diskutimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve pas botimit pilot dhe botimin përfundimtar. Botimi pilot pritet të bëhet në fund të vitit 2016 ose në fillim të vitit 2017, diskutimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve 3 muaj pas botimit pilot dhe më pas përzgjedhja e fotografive dhe botimi përfundimtar. Sipas dinamikës së paraparë, Fjalori mund të jetë i gatshëm për botimin përfundimtar gjatë vitit 2017.

BOTIMET

1. Abdurrahim Buza –Monografi.- Monografia për piktorin Abdurrahim Buza, i cili njihet si piktori i parë kosovar, studioi artin në Itali në Akademinë “Albertina di Belle Arti” në Torino dhe pastaj në Firenze kreu pikturën monumentale në vitin 1933. Për shkak të rrethanave të njohura historike mbeti të jetonte dhe vepronte në Tiranë. Po thuajse e tërë krijimtaria e tij artistike i kushtohet temave të përditshme kosovare. Gjatë karrierës së tij si artist ka punuar qindra vepra të cilat janë ekspozuar në shumë vende jashtë Shqipërisë dhe Kosovës. Njihet edhe si një ndër pedagogët e parë në fushën e artit dhe për meritat në këtë fushë mori titullin “Mësues i Merituar”. Ndërsa për krijimtarinë e tij të bujshme artistike merr titullin “Piktor i Popullit”. Duke pasur parasysh këto fakte si dhe origjinalitetin individual të krijimtarisë

së tij, Seksioni i Arteve propozon që të hartohet një monografi në të cilën do të përfshiheshin jeta dhe krijimtaria e tij. Autori i monografisë u propozua të jetë akademik Tahir Emra.

TUBIMET SHKENCORE

1. Tryezë muzikologjike kushtuar 1-vjetorit të Shenjtërimit të Nënës Terezë dhe Shugurimit të Katedrales katolike në Prishtinë mbi vepra të kompozitorëve tanë kushtuar Nënës Terezë.

Planifikohen të paraqiten një varg (etno) muzikologësh dhe studiuesish të tjerë me kumtesa mbi vepra të ndryshme të kompozitorëve tanë kushtuar Nënës Terezë, si:

- veprat solistike (këngë/romanca për zë e piano);
- këngë për kore pionierësh;
- vepra për solist a soliste

dhe ansambël kameral;

- vepra për solistë, kor dhe orkestër...

EKSPOZITAT

1. Ekspozita personale e akademik Rexhep Ferri, me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Ekspozita do të organizohet me rastin e 80-vjetorit të lindjes së akademik Ferrit. Ajo do të përfshijë krijimtarinë e viteve të fundit të autorit, i cili kësaj radhe do të paraqesë përveç pikturave edhe disa tapiceri. Tapiceritë janë risi në krijimtarinë e viteve të fundit të kërkimeve krijuese të autorit. Për ekspozitën do të përgatitet edhe botimi i katalogut.

Sekretari i Seksionit

Anëtar korrespondent Luan

Mulliçi, d.v.

PROCESVERBALET E KUVENDIT TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS



PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXVII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 16 shkurt 2016, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrëspondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri dhe Salih Gashi.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, Sekretare e Akademisë.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXVI të Kuvendit;
2. Miratimi i Raportit të punës së ASHAK-ut për vitin 2015;
3. Miratimi i Raportit financiar të ASHAK-ut për vitin 2015;
4. Çështje vijuese.

Mbledhjen e hapi Kryetari Islami, i cili bëri një vështrim të punës së Akademisë për vitin 2015. Nga fjala e Kryetarit veçojmë:

“Kolegë të nderuar,

Mirësevini në mbledhjen e LXXXVII të Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rendin e ditës që e keni para vetes. Ftesën dhe materialet i keni marrë me kohë. Edhe në këtë mbledhje, e para

në këtë vit, do të shqyrtohet puna e të gjitha organeve dhe shërbimeve të Akademisë, çfarë janë Kuvendi, Kryesia, Seksionet dhe puna e Shërbimit Administrativ, Profesional dhe Teknik për vitin 2015. Në këtë mbledhje, si herëve të tjera, shqyrtohet edhe Raporti Financiar.

Materialet e duhura për punën e të gjitha këtyre instancave janë të përgatitura nga Shërbimi i Akademisë.

Programet e punës së seksioneve janë shqyrtuar dhe miratuar nga seksionet dhe nga Kryesia e Akademisë. Megjithatë, jemi këtu për t'i shqyrtuar të gjitha problemet.

Na mungojnë disa anëtarë, zakonisht të njëjtit.

Nga dita e pavarësisë dhe e sovranitetit të Kosovës më 17 shkurt 2008, mbledhja e parë e Kuvendit tonë në çdo fillimvit po përputhet me këtë datë. Për t'u mos u mbledhur dy herë, po e mbajmë mbledhjen e Kuvendit dhe shënimin e 8-vjetorit të pavarësisë brenda një dite.

Prandaj, kjo mbledhje ka dhe një karakter solemn.

Gjatë vitit 2015 Akademia mbajti gjithsej 3 mbledhje të Kuvendit: më 19 Shkurt, kur u miratuan Programi i punës së seksioneve dhe i Akademisë dhe Raporti Financiar për vitin 2014; më 2 Korrik, kur u miratua Programi i punës për vitin 2016; dhe më 29 Dhjetor, kur u bë zgjedhja e Nënkryetarit të Akademisë. Gjatë këtij viti Kryesia e Akademisë mbajti gjithsej 9 mbledhje të rregullta, disa mbledhje

ad hoc me rastin e 5 vdekjeve; u mbajtën dhe shumë mbledhje të seksioneve dhe të trupave të tjera, të komisioneve, të këshillave organizuese të tubimeve shkencore dhe artistike, të redaksisë qendrore të FEK, të redaksive të revistave etj.

Sa nuk keni bërë ju vërejtje, t'u them se programet e punës së tri seksioneve (i Shkencave Shoqërore, i Shkencave të Natyrës dhe i Arteve) duhet të arsyetohen me hollësisht nga sekretarët e seksioneve, sipas modelit të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Përkundër problemeve financiare dhe dy shkurtimeve shtesë që erdhën nga Qeveria për të gjitha zërat financiarë në Kosovë, mund të konstatojmë se viti 2015 ishte një vit i sukseseve të Akademisë dhe të gjitha instancave të saj. Arriti t'i realizojë objektivat e veta, të parapara me programin e punës, të miratuar në fillim të korrikut 2015.

Patëm botime shkencore-profesionale dhe artistike, mbajtëm tryeza e konferenca shkencore dhe aktivitete të tjera shkencore dhe artistike etj. I kemi në materiale të gjitha aktivitetet e realizuara, në pasqyrën sipas seksioneve, me arsyetimet përkatëse, me vërejtjet që i thash, prandaj nuk do t'u marrë kohë që t'i përsëris. I japim në hollësi në Vjetarin për vitin 2015. I kemi edhe informatat për bashkëpunimin ndërkombëtar, ku nënshkrimi i Protokollit midis Akademisë sonë dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitet 2015-2017 zë një vend të

rëndësishëm; është Protokollin i tetë me radhë mbi bazë të Marrëveshjes së vitit 2000.

Gjithashtu edhe Shërbimi Administrativ, Profesional e Teknik i ASHAK, përgjegjës për ofrimin e shërbimeve administrative, profesionale e teknike, i ka kryer detyrat e veta në realizimin e Programit të punës të Akademisë dhe të aktiviteteve tjera të saj. Ky Shërbim ka arritur ta përmirësojë dhe ta ngritë cilësinë e shërbimeve administrative, profesionale e teknike me kosto shumë të ulët.

Vitin që shkoi i shënuam dy jubile të rëndësishme për Akademinë: 25-vjetorin e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, që u hartua nga anëtarët e Akademisë, me të cilën hidhen fillet e pavarësisë së sotme të Kosovës, dhe 40-vjetorin e ASHAK-ut. Me mirëkuptimin e Qeverisë dhe Ministrisë së Financave, duke na lejuar transferimin nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë shpenzime kapitale, arritëm t'i blinim një piano dhe një veturë të re, si nevojë të kahershme; 16 vjet e përdorëm një veturë, ajo e kreu funksionin e vet. Kishim dhe një angazhim shtesë; i mbajtëm zgjedhjet për Nënkryetar të Akademisë, duke i respektuar në tërësi normat ligjore dhe statutare në fuqi dhe vullnetin e votuesve. Por në punën tonë kishim edhe ngecje, ku me arsye e ku pa arsye.

Viti 2015 njihet dhe si vit i Ligjit për Akademinë, ku pas një beteje jo të lehtë 5-vjeçare u arrit aprovimi i tij.

Në këtë vit (2016) Akademia ishte pjesë e angazhimeve të Kosovës për

anëtarësim në UNESCO. Akademia iu drejtua me një letër Drejtoreshës së përgjithshme dhe të gjitha delegacioneve të UNESCO-s, me argumentimin shkencor për arsyeshmërinë e hyrjes së Kosovës në këtë organizatë të OKB-së. Po ashtu, në një letër tjetër ASHAK-u e ka kundërshtuar letrën e SANU-së me qëllim të flakjes së gënjeshtreve të saj për të penguar anëtarësimin e Kosovës në UNESCO. I shkruam të gjitha akademive të botës.

Viti 2015 do të mbahet në mend në historinë e Akademisë edhe për anën e pikëllueshme, për humbjet biologjike që patëm. U ndanë nga jeta 5 anëtarë të Akademisë, të cilët i përcollëm me respektin më të madh (Engjëll Berisha, Ruzhdi Pllana, Esat Stavileci, Mark Krasniqi dhe nënkryetari Pajazit Nushi). E falënderoj stafin e Administratës, me Sekretaren në krye, për angazhimin në organizimin e përcjelljes së anëtarëve të ndjerë për në banesat e fundit, si dhe për shënimin e dy përvjetorëve të përmendur.

Për këtë vit, 2016, për shkak të reduktimeve financiare na duhet një menaxhim më i mirë, një racionalitet dhe një prioritet në aktivitetin tonë shkencor, artistik dhe profesional, në përputhje me kriteret që i kemi aprovuar në organet e Akademisë, në Kryesi dhe në Kuvend. Nuk duhet t'i lëmë anash edhe burimet e tjera, çfarë janë donacionet, të lejuara me ligjin për Akademinë. T'u them se këtë vit prioritet do të ketë Fjalori Enciklopedik. Me rishikim do të kërkojmë dhe mjete shtesë për këtë qëllim.

Në këtë vit na presin punë të mëdha në hartimin e Statutit dhe të akteve tjera normative konform Ligjit të ri të Akademisë. Një version i Statutit tashmë është hartuar nga Komisioni adekuat që e ka ngritur Kryesia. Para shqyrtimit në mbledhjen e një Kryesie, do ta keni edhe nëpër seksione ku mund të jepni vërejtje dhe sugjerime.

Viti 2016 do të jetë dhe vit i zgjedhjeve, një aktivitet shumë i dobishëm dhe i përgjegjshëm, përveç tjerash se për herë të parë i mbajmë sipas Ligjit të ri, me disa kriteret krejt të reja sa i përket moshës së pranimit dhe çështjeve tjera.

Ju faleminderit!"

Pas fjalës së Kryetarit filloi shqyrtimi i pikave të rendit të ditës.

Ad. 1.-

Procesverballi i mbledhjes LXXXVI të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kuvendi shqyrtoi Raportin e punës së ASHAK për vitin 2015, me radhë sipas seksioneve. Kryetari Islami tha se seksionet i kanë mbajtur mbledhjet me kohë dhe i kanë miratuar raportet e tyre. Raporti i kompletuar është shqyrtuar më pas nga Kryesia e Akademisë dhe miratimi përfundimtar i mbetet sot Kuvendit.

Gjatë shqyrtimit të Raportit të Seksionit të Shkencave Natyrore N. Daci në diskutimin e tij shprehu shqetësim lidhur me botimin e revistës Kërkime. Ai tha se nuk ka prurje të materialeve për revistë dhe vërehet

një zbehje e interesimit për të botuar, meqë punimet e botuara në këtë revistë nuk vlerësohen për zgjedhje të stafit akademik në Universitet. R. Ismajli në diskutimin e tij tha se për revista është e nevojshme të merret ISSN-ja. Ai tha se duhet drejtuar Qeverisë dhe dy ministrive përkatëse MASHT dhe MKRS që të ndërmarrin veprimet e nevojshme, ashtu që revistat që botohen në Kosovë të kenë mundësi të marrin ISSN-në.

Pas diskutimeve Kuvendi miratoi Raportin e punës për vitin 2015, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe do të botohet në Vjetari 2015.

Ad. 3.-

Më pas u shqyrtua edhe Raporti financiar i Akademisë për vitin 2015, i cili u miratua pa vërejtje. Raporti është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Mbledhja u mbyll në orën 12:10

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXVIII e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 11 maj 2016, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Mehmet Kraja,

Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Sabri Hamiti, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrëspondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi, Xhevdet Xhafa dhe Zejnullah Rrahmani.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari Hivzi Islami.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXVII të Kuvendit;

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës;

4. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes LXXXVII të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Ad. 2.-

Kryetari Islami njoftoi Kuvendin se Kryesia e Akademisë në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2016 ka ngritur Grupin punues në përbërje prej: Lendita Pula, sekretare e Akademisë, akademik Isuf Krasniqi, anëtar korrëspondent Arsim Bajrami dhe Ali Caka, drejtor i DPPTIK. Grupi ka

punuar në përbërje të plotë, ka mbajtur takimet e rregullta dhe ka hartuar draftin e parë të Statutit të Akademisë dhe të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë. Të dy draftet janë shqyrtuar në mbledhjen e rregullt të Kryesisë mbajtur më 3 mars 2016 dhe më pas u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Akademisë. Bashkë me të dy draftet anëtarëve të Akademisë u është ndarë edhe njoftimi përcjellës me të cilin janë njoftuar që vërejtjet dhe sugjerimet të paraqiten me shkrim dhe të nënshkuara, në mbledhjet e seksioneve dhe më pas sekretarët e seksioneve pas shqyrtimit të draftit të Statutit dhe të Rregullores nëpër seksione, vërejtjet dhe sugjerimet eventuale t'ia paraqesin me shkrim dhe të nënshkuara, Kryesisë së Akademisë, më së voni deri më 1 prill 2016. Gjatë kësaj kohe janë mbajtur mbledhjet e seksioneve dhe janë pranuar me shkrim të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Përveç kësaj sekretarja e Akademisë ka konsultuar edhe veç e veç me anëtarë të Akademisë duke u munduar të marrë sa më shumë mendime. Kryetari e falënderoi grupin punues veçanërisht sekretaren për punën e bërë. Ai më pas ftoi sekretaren e Akademisë të njoftojë Kuvendin me rrjedhën e punës së Grupit punues.

L. Pula në fjalën e saj njoftoi se pas ngritjes së Grupit punues për hartimin e Statutit dhe të Rregullores, ka filluar menjëherë puna në hartimin e të dy drafteve. Pas hartimit draftet e para bashkë me Ligjin për ASHAK u janë ndarë të gjithë anëtarëve të Aka-

demisë. Gjatë muajit mars janë mbajtur mbledhjet e seksioneve ku janë shqyrtuar të dy draftet, me përjashtim të SGJL i cili ka shqyrtuar në mbledhje të rregullt vetëm Statutin, ndërsa për Rregulloren kemi marrë sugjerimet nga Sekretari Seksionit, akademik Basha.

Nga 30 anëtarë të Akademisë vërejtje dhe sugjerime me shkrim rreth Statutit kanë paraqitur 9 anëtarë, 6 prej tyre kanë paraqitur vërejtje dhe sugjerime përmbajtjesore, ndërsa tre të tjerë kanë paraqitur vetëm vërejtje për çështje teknike.

Pas mbledhjeve të seksioneve Grupi punues është mbledhur dhe i ka shqyrtuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e pranuar, si dhe gjatë punës i ka shqyrtuar edhe vërejtjet dhe sugjerimet që janë diskutuar nëpër seksione dhe të cilat janë paraqitur në procesverbalet e mbledhjeve të seksioneve. Shumica e tyre janë marrë parasysh dhe janë in-korporuar në draftet të cilat do të shqyrtohen sot dhe të cilat janë ndarë me kohë. Disa vërejtje dhe sugjerime nuk janë in-korporuar, meqë ato bien ndesh me Ligjin për ASHAK. Grupi punues e ka njoftuar Kryesinë e Akademisë me ndryshimet dhe plotësimet e Statutit dhe të Rregullores dhe Kryesia është pajtuar.

Në fund, në emër të grupit, ajo i falënderoi të gjithë për bashkëpunim!

Në vazhdim Kryetari Islami, në bazë të evidencës së Shërbimit profesional administrativ të ASHAK, njoftoi se në sallë janë të pranishëm 27 anëtarë të Akademisë, kuorum ka dhe se

mbledhja mund të vazhdojë. Ai vazhdoi duke thënë se:” dokumentet miratohen me 2/3 e gjithë trupit votues, që do të thotë se për vendimmarrje duhen 19 vota. Në rast të votimit të neneve apo paragrafëve të diskutueshëm, në votim së pari del versioni i Grupit punues. Statuti nuk është i përhershëm, sepse nenet dhe dispozitat e caktuara mund të ndryshohen e plotësohen kur të mendojë Kuvendi se duhet bërë, gjë që nuk është rasti me Ligjin, sepse atë e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës. Dhe e dyta, çështjet që nuk rregullohen me këtë Statut përcaktohen me rregulloret e veçanta të Akademisë (neni 1, paragrafi 2 i Statutit)”. Ai propozoi që shqyrtimi i të dy dokumenteve, Statutit dhe Rregullores, të bëhet nen për nen, duke u ndaluar vetëm në nenet ku ka vërejtje dhe sugjerime. Kuvendi e pranoi këtë qasje të punës të propozuar nga Kryetari dhe vazhdoi punën.

Diskutuan M. Kraja, N. Daci, M. Dushi, Fejzullah Krasniqi, S. Hamiti, L. Mulliqi, Z. Ballata. Diskutimet u bënë për nenet: 25, 26, 27, 31, 32 dhe 41.

U propozua që:

- Neni 27, paragrafi 2, të bartet te neni 25 dhe të plotësohet: “Të drejtat dhe detyrat e anëtarit të Akademisë pezullohen me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë për kohën, mbi një vit, që ai nuk jeton dhe nuk vepron në Kosovë”;

- Neni 27, nënparagrafi 1.3 të shtohet: “Me vendim të veçantë të Kuvendit të Akademisë”;

- Neni 31, nënparagrafet 5.1 dhe

5.3, të riformulohen:

5.1. “Anëtarëve të Akademisë që ushtrojnë funksione udhëheqëse ditën që mbushin moshën 75 vjeç u ndërpritet ushtrimi i funksionit udhëheqës”;

5.3. “Anëtarët e Akademisë që zgjidhen në vende udhëheqëse nëpërmjet procedurës së zëvendësimit, në rastet e skadimit të mandatit sipas nënparagrafit 5.1. të këtij neni, ushtrojnë mandatin e mbetur deri në zgjedhjet e reja sipas nënparagrafit 5.2 të këtij neni” ;

- Neni 32, nënparagrafi 1.16 të hiqet “akte normative”;

- Neni 41, paragrafi 2 të riformulohet:

“Kryetari, Nënkryetari, Sekretari shkencor dhe sekretarët e seksioneve të Akademisë i kryejnë funksionet në të cilat janë zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij statuti, deri më kalimin e mandatit”.

Propozimi i L. Mulliqit për plotësimin e nenit 40 me shënimin që: “mjetet financiare të Akademisë t’u ndahen seksioneve në mënyrë të barabartë” u tha se nuk mund të pranohet, meqë bie ndesh me Ligjin për Akademinë, ndërsa propozimi i Fejzullah Krasniqit që neni 40, paragrafi 2 të plotësohet dhe të përshtatet me paragrafin 3, të nenit 5, u tha se duhet të shikohet përshtatja me Ligjin për ASHAK.

Kuvendi me 26 vota për dhe një kundër miratoi Statutin e Akademisë me plotësimet, sipas propozimeve që u dhanë.

Ad. 3.-

Pas miratimit të Statutit, Kuvendi filloi shqyrtimin nen për nen të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Lidhur me Rregulloren M. Kraja dha disa vërejtje dhe sugjerime të cilat u pranuan. Kuvendi me 26 vota për dhe një kundër miratoi Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Pas miratimit të Statutit dhe të Rregullores kryetari Islami falënderoi të gjithë anëtarët e Akademisë për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë.

Pas fjalës së Kryetarit, fjalën e kërkoi M. Dushi.

Ai në diskutimin e tij tha se dëshiron edhe një herë të debatojë për botimin e librit “Klima e Kosovës”, me autor Ruzhdi Pllana, tani më i ndjerë. Ai tha se është i hidhëruar meqë nuk i është lejuar që në libër të figurojë një paragraf të cilin ai vetë e ka shkruar.

Me këtë rast ndërhyri Kryetari Islami duke thënë se është në dijeni për rastin, por se kjo çështje nuk është në rend të ditës së mbledhjes së sotme të Kuvendit. Ai tha se çështja e botimit në fjalë është shqyrtuar në Seksionin e Shkencave të Natyrës dhe se kjo temë konsiderohet e mbyllur, prandaj sot në këtë seancë nuk ka vend për këtë lloj diskutimi. Ai e shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit.

Mbledhja u mbyll në orën 13:10

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja LXXXIX e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 30 qershor 2016, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Idriz Ajeti, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi, Xhevdet Xhafa dhe Zejnullah Rahmani.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari Hivzi Islami.

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXVIII të Kuvendit;
2. Miratimi i Programit të punës së Akademisë për vitin 2017;
3. Çështje vijuese.

Ad. 1.-

Para miratimit të procesverbalit të

mbledhjes LXXXVIII të Kuvendit të Akademisë, M. Dushi dha disa vërejtje për plotësimin e procesverbalit. Ai tha se pika e fundit: Çështje vijuese, nuk figuron në procesverbal dhe më pas paraqiti vërejtjet e tij duke thënë se në procesverbal nuk është pasqyruar e gjithë fjala e tij, fjala e Kryetarit dhe rrjedha e diskutimit. Pas fjalës së M. Dushit, Kryetari Islami kërkoi nga Sekretarja e Akademisë, si procesmbajtëse të ofrojë sqarimet e nevojshme.

Sekretarja e Akademisë tha se pika: Çështje vijuese nuk është përfshirë në procesverbal, meqë diskutimi i akademik Dushit ka pasuar menjëherë pas miratimit të Rregullores për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë, pa kaluar fare te pika e fundit e rendit të ditës. Ndërsa sa i përket çështjes së mospërfshirjes së diskutimeve në procesverbal ajo tha se është munduar të përfshijë aq sa ka pasur mundësi kohore, meqë çdo gjë rreth diskutimit ka rrjedhur shpejtë. Sekretarja më pas tha se në raste të tilla, kur ka diskutime më të gjata, është praktikë që diskutuesit t'i sjellin ato me shkrim në administratë, ashtu që tekstet të futen në thonjëza, por nga Kuvendi i kaluar edhe pse ka pasur kohë, ajo tha se nuk ka marrë asgjë me shkrim as nga akademik Dushi dhe as nga Kryetari i Akademisë.

Pas sqarimit të Sekretares u hap diskutimi. Diskutuan N. Daci, R. Ismajli, S. Hamiti. Në diskutimet e tyre ata propozuan që kjo çështje të mbyllet dhe të kalohet në pikën tjetër të rendit të ditës. Propozimi u përkrah edhe nga

anëtarët e tjerë të Akademisë dhe procesverbalit u miratua pa plotësime, ashtu siç është dorëzuar me materialet e Kuvendit. U tha se në të ardhmen, kur ka rastet e të tilla, shkresat të deponohen në administratë dhe ato të futen në procesverbale ashtu siç janë në origjinal.

Ad. 2.-

Në kuadër të kësaj pike të rendit të ditës Kryetari Islami para fillimit të shqyrtimit të Programit të punës së ASHAK për vitin 2017, tha se Programi i punës për vitin 2017 është shqyrtuar fillimisht në mbledhjet e seksioneve përkatëse të Akademisë dhe më pas edhe në Kryesinë e saj. Ai shtoi se Programi i punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë (SGJL) dhe Programi i punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore (SSHS) është mjaft i pasur, ndërsa shtoi se Programi i Seksionit të Shkencave të Natyrës (SSHN) dhe Programi i Seksionit të Arteve (SA) kanë mundësi të jenë më të pasur. Ai sugjeroi sekretarët e këtyre dy seksioneve (SSHN dhe SA) që të bëjnë përpjekje dhe të punojnë edhe në drejtim të organizimit të tubimeve shkencore: konferencave, tryezave e aktiviteteve të tjera. Kryetari apeloi te sekretarët e seksioneve që t'i përcjellin afatet dhe të fillojnë me kohë punën për përgatitjen e programeve të punës. Ai shtoi se secili sekretar duhet t'i dijë detyrat e veta dhe duhet t'i kryejë ato me përgjegjësi dhe në kohë.

Më pas filloi shqyrtimi i Programit të punës së ASHAK me rend sipas seksioneve.

Gjatë shqyrtimit të Programit të punës së Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, R. Ismajli dha disa sqarime për Qendrën për Leksikografi dhe Enciklopedi. Ai tha se pas përfundimit të vizitës studimore në Akademinë Austriake të Shkencave në Vjenë ka përgatitur një raport për vënien në veprim të Qendrës për Leksikografi dhe Enciklopedi. Raporti në formë aneksi është pjesë e Programit të punës së SGJL. Ai propozoi që të bëhet një ndryshim, ashtu që të fshihet fjala Enciklopedi dhe të mbetet vetëm emërtimi Qendra për Digjitalizim dhe Leksikografi. Propozimi u përkrah.

Më pas filloi shqyrtimi i Programit të Punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore. M. Kraja në diskutimin e tij fillimisht bëri disa vërejtje për formën e hartimit të programeve sipas seksioneve, duke thënë se duhet të ekzistojë një standard i hartimit të programeve. Me këtë rast ndërhyri Kryetari Islami i cili u pajtua me vërejtjen në fjalë dhe apeloj te sekretarët e seksioneve që të ndjekin versionin e SGJL, ashtu siç është thënë edhe në Kryesi. Më pas M. Kraja vazhdoi diskutimin për Programin e punës së Seksionit të Shkencave Shoqërore, duke u ndalur te pika 3, projekti: "Hasan Prishtina në dokumentet arkivore". Ai u shpreh se është kundër kësaj pike, përkatësisht është kundër që bartës i projektit të jetë Oliver Schmitt, duke pasur parasysh se ai nuk njihet për shkrime të mira për Kosovën dhe shqiptarët. Pas fjalës së akademik Krajës, për këtë pikë u hap diskutimi. J. Bajraktari, sekretar i SSHSH dhe bartës i projektit nga ana e

ASHAK tha se projekti në fjalë është rezultat i bashkëpunimit të Akademisë sonë me Akademinë e Shkencave të Austrisë, propozimi ka dalë nga vetë Akademia Austriake dhe nuk ka arsye të mos pranohet, duke marrë parasysh se Schmitt, njihet si studiues solid në studimet ballkanologjike. N. Daci në diskutimin e tij tha se projekti në fjalë është i rëndësishëm së veçantë, por u shpreh kundër që të ketë bashkautorësi, meqë siç tha ai në Shkencat shoqërore kjo nuk është praktikë. Kryetari Islami në diskutimin e tij sqaroi se ideja e projektit ka dalë nga vizita e fundit (mars 2016) e delegacionit të Akademisë Austriake. Ai tha se në takimin e mbajtur në ASHAK është biseduar gjerësisht për tema që i përkasin të gjitha seksioneve të ASHAK. Ai më pas tha se Profesor Schmitt gjatë qëndrimit në Kosovë është takuar edhe me përfaqësues të institucioneve përkatëse dhe projektin e ka paraqitur me shkrim dhe e ka arsyetuar mirë. Ai është historian i njohur dhe se ASHAK në bashkëpunim me të do të ndriçojë mirë figurën e Hasan Prishtinës. J. Bajraktari edhe një herë e mori fjalën dhe sqaroi se në tërë këtë projekt flitet vetëm për mbledhjen e dokumenteve arkivore, nuk flitet për botim dhe bashkautorësi. Nga ana e Akademisë Austriake duhet një bartës i projektit, meqë ata kanë qasje në shumë arkiva dhe mund të mbledhin më shumë të dokumente. R. Ismajli në diskutimin e tij fillimisht tha se nuk pajtohet me vlerësimin e M. Krajës për O. Schmitt. Ai më pas sqaroi se gjatë kontakteve me Akademinë Austriake është biseduar gjatë për

këtë projekt dhe se çështja e bashkautorësisë po keqkuptohet. Fjala është vetëm për hulumtime dhe mbledhje të dokumenteve nga të gjitha arkivat dhe në këtë rast është e nevojshme që edhe nga pala austriake të ketë një përfaqësues, ndërsa shtoi se përgjegjësinë për materialet e mbledhura do ta ketë bartësi nga ASHAK, përkatësisht SSHSH.

Gjatë shqyrtimit të Programit të punës së Seksionit të Shkencave të Natyrës, M. Kraja diskutoi për botimin: "Regjioni lindor i Kosovës (Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet gjeomjedisore)", me autor Valbon Bytyçi. Ai tha se në raste të tilla kur autorët janë jashtë Akademisë do të duhej që dorëshkrimi të jetë i gatshëm e jo vetëm të jepet propozimi. N. Daci tha se çështja e botimit në fjalë është diskutuar gjerë e gjatë në Seksion dhe se është propozuar që dorëshkrimi të ketë edhe një koautor nga ASHAK. Në këtë rast është propozuar që koautor të jetë akademik Hivzi Islami, si njohës i mirë i fushës përkatëse. H. Islami dhe M. Dushi u shprehën kundër këtij propozimi, me arsyetimin se nuk është praktikë t'i pranohet dikujt botimi i veprës dhe t'i caktohet koautori nga ASHAK.

Në fund u shqyrtua edhe Programi i punës i Seksionit të Arteve. Z. Ballata në diskutimin e tij tha se në Program nuk është përfshirë saktë mbajtja e ndonjë programi artistik gjatë vitit dhe propozoi që edhe një pikë si kjo të futet në program. Lidhur me këtë kryetari Islami tha se çështja e

organizimit të programeve artistike dhe të tryezave shkencore të të gjitha zhanreve është e hapur dhe se ato mund të organizohen sipas mundësive dhe rasteve.

Pas shqyrtimit të programeve të punës sipas seksioneve, Kuvendi me shumicë votash miratoi Programin e punës së Akademisë për vitin 2017.

Programi është pjesë përbërëse e procesverbalit.

Mbledhja u mbyll në orën 12:35

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

PROCESVERBAL

Nga mbledhja XC e Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, mbajtur më 21 dhjetor 2016, ora 11:00, në mjediset e Akademisë.

Në mbledhje marrin pjesë akademikët: Ali Aliu, Ekrem Murtezai, Eqrem Basha, Feriz Krasniqi, Fejzullah Krasniqi, Hivzi Islami, Isa Mustafa, Isuf Krasniqi, Mehmet Kraja, Minir Dushi, Nexhat Daci, Rauf Dhomi, Rexhep Ferri, Rexhep Ismajli, Sabri Hamiti, Tahir Emra, Zeqirja Ballata dhe anëtarët korrespondentë: Anton K. Berishaj, Arsim Bajrami, Arsim Morina, Edi Shukriu, Jusuf Bajraktari, Luan Mulliqi, Mehmet Halimi, Qamil Haxhibeqiri, Salih Gashi, Xhevdet Xhafa dhe Zejnullah Rrahmani.

Merr pjesë edhe Lendita Pula, sekretare e Akademisë.

Mbledhjen e hapi kryetari Hivzi Islami. i cili në fillim, ndër të tjera theksoi:

“Kolegë të nderuar, mirë se vini në Mbledhjen e XC të Kuvendit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me rendin e ditës që e keni marrë me kohë. Kjo mbledhje e Kuvendit është zgjedhore dhe si e tillë është solemne. Pika të tjera të rendit të ditës nuk janë paraparë. A pajtoheni me rendin e ditës, a miratohet? Miratohet. Faleminderit!

Kuvendi e miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes LXXXIX të Kuvendit;
2. Emërimi i Komisionit të zgjedhjeve;
3. Paraqitja e arsyetimeve të shkurtra të sekretarëve të seksioneve për secilin kandidat (për anëtarë të rregullt, për anëtarë korrespondentë dhe për anëtarë të jashtëm);
4. Votimi dhe shpallja e rezultateve të votimit;

Pas miratimit të rendit të ditës Kryetari Islami, bazuar në Statutin e Akademisë, neni 29, paragrafi 14, propozoi që në kuorum të mos përfshihet akademik Rexhep Qosja. Propozimi u miratua njëzëri dhe në vazhdim Kryetari kërkoi nga Sekretarja e Akademisë të ofrojë sqarimet e nevojshme.

L. Pula njoftoi Kuvendin se në sallë janë të pranishëm 28 anëtarë të Akademisë, nga 30 sa janë gjithsej. Meqë një anëtar nuk përfshihet në

kuorum, mund të konstatohet se kuorumi për këtë mbledhje është 29 anëtarë, 18 anëtarë të rregullt dhe 11 anëtarë korrespondentë.

Sipas Ligjit për Akademinë, neni 15 dhe Statutit të Akademisë neni 24:

“Anëtari i rregullt zgjidhet me shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Akademisë”.

“Anëtari korrespondent zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë”.

“Anëtari i jashtëm dhe anëtari i nderit zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë”.

Mbi këtë bazë:

- Anëtar i rregullt zgjidhet kandidati që merr së paku 10 vota;
- Anëtar korrespondent zgjidhet kandidati që merr së paku 15 vota;
- Anëtar i jashtëm zgjidhet kandidati që merr së paku 15 vota.

Pasi u dhanë sqarimet e nevojshme Kuvendi filloi shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

Ad. 1.-

Procesverbali i mbledhjes LXXXIX të Kuvendit të Akademisë u miratua pa vërejtje.

Në vazhdim, Kryetari Islami u paraqit edhe një herë me fjalë rasti dhe ndër të tjera tha:

“Të nderuar kolegë, para se të procedojmë me votimin, më lejoni t’i them dy-tri fjalë.

Nga 53 propozime sa arritën në

Akademi, 14 prej tyre u mënjanuan për arsye ligjore dhe procedurale; një propozim u dha në një seksion. Në garë mbetën 40 kandidatë, prej të cilëve në procedurat e votimit në seksione nuk kaluan 31 kandidatë.

Nga 53 propozime sa kanë ardhur nga jashtë, dhe një propozim që është dhënë nga brenda, në garë kanë hyrë 40 kandidatë që i kanë plotësuar kushtet formale.

Seksionet në mbledhjet e tyre para Kuvendit kanë shtruar dhe kërkesat e tyre për numrin e anëtarëve të ri, të mundshëm që do të zgjidheshin në Akademi. Tri seksionet: Seksioni i Shkencave të Natyrës, Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Seksioni i Gjuhësisë dhe Letërsisë ishin në nivel të përgjegjësive, duke i sjell në Kuvend kandidatët ndër më të mirë të mundshëm për këtë moment; e dimë gjendjen momentale çfarë e kemi nëpër departamente, fakultete, institute. Na sollën tri femra po kështu ndër më të mira të mundshme dhe ngadalë, por sigurt po përmbushet edhe një kriter në funksion të rritjes së pjesëmarrjes së tyre. Të gjithë kandidatët e flasin nga një gjuhë të huaj, disa edhe nga dy, jashtë gjuhës serbokroate.

Efektet pozitive të Ligjit të ri për Akademinë, që vëri kufirin e hyrjes në Akademi deri në moshën 65 vjeçare, janë evidente: midis kandidatëve që kanë ardhur në këtë mbledhje të Kuvendit për t'u votuar, këto tri seksione kanë dhënë vizën dhe për kandidatë të rinj me moshë të re, nën 60 vjet dhe nën 50 vjet: 2 kandidatë

nga 42 vjet, i treti 43, i katërti 48, i pesti 53; të tjerët rreth 62-63 vjet. Këtë situatë nuk e kemi pasur më herët; mosha mesatare aktualisht është rreth 73 vjet, në se votohen të gjithë kandidatët e ri që kanë ardhur në Kuvend, ajo bie në rreth 67 vjet. Do të jetë një përtëritje e dukshme dhe një lajm i mirë.

Nuk ka asnjë arsye të mos votohen këta kandidatë si anëtarë korrespondentë, sepse për të ardhmen e seksioneve dhe të Akademisë këta janë me rëndësi, sikundër që nuk ka arsye të mos votohen kandidatët për anëtarë të jashtëm; këtu fitojmë vetëm ne si Akademi dhe si Kosovë, obligime ndaj këtyre të fundit nuk kemi.

Për herë të parë një anëtar i jashtëm, sipas kërkesës së tij, propozohet që me procedurë dhe nen të veçantë të Statutit të zgjidhet anëtar korrespondent, ky është prof. Muhamedin Kullashi, i cili në vitin 2000 është votuar në Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe është zgjedhur gati unanimitisht në Kuvend. Edhe tash sërish në Seksion është votuar unanimitisht – është fletëvotim i veçantë për të, por që hidhet në kutinë e kandidatëve korrespondentë.

Te avancimet: seksionet i kanë votuar gati unanimitisht kandidatët, ata janë këtu, i njohim tash e 4 vjet, e dimë edhe punën dhe aktivitetin e tyre. Sot, inatet i lëmë anash, të punojmë për të mirën e institucionit, të shkencës, të krijimtarisë! Megjithatë, votojmë për të gjithë sipas vlerësimit dhe ndërgjegjes sonë. Duket pak

e pakuptimtë të votimet në Kuvend që shkencat shoqërore të bëhen pengesë për shkencat e natyrës dhe e kundërta, apo artet dhe shkencat biologjike t'i imponojnë seksioneve tjera kandidatë me votimin në Kuvend. Megjithatë, ligji është ligj, votimi është i lirë, ndërgjegjja mbetet në duar të votuesve.

Seksioni që dështoi qindpërqind është Seksioni i Arteve. Kur u kërkuan kuotat, tri seksionet e tjera kërkuan deri katër kandidatë, Kryesia u dha nga 3, me kërkesë që i treti të jetë grua, por jo me çdo kusht, gra të përgatitura. Seksioni i Arteve e kërkoi vetëm një, ndërsa mund të kërkonte të paktën 3 për të bërë një baraspeshë midis seksioneve dhe Kryesia do t'u jepte edhe aq. Në një anë ankohen, kjo Akademi është e shkencave dhe e arteve, prandaj duhet të ndahen edhe mjetet përgjysmë, kërkesë e tyre e kamotshme, sikundër që në disa palë zgjedhje kanë kërkuar vetëm nga një kandidat. Tash nuk e donë asnjë kandidatë! Do ta mbyllin Seksionin vetë! Shtrohet pyetja: nëse këta nuk e duan veten, profesionin e vet, atëherë pse ne t'i duam këta!

Nëse mekanizmat biologjikë mbesin *status quo*, këto tri seksione pas 4 vjetëve do të kenë nga 13-14 anëtarë, ndërsa artet ashtu siç po sillen ndaj vetvetes, do të mbesin me 6 veta dhe më pak nëse veprojnë mekanizmat biologjikë!

Tani do t'i marrim fletëvotimet një nga një sipas kategorive dhe do të votojmë në 3 kutia. Së pari votohet për anëtarët e rregullt, pastaj për anëtarët

korrespondentë dhe anëtarët e jashtëm.

Komisioni do të merret me numërimin e votave në këtë sallë. Në dispozicion është Sekretarja me shërbimin profesional-administrativ.

Për anëtarë të Komisionit zgjedhor propozojmë akademikët: Feriz Krasniqi, Zeqirja Ballata dhe Sabri Hamiti.

Faleminderit!"

Ad. 2.-

Kuvendi emëroi njëzëri Komisionin e zgjedhjeve në përbërje prej akademikëve: Feriz Krasniqi, Zeqirja Ballata dhe Sabri Hamiti.

Ad. 3.-

Kryetari Islami, sqaroi se sipas Rregullores për zgjedhjet, sekretarët e Seksioneve duhet të raportojnë me nga disa rreshta për çdo kandidat që ka ardhur në Kuvend. Ata i kanë përgatitur arsyetimet e shkurtra për secilin kandidat dhe se janë të gatshëm t'i lexojnë. Me këtë rast disa anëtarë të Akademisë propozuan që arsyetimet mos të lexohen, ashtu që mos të humbet kohë, meqë anëtarët e Akademisë i kanë marrë me kohë materialet (recensionet) për secilin kandidat dhe kanë pasur kohë të mjaftueshme për t'i lexuar ato. Propozimi u miratua dhe Kuvendi vazhdoi punën.

Ad. 4.-

Para fillimit të procesit të votimit diskutuan R. Dhomi dhe M. Dushi.

Në diskutimin e tij R. Dhomi propozoi që në të ardhmen procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Akademisë

të kryhet nëpër seksione, ndërsa në Kuvend të bëhet vetëm miratimi i zgjedhjes së tyre, ndërsa M. Dushi propozoi që të gjithë kandidatët e propozuar për anëtarë të Akademisë të shkojnë për votim në Kuvend, por prioritet të kenë anëtarët e votuar nëpër seksionet përkatëse.

Me këtë rast Kryetari Islami sqaroi se të gjitha procedurat deri më tani janë zhvilluar duke u bazuar në Ligjin dhe Statutin e Akademisë dhe propozimet përkatëse nuk mund të implementohen.

Pas diskutimeve u ndanë fletëvotimet. Pas përfundimit të votimit, Komisioni i hapi me radhë kutitë e votimeve, i numëroi fletëvotimet dhe i hartoi raportet përkatëse për rezultatet e votimeve të cilat i paraqiti para Kuvendit.

Votimi për anëtarë të rregullt (akademikë) kanë dhënë këto rezultate:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Kanë votuar 17 anëtarë të rregullt të ASHAK.
2. Fletëvotime të vlefshme 12
3. Fletëvotime të pavlefshme 5

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Mehmet Halimi 6 vota
2. Zejnullah Rrahmani 11 vota

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Kanë votuar 17 anëtarë të rregullt të ASHAK.

2. Fletëvotime të vlefshme 16

3. Fletëvotime të pavlefshme 1

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Anton K. Berishaj 12 vota
2. Arsim Bajrami 6 vota
3. Edi Shukriu 8 vota
4. Jusuf Bajraktari 13 vota

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Kanë votuar 17 anëtarë të rregullt të ASHAK.

2. Fletëvotime të vlefshme 12

3. Fletëvotime të pavlefshme 5

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Arsim Morina 6 vota
2. Qamil Haxhibeqiri 9 vota
3. Salih Gashi 6 vota

IV. Seksioni i Arteve

1. Kanë votuar 17 anëtarë të rregullt të ASHAK.

2. Fletëvotime të vlefshme 10

3. Fletëvotime të pavlefshme 7

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Luan Mulliqi 7 vota
2. Xhevdet Xhafa 9 vota

Komisioni, në bazë të rezultatit të votimit, i shpall para Kuvendit të Akademisë emrat e kandidatëve që kanë marrë numrin e nevojshëm të votave dhe në këtë mënyrë janë zgjedhur anëtarë të rregullt (aka-

demikë) të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Zejnullah RRAHMANI

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Anton K. BERISHAJ
2. Jusuf BAJRAKTARI

Votimi për anëtarë korrespondentë kanë dhënë këto rezultate:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Kanë votuar 28 anëtarë të ASHAK.
2. Fletëvotime të vlefshme 22
3. Fletëvotime të pavlefshme 6

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Bardh Rugova 15 vota
2. Kujtim Shala 19 vota

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Kanë votuar 28 anëtarë të ASHAK.
2. Fletëvotime të vlefshme 24
3. Fletëvotime të pavlefshme 4

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Frashër DEMAJ 17 vota
2. Gjyljeta MUSHKOLAJ 15 vota
3. Justina PULA 18 vota

Për Muhamedin Kullashi (fletëvotim i veçantë):

1. Kanë votuar 28 anëtarë të ASHAK
2. Fletëvotime të vlefshme 26

3. Fletëvotime të pavlefshme 2

1. Muhamedin KULLASHI 26 vota

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Kanë votuar 28 anëtarë të ASHAK.
2. Fletëvotime të vlefshme 23
3. Fletëvotime të pavlefshme 5

Kandidatët e propozuar kanë marrë votat si më poshtë:

1. Fetah PODVORICA 16 vota
2. Myzafere LIMANI 17 vota
3. Shukri FETAHU 14 vota

Komisioni, në bazë të rezultatit të votimit, i shpall para Kuvendit të Akademisë emrat e kandidatëve që kanë marrë numrin e nevojshëm të votave dhe në këtë mënyrë janë zgjedhur anëtarë korrespondentë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Bardh RUGOVA
2. Kujtim SHALA

II. Nga Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Frashër DEMAJ
2. Gjyljeta MUSHKOLAJ
3. Justina PULA
4. Muhamedin KULLASHI

III. Nga Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Fetah PODVORICA

2. Myzafere LIMANI

Procesmbajtëse

Lendita Pula

Votimi për anëtarë të jashtëm kanë dhënë këto rezultate:

Kryetari i Akademisë

Akademik Hivzi Islami

1.Abdylmenaf BEXHETI 12 vota

2.Bahri BECI 17 vota

3.Gëzim QENDRO 11 vota

4.Kristaq PRIFTI 20 vota

5.Luan STAROVA 11 vota

6. Matteo MANDALA 20 vota

7.Mentor PETRELA 19 vota

Komisioni, në bazë të rezultatit të votimit, i shpall para Kuvendit të Akademisë emrat e kandidatëve që kanë marrë numrin e nevojshëm të votave dhe në këtë mënyrë janë zgjedhur anëtarë të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës:

1.Bahri BECI

2.Kristaq PRIFTI

3.Matteo MANDALA

4.Mentor PETRELA

Pas komunikimit të rezultateve të votimit, Kryetari i Akademisë konstatoi se procesi zgjedhor është përshkuar me respektimin e procedurave të parapara me Statut dhe me Rregulloren për propozimin dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë dhe uroi anëtarët e zgjedhur.

Mbledhja u mbyll në orën 13:15

KRONIKA E VITIT 2016



(Aktivitete shkencore, ekspozita, vizita, përvjetorë, ligjërata, përrime...)

**AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MERR
PJESË NË KONFERENCËN
NDËRKOMBËTARE SHKENCORE
“TOMOR OSMANI”**

Me ftesë të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave Humane, Departamenti i Gjuhësisë, akademik Rexhep Ismajli, më 27 janar 2016 mori pjesë në konferencën ndërkombëtare shkencore “Tomor Osmani: një jetë me Albanologjinë”.

Akademik Rexhep Ismajli paraqiti kumtesën me titull: “Tomor Osmani gjuhëtar”.

**TAKIM PUNE NË AKADEMINË E
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË
MAQEDONISË**

Akademikët Ali Aliu dhe Eqrem Basha më 28 janar 2016 qëndruan në Shkup, në Akademinë Maqedone dhe u pritën

nga akademikët Gjorgji Stardelov dhe Luan Starova.

Në takim u diskutuan detajet dhe ecuria e përgatitjes së antologjive të autorëve – letrarë të ASHAK dhe ASHAM.

Takimi u realizua në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy akademive.

**AKADEMIK REXHEP ISMAJLI MERR
PJESË NË KONFERENCËN SHKENCORE
“ISMAIL KADARE: LEXIMI DHE
INTERPRETIMI”**

Me ftesë të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, akademik Ismajli, më 12 shkurt mori pjesë në emër të ASHAK në Konferencën shkencore “Ismail Kadare - leximi dhe interpretimi. Ai paraqiti kumtesën me titull: “Tematizohet shoqëria e sakrificës?”



DELEGACIONI I AKADEMISË SË SHKENCAVE TË AUSTRISË VIZITË PUNE NË ASHAK

Me ftesë të Kryetarit të ASHAK, akademik Hivzi Islami, më 1-2 mars 2016 delegacioni i Akademisë së Shkencave të Austrisë i përbërë nga akademikët: Michael Alram, nënkryetari i Akademisë, Brigitte Mazohl, kryetare e Seksionit të Shkencave Sociale dhe Oliver Schmitt, zhvilloi një vizitë pune në ASHAK. Delegacioni u rit dhe u shoqërua tërë kohën nga akademik Rexhep Ismajli, kryetar i Komisionit për marrëdhënie ndërkombëtare. Në takimin e mbajtur në mjediset e Akademisë të dy palët biseduan për mundësitë e bashkëpunimit. Nga ASHAK u propozuan temat konkrete të bashkëpunimit për: Korpusin nacional të shqipësisë; Fushën e

arkeologjisë dhe të antikës; projektin: Hasan Prishtina në dokumentet arkivore, si dhe për shkencën e mjedisit.

BOTIMET E ASHAK NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR TË LIBRIT "SALON DU LIVRE DE PARIS"

Më 17 deri 20 mars 2016, në Paris është mbajtur panairi ndërkombëtar i librit "Salon du livre de Paris".

Mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Kosovës, në këtë ngjarje të rëndësishme kulturore janë prezantuar për herë të parë edhe botues kosovarë, përmes Shoqatës së Botuesve të Kosovës. Në mesin e rreth 120 titujve të botuesve më të njohur të Kosovës, janë prezantuar edhe një numër i konsiderueshëm i botimeve të ASHAK.

Panairi ndërkombëtar i librit "Salon du



livre de Paris" është ndër ngjarjet kulturore më mëdha të këtij lloji në Evropë dhe çdo vit mirëpret rreth mbi 1200 botues që përfaqësojnë 25 shtete.

TELEGRAM NGUSHËLLIMI ME RASTIN E VDEKJES SË AKADEMIK ZEF MIRDITA

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës shpreh dhembje të thellë për ndarjen nga jeta e Akademik Zef Mirdita. Akademik Mirdita ishte një nga personalitetet e njohura të jetës akademike dhe intelektuale të Kosovës, i cili ka lënë gjurmë të pashlyera në fushën e studimeve historike të periudhës së antikës, në veçanti në studimin dhe trajtimin shkencor të ilirëve. Profesor Mirdita ka qenë një nga pedagogët e nderuar të Universitetit të Prishtinës i cili ka nxjerrë shumë gjenerata të historianëve të rinj. Ai nga vitet e 90-ta të shekullit të kaluar ka jetuar dhe ka punuar në Republikën e Kroacisë, pa u ndarë nga veprimtaria hulumtuese shkencore, ku ka botuar një varg studimesh të vlefshme për historinë. Ai ishte anëtar i Akademisë sonë i cili do të kujtohet me pietet të veçantë.

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes dhe gjithë farefisit të tij.

Në Prishtinë, më 5 prill 2016.

NDËRROI JETË AKADEMIK LATIF SUSURI

Më 14 prill vdiq anëtari i rregullt i ASHAK, akademik Latif Susuri. Mbledhja komemorative u mbajt në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Mbledhjen e hapi

akademik Hivzi Islami, kryetar i Akademisë, ndërsa për jetën dhe veprën e akademik Susurit foli sekretari i Seksionit të Shkencave të Natyrës, akademik Fejzullah Krasniqi, i cili ndër të tjera theksoi:

"Vdekja e akademik Susurit është humbje e madhe për familjen, shkencën, Akademinë, për kolegët dhe miqtë nga Kosova dhe më gjerë. Akademik Latif Susuri lindi më 7.05.1941 në Zhur, ku e kreu shkollën fillore. Shkollën e mesme bujqësore e mbaroi në Prishtinë, ndërsa Fakultetin e Bujqësisë në Universitetin e Beogradit, në vitin 1975. Disertacionin e doktoratës e mbrojti në Fakultetin e Agronomisë të Universitetit të Zagrebit, në vitin 1983. Si bursist i disa fondacioneve qëndroi për studime specialiste në SHBA, në Angli dhe në qendra të tjera. Në vitin 1977 zgjidhet ligjërues në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës dhe pastaj i merr të gjitha thirrjet akademike deri te profesori ordinar. Ishte dhe dekan i këtij Fakulteti. Në vitin 2000 u zgjedh anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Preokupimi kryesor i akademik Susurit ishte puna shkencore-hulumtuese në fushën e sëmundjeve të bimëve, të fitopatologjisë. Nga lëmi i ngushtë ka botuar shumë punime në revista të njohura shkencore në vend dhe në botën e jashtme (SHBA, Gjermani, Itali, Hungari, Slloveni, Kroaci etj.). Ishte profesor mysafir në disa universitete dhe anëtar i disa shoqatave profesionale. Për punën e tij ka marrë shumë mirënjohje.

Me këtë rast, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes Susuri, miqve dhe dashamirëve të tij gjithandej Kosovës dhe mbarë botës shqiptare”.

Pas mbledhjes komemorative, po ashtu në mjediset e Akademisë vazhduan homazhet.

Akademik Latif Susuri u varros në vendin e tij të lindjes, në Zhur. Fjalën mortore në emër të ASHAK, e mbajti akademik Feriz Krasniqi.



AKADEMIK REXHEP ISMAJLI QËNDRON NË VJENË-AUSTRI

Më 18-19 prill 2016 akademik Ismajli ka qëndruar në Vjenë. Ai me këtë rast ka marrë pjesë në Kuvendin vjetor të ALLEA-s që u mbajt në mjediset Akademisë Austriake të Shkencave.

Ai me këtë rast mori pjesë edhe në ndarjen e çmimit Madame de Staël dhe në simpoziumin mbi liritë e hulumtimit shkencor.

NDAHET “SHPËRBLIMI MBËSHTETËS 2016”

Më 22 prill 2016, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës ia ndau Shpërblimin mbështetës 2016 kandidatës të moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës, dr. Dafina Bytyqi.

Në ndarjen e çmimit foli akademik Hivzi Islami, Kryetar i Akademisë, i cili ndër të tjera tha:

“Të nderuar kolegë dhe miq, anëtarë të Akademisë, njerëz të shkencës, të botës akademike dhe të kulturës, e nderuara laureate e vitit kaluar, dr. Pranvera Ibrahim (laureati i parë dr. Qëndrim Gashi, gjendet në Gjermani për qëllime studimore), jemi tubuar sot në mjediset e Akademisë për ta shpallur çmimin e themeluar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, i emërtuar “Shpërblimi mbështetës”, që u jepet kandidatëve të moshës së re që kanë arritur rezultate të veçanta në fushën e shkencës dhe të artit. Ky çmim, që ka filluar të jepet nga viti 2014, tashmë është bërë tradicional. Fondi për këtë shpërblim është krijuar nga donacionet dhe vlera e tij është 3.000 euro.



Kandidati i parë që e mori këtë çmim për rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës, konkretisht të shkencës së matematikës, ishte prof. Dr. Qëndrim Gashi, ndërkaq kandidatja e dytë që u laureua me këtë çmim për rezultate të larta në fushën e shkencës së mjekësisë vitin e kaluar ishte dr. Pranvera Ibrahim. Donacion i parë erdhi nga kompania Ing Office, Sh. P. K., Gjilan, ndërsa donacioni i dytë nga kompania "Marigona Residence".

Në bazë të konkursit publik të rishpallur më 4 mars 2016, u paraqitën 13 kandidatë nga fusha të ndryshme të shkencave. Nuk kishte asnjë kandidatë nga sfera e arteve. Kryesia në mbledhjen e vet të mbajtur më 19 prill 2016 ka caktuar Komisionin vlerësues në përbërje: kryetari i Akademisë Hivzi Islami, akademik Feriz Krasniqi dhe anët. korresp. dr. Jusuf Bajraktari. Komisioni pasi e shqyrtoi dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur dhe në përputhje me kushtet e kërkuara me konkurs, përzgjedhi për laureate të çmimit "Shpërblimi mbështetës 2016" dr. Dafina Bytyçin, mjeke, hulumtuese në fushën e mjekësisë, e cila, pas përfundimit me sukses të shkollës doktrale trevjeçare në Lyon të Francës, u kurorëzua me doktoratën në temën "Doktor në Biomekanikë" (Docteur en Biomécanique, Université de Lyon 1). Sot është specializante në QKUK, në Klinikën e Ortopedisë dhe të Traumatologjisë.

Vlera materiale e shpërblimit, që nuk është e vogël për llojin e shpërblimit dhe rrethanat tona, është donacion, sikurse edhe vitin e kaluar, që vjen nga

kompania "Marigona Residence", me përfaqësuesit Erolld Belegu, Rasim Merlaku dhe Valton Bilalli dhe në emër të Akademisë i falënderoj shumë. Kjo kompani ka shprehur mirësinë të ofrojë mjete për shpërblimin mbështetës edhe për vitin 2017. Tri herë faleminderit!

Shpërblimi që i jepet sot dr. Dafina Bytyçit konsiderojmë se është një simbolikë e fortë për arsye se Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës si institucioni më i lartë i shkencës dhe i artit në Kosovë, ia njeh punën dhe meritat një të reje, pa i mbushur të 30-tat, për arritjet e saj në fushën e shkencës dhe të hulumtimit. Natyrisht, për shkak të moshës së re, nga kandidatja nuk janë pritur rezultate kulmore shkencore-hulumtuese. Ato rezultate tek pritet të arrihen në të ardhmen dhe qëllimi ynë më i rëndësishëm është që të mbështetet dhe të motivohet doktoresha për punë të mëtutjeshme produktive në shkencë, në këtë rast në shkencën e mjekësisë. Në qoftë se me këtë shpërblim arrihet një shtytje e cila sadopak do t'i shërbejë laureates si një kurajë për ecje përpara në profesion dhe në hulumtime shkencore, atëherë mendojmë se është përmbushur objektivi ynë.

Ky çmim është një privilegj edhe për Akademinë që iu dha mundësia, në sajë të donacionit në fjalë, ta shpërblejë një kandidate të kësaj moshe, me këto cilësi si garanci se do të zhvillohet në një shkencëtare dhe hulumtuese të mirëfilltë. Edhe vitin e kaluar, siç u zotua në gojë, Akademia me këtë çmim laureoi një femër të re që po shënon rezultate gjithnjë e më solide në

shkencat e mjekësisë; dr. Pranvera Ibrahim, në fund të vitit 2015, pas marrjes së çmimit, mbrojti doktoratën e shkencave në Suedi.

Do të mbetet i përhershëm synimi i Akademisë që në kushte të barabarta të shpërblehen femrat. Duket se mirëkuptimi te donatorët nuk do të mungojë. Numri i Majlindave dhe shpërthimet e saj në kontinentin plak, nesër edhe në rrafshin global, me valëvitjen e flamurit të shtetit më të ri në botë, presim të rritet edhe në fushat e tjera, në radhë të parë të shkencave dhe të arteve, dhe pikërisht nga femrat e reja.

Edhe në rastin e pranimit të anëtarëve të rinj të Akademisë, që nuk po shkon lehtë në propozime dhe votime kur është fjala për femrat, sikurse në të gjitha akademitë e tjera, këtë fakt do ta kemi parasysh, aq më tepër që në vitet e fundit femrat po imponohen me rezultate të rëndësishme në të gjitha fushat e shkencave dhe të arteve. Është kjo edhe një porosi e ALLEA-s (All European Academies - Federata e Akademive Nacionale të Evropës).

Raportin vlerësues për punën dhe rezultatet e arritura të dr. Dafina Bytyqit në shkencën e mjekësisë, në emër të Komisionit do ta paraqesë akademik Feriz Krasniqi, anëtar i Komisionit”.

Pas fjalës së Kryetarit, akademik Feriz Krasniqi paraqiti arsyetimin e ndarjes së Shpërblimit mbështetës 2016. Ai ndër të tjera theksoi:

“Komisioni i caktuar nga Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, që të vlerësojë

kandidatët që kanë marrë pjesë në konkursin “SHPËRBLIMI MBËSHTETËS 2016”, për kandidatin e moshës së re që ka arritur rezultate të rëndësishme në fushën e shkencës dhe të artit shqyrtoi dhe vlerësoi veç e veç dokumentacionin e prezantuar të kandidatëve të paraqitur në Konkursin e shpallur nga ASHAK, dhe vendosi njëzëri, që Shpërblimi mbështetës 2016 t’i ndahet kandidates nga fusha e mjekësisë, dokoreshës së shkencës biomekanike Dafina Bytyqi.

Disa të dhëna, shkurt, për kandidaten: Dafina Bytyqi lindi në Prishtinë, më 27 maj 1986. Shkollën fillore dhe të mesme, e kreu në Prishtinë, me notë mesatare maksimale 5. Studimet universitare në mjekësinë e përgjithshme, i përfundoi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës, në korrik të 2010-tës, me notë mesatare 9.65, kurse shkollën doktorale trevjeçare e përfundoi më 2015 në “Universitetin Lion 1” në Lion të Francës dhe mori gradën doktor shkence në biomekanikë. U doktorua në moshën 28 vjeçare dhe si e tillë konsiderohet kandidatja më e re me titullin doktor shkencë në Universitetin e Prishtinës në fushën e mjekësisë. Ishte studente e dalluar e Universitetit të Prishtinës dhe pjesëmarrje në shumë projekteve shkencore-hulumtuese, rezultatet e të cilave i prezantoi në takimet dhe konferencat profesionale të kirurgjisë ortopedike në vend. Botoi një varg punimesh si autore dhe bashkautore, në revistat e njohura shkencore me faktor të lartë të ndikimit shkencor (impakt faktor).

Pas përfundimit të fakultetit, gjatë viteve 2010 – 2011, u angazhua asistente hulumtuese në Fondacionin e shëndetit të nënës dhe foshnjës, dhe asistente në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës në lëndën Fiziologji Patologjike ku gjendet edhe tani. Krahas specializimit në kirurgji ortopedike, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, ajo bëri praktikë klinike në kirurgji të gjurit nga 6 muaj në vjet, prej 2011-2015, në qendrën e ekselencës në Albert Trillat në Lion të Francës tek prof. Philippe Neyret.

Gjatë viteve 2008-2010, Dafina Bytyqi ishte vizitore shkencore dhe pjesëmarrëse në shumë trajnime e ligjërata në klinika të ndryshme universitare: në Universitetin e Manheim-it, në Universitetin e Vjenës, në Hannover, SHBA, ku bëri praktikë klinike, kryesisht në kirurgji të përgjithshme.

Kështu kandidatja Dafina Bytyqi ka bërë një punë solide profesionale e shkencore, në klinikat universitare në vend dhe jashtë tij, krahas ortopedëve të njohur vendorë e botërorë. Punimet e saja shkencore kryesisht janë nga fusha e ortopedisë.

Kandidatja Dafina Bytyqi edhe pse e moshës së re, në maj feston ditëlindjen e 30të, ka rezultate të dukshme profesionale dhe shkencore duke afirmuar punën profesionale dhe shkencore të vendit tonë në suaza ndërkombëtare.

Ajo është autore ose bashkëautore e një varg punimesh që janë rezultat i punës së palodhshme të saj, rezultate të cilat ajo i ka prezantuar në takime profesionale e shkencore në tubime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Kandidates Dafina Bytyqi bazuar në rezultatet dhe meritat e saj iu dhanë disa shpërblime përkatësisht iu ndan:

1. Vendi i parë në KISCOMS në 2008ën,
2. Studente e dalluar e Universitetit të Prishtinës në 2010ën,
3. Bursa për studime të doktoratës e Qeverisë franceze në 2011ën, dhe
4. Çmimi për Fellowship nga EFORT në 2013-ën.

Mbështetur nga këto që u thanë më lartë, Komisioni ka kënaqësi të veçantë t'ia ndajë "Shpërblimin mbështetës 2016" dr. Dafina Bytyqit, specializante dhe doktor shkencë në biomekanikë, si mirënjohje për kontributin e saj në profesion dhe shkencë si një shtytje për punën e saj të mëtejme shkencore dhe profesionale.

Në Prishtinë, më 22 prill 2016.

Anëtarët e Komisionit:

1. Akademik Hivzi Islami
2. Akademik Feriz Krasniqi
3. Akademik Jusuf Bajraktari"

TRYEZË SHKENCORE "TRASHËGIMIA KULTURORE E KOSOVËS SOT"

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Këshilli për Trashëgimi, më 13 maj organizoi tryezën shkencore "Trashëgimia kulturore e Kosovës sot". Në Tryezë përveç fjalës së hapjes, kontributet e tyre i prezantuan nëntë referues, të cilët folën për gjendjen e përgjithshme të trashëgimisë kulturore në nivel të Republikës së Kosovës; për çështjet e legjislacionit dhe administrimit në trashëgimi; për kategoritë e trashëgimisë arkitekturore dhe kishat mesjetare nga aspekti arkeologjik; për trashëgiminë në artin muzikor, pamor, në teatër dhe film. Tryeza solli risi në

trajtimin e kaheve antropologjike të trashëgimisë shpirtërore të simbiozës mes trashëgimisë natyrore dhe kulturore si dhe për zhvillimin e turizmit mbështetur në trashëgiminë arkeologjike.

**AKADEMIK NEXHAT DACI MERR
PJESË NË “7th DANUBE ACADEMIES
CONFERENCE (DAC)**

Më 11-14 maj 2016, akademik Daci ka përfaqësuar ASHAK në konferencën e akademive të Danubit, në Lubjanë. Ai ka prezantuar punimin me titull: “The removal of heavy metal lous form natural water by low cost; Adsorbens: maize cobs, olive pit, wheat bran, coffee wastes, coal ash and bentonite”. Konferenca është organizuar nga Akademia Evropiane e Shkencave dhe e Arteve dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Sllovenisë.

**PËRFAQËSUES NGA ASHAK MARRIN
PJESË NË KONFERENCËN “SHEKULLI I
KADARESË”**

Më 13-14 maj 2016 në Tiranë dhe në Gjirokastrë u shënuar 80-vjetori i lindjes së shkrimtarit Ismail Kadare, anëtar i jashtë i ASHAK. Aktiviteti u përgatit dhe u zhvillua nën siglën e dy akademive, i paraparë në Protokollin e bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH.

Nga Akademia jonë në shënimin e aktivitetit në fjalë morën pjesë akademikët Ali Aliu, Eqrem Basha dhe Mehmet Kraja. Akademik Kraja paraqiti kumtesën me titull: “Ismail Kadare dhe Kosova”.

**AKADEMIK REXHEP ISMAJLI
QËNDRON NË VJENË**

Më 22 prill-21 maj 2016, akademik Ismajli ka qëndruar në Vjenë për hulumtime në arkivat e Akademisë së Shkencave të Austrisë, në bibliotekat e instituteve të Universitetit të Vjenës dhe në Bibliotekën kombëtare. Qëndrimi është realizuar përmes programit të shkëmbimit me Akademinë Austriake dhe me mbështetjen e kësaj Akademie.

**AKADEMIK EQREM BASHA MERR
PJESË NË MANIFESTIMIN “FEIERLICHE
SITZUNG 2016”**

Me ftesë të Akademisë së Shkencave të Austrisë, më 19-22 maj, akademik Basha mori pjesë në manifestimin “Feierliche Sitzung 2016” në Vjenë.

Ky manifestim organizohet çdo vjet nga Akademia e Shkencave të Austrisë dhe në të ftohen akademikët të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë Austriake.

**AKADEMIK NEXHAT DACI QËNDRON
NË VJENË**

Më 22-24 maj 2016 akademik Daci ka përfaqësuar ASHAK në konferencën: “Western Balkans Process, 2 th Join Science Conference”, në Vjenë-Austri. Ai ka qenë aktiv gjatë punimeve të konferencës duke dhënë kontribut të theksuar në qëndrimet përfundimtare të saj.

**TAKIM PUNE NË AKADEMINË E
SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË
MAQEDONISË**

Akademikët Nexhat Daci, Isuf Krasniqi dhe Fejzullah Krasniqi qëndruan më 28

qershor 2016, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë. Ata me këtë rast zhvilluan takim pune për mundësitë e bashkëpunimit në projekte me interes të përbashkët: mjedisi, resurset natyror dhe energjetika. Takimi u zhvillua në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy akademive.

ASHAK SHPALL ZGJEDHJET PËR ANËTARË TË RI TË SAJ

Kryesia e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 gusht 2016, vendosi të shpallë zgjedhjet për anëtarë të saj, më 1 shtator 2016 dhe miratoi Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë.

Qarkorja do t'u dërgohet të gjitha këshillave të fakulteteve të universiteteve publike dhe këshillave shkencorë të instituteve shkencore që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

MBAHET KONFERENCA SHKENCORE: NDRE MJEDA -15 VJETORI I LINDJES

Më 15 shtator Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i ASHAK Konferencë shkencore. Përvjetori i lindjes së poetit, klerikut, gjuhëtarit dhe studiuesit Ndre Mjeda (20 nëntor 1866 - 1 gusht 1937) u shënua në ambientet e ASHAK-ut në Prishtinë me një konferencë shkencore organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si pjesë e Protokollit për bashkëpunim midis tyre. Konferenca u mbajt me 15 shtator 2016 dhe në të u paraqitën me kumtesa 18 pjesëmarrës

nga Kosova dhe Shqipëria, sa ishin paraparë me program dhe ishin ftuar. Njëkohësisht u mblodhën të gjithë kontributet e pjesëmarrësve dhe u finalizuan për botim. Konferenca solli kontribute të reja në ndriçimin e personalitetit të Mjedjes, krijimtarisë së tij poetike, studimeve letrare e gjuhësore, shkrimeve fetare, etj.

MBLEDHJE KOMEMORATIVE PËR MAESTRON GJELOSH GJOKAJ

Më 28 shtator 2016, në orën 12:00, në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, u mbajt mbledhja komemorative në nderim të anëtarit të jashtëm të Akademisë, maestros Gjelosh Gjokaj.

Maestro Gjelosh Gjokaj vdiq në Gjermani më 25 shtator 2016.



Për veprën dhe figurën e maestros Gjelosh Gjokaj foli kryetari i Akademisë, akademik Hivzi Islami dhe anëtari korrespondent i Akademisë Luan Mulliqi. Që të dy e vlerësuan lartë veprimtarinë e Gjokajt.

Në shenjë kujtimi dhe respekti për maestron Gjelosh Gjokaj në mjediset e Akademisë u hap edhe libri i zisë.

Maestro Gjokaj u varros në Tuz të Republikës së Malit të Zi, më 1 tetor 2016. Nga ASHAK në ceremoninë e varrimit morën pjesë akademik Rexhep Ferri dhe anëtar korrespondent Luan Mulliqi, i cili mbajti edhe një fjalim mortor në emër të Akademisë.

EKSPOZITË INAUGURUESE E SKULPTORIT LUAN MULLIQI, ANËTAR KORRESPONDENT

Më 17 tetor 2016, në galerinë e Akademisë u hap ekspozita inauguruese e anëtarit korrespondent Luan Mulliqi. Ekspozita përfshiu 40 vepra skulpturore të realizuara në materiale të ndryshme: bronz, dru, mermer etj. Koncepti artistik i ekspozitës është frymëzuar nga trashëgimia jonë kulturore.



AKADEMIK REXHEP ISMALI VIZITË ZYRTARE NË AKADEMINË E SHKENCAVE TË AUSTRISË

Më 26-30 shtator 2016, akademik Rexhep Ismaili me ftesë të Akademisë së Shkencave të Austrisë qëndroi në Vjenë. Përveç takimeve në Akademinë Austriake, ai realizoi edhe vizita pune në Institutin e Gjuhësisë, në Institutin e Studimeve të Evropës Juglindore dhe në Institutin e Romanistikës.

Në hapjen e ekspozitës, përveç anëtarëve të Akademisë morën pjesë personalitete nga fusha e arteve dhe mysafirë të shumtë.

Ekspozita qëndroi e hapur për gati një muaj dhe pati vizitorë të shumtë.

KONCERT I PËRBASHKËT VEPRASH KAMERALE –MUZIKË DHOME

Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në kuadër të Proto-

kollit të bashkëpunimit 2015-2017, organizuan Koncert të përbashkët veprash kamerale-muzikë dhome. Koncerti u mbajt më 18 tetor 2016, në Tiranë, ku morën pjesë shumë personalitete dhe adhurues të muzikës.

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT MIDIS AKADEMISË SË MBISHKRIMEVE DHE TË LETËRSISË TË FRANCËS DHE ASHAK

Më 14 nëntor 2016, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Mbishkrimeve dhe e Letërsisë të Francës, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit.

Marrëveshja u nënshkrua në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nga Kryetari i ASHAK-ut,

Akademik Hivzi Islami dhe Sekretari permanent i Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë të Francës, Michel Zink. Fjalën e hapjes e mbajti Kryetari i Akademisë, nga e cila veçojmë:

“Të nderuar kolegë dhe miq,

Pas ceremonisë së nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy akademive, përfaqësuesi i Akademisë së Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), Sekretari permanent, prof. Michel Zink, do të mbajë një ligjëratë. Para ligjëratës, më lejoni që ta paraqes një tablo të shkurtër të biografisë dhe të punës së tij akademike, shkencore-hulumtuese dhe krijuese.

Prof. Zink, filolog dhe medievist, lindi



në vitin 1945 në Issy-lesMoulineaux, afër Parisit. Është specialist i filologjisë dhe letërsisë mesjetare të Francës, të shekujve XII-XV, i filologjisë dhe i letërsisë religjioze, i historiografisë dhe historisë së përgjithshme të letërsisë frënge të Mesjetës.

Pasi i kreu studimet në École Normale supérieure më 1968, në vitet 1976-1987 ishte profesor në Universitetin e Toulouse-it II-Le Mirail, pastaj në vitet 1987-1994 në Universitetin e Sorbonës IV. Nga viti 1995 ligjëron në Collège de France letërsinë mesjetare franceze. Prof. Zink gjithashtu ka ligjëruar në disa universitete prestigjioze jashtë Francës, si në Yale, Berkley të Kalifornisë, në Arizona, Pensilvania, Çikago, në Sapienca të Romës, në Stanford Univesity, në Universitetin e Czirhut etj.

Në edicionin Livres de poche (Librat e xhepit) drejton koleksionin Letërsia gotike, si dhe drejton revistën Romania që merret me gjuhët dhe letërsinë romane.

Në vitin 2000 u zgjodh anëtar i Akademisë Frënge të Mbishkrimeve dhe të Letërsisë (Académie des Inscriptions et Belles-Lettres), e themeluar në vitin 1663 nga Luigji XIV. Në vitin 2011 ishte kryetar i kësaj Akademie, ndërsa sot është sekretar permanent i saj. Nga viti 1996 është dhe anëtar i Akademisë Amerikane të Arteve dhe të Shkencave.

Bibliografia e tij është shumë e gjerë. Janë dhjetëra e dhjetëra botime nga fushat e interesimit të tij shkencor e letrar, filologjia, letërsia mesjetare frënge, studime, interpretime, komente, analiza, çka e bën atë njërin

nga ekspertët më të shquar frënge në këto fusha.

Për rezultatet në punën e tij mori disa shpërblime e dekorata, sikurse “Komandor i Urdhrit të Palmave Akademike” (“Commandeur dans l’Ordre de Palmes Académiques”), “Kalorës i Legjionit të Nderit” (“Chevalier de la Legion d’Honneur”), çmimin e “Asociacionit të Studimeve Franceze” (“Association des Études Françaises”) etj. Pas fjalës së Kryetarit akademik Michel Zink, mbajti ligjëratën.

TRYEZË SHKENCORE: 100-VJET NGA VRASJA E ISA BOLETINIT



Më 25 nëntor 2016, në bazë të Protokollit të bashkëpunimit midis ASHAK dhe ASHSH, në mjediset e Akademisë sonë u mbajt tryeza shkencore 100-vjet nga vrasja e Isa Boletinit. Tryeza u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore, përkatësisht Këshilli Organizues. Fjalën e hapjes e mbajti Anton K. Berishaj, ndërsa me kumtesa u paraqiten tetë referues të cilët elaboruan fakte dhe të dhëna historike për veprimtarinë politike e luftarake të kësaj figure të veçantë të historisë tonë kombëtare. Tryeza shqyrtoi aspekte nga jeta dhe

vepra e Isa Boletinit; vendin që zë ai në historinë kombëtare; për rolin e tij në kryengritjen e vitit 1912; për kontributin e tij për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë; për vlerësimet dhe trajtimin e tij në dokumentet arkivore të kohës; për prezencën e tij në tekstet mësimore dhe për shumë aspekte tjera që lidhen me emrin e Isa Boletinit. Pas kumtesave u bënë diskutime të frytshme lidhur me temën bosht, ndërsa në fjalën e mbylljes kryetari i K. Organizues i falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre dhe kërkoi nga ata që kumtesat ti dërgojnë për botim.

TRYEZË SHKENCORE: ESAD MEKULI NË 100-VJETORIN E LINDJES

Përvjetori i poetit, përkthyesit, botuesit dhe kryetarit të parë të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Esad Mekuli (17 dhjetor 1916 – 6 gusht 1993), u shënua me një tryezë shkencore. Tryeza u mbajt më 6 dhjetor 2016 në mjediset e ASHAK-ut. Këshilli organizues: Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe Eqrem Basha kishin ftuar 12 pjesëmarrës, studiues, kritikë letrarë, njohës të veprës së Mekulit, nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Morën pjesë 11 prej tyre. Tryeza u konsiderua e suksesshme. Kumtesat e paraqitura në tryezë do të publikohen në numrin vijues të revistës “Studime”.

TAKIMI PËR FJALORIN ENCIKLOPEDIK
Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, përkatësisht Redaksia Qendrore e FEK-ut ka organizuar Takim pune për Fjalorin Enciklopedik të

Kosovës, në Durrës nga 8-11 dhjetor 2016.

Në takim kanë marrë pjesë: Redaksia Qendrore e Fjalorit dhe redaktorët e fushave përkatëse të FEK-ut, me përjashtim të ndonjë zëvendësimi të tyre nga një anëtar i redaksisë përkatëse.

Takimi është realizuar sipas programit të paraparë.

U MBAJT TRYEZA SHKENCORE PËR MIGRIMET



Në mjediset e ASHAK, më 15 dhjetor 2016 u mbajt tryeza shkencore për migrimet Përveç fjalës së hapjes, mbajtur nga akademik Anton K. Berishaj, kryetari i Këshillit organizativ, tetë referues prezantuan rezultatet e tyre lidhur me këto çështje: faktorët në migrimet e jashtme; aspekte etnografike të migrimit të brendshëm; rolin e diasporës shqiptare në Kosovë; analizën gjeografike të zonave migruese në regjion; migrimet e popullsisë kosovare dhe asaj të Luginës së Preshevës si dhe probleme tjera interesante nga kjo fushëveprimtari. Pas kumtesave pati edhe diskutime të frytshme për temën bosht. Kryetari i Këshillit organizativ, në mbyllje të

tryezës e cilësoi temën e trajtuar me interes të veçantë dhe mjaft të suksesshme. Ai kërkoi nga pjesëmarrësit që t'i përgatisin dhe t'i dërgojnë kumtesat e tyre për botim.

MBAHET KUVENDI ZGJEDHOR I ASHAK PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË RINJ

Më 21 dhjetor 2016 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës mbajti Kuvendin e saj zgjedhor dhe zgjodhi anëtarët e rinj të Akademisë:

Anëtarë të rregullt (akademik):

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Zejnullah RRAHMANI

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Anton K. BERISHAJ

2. Jusuf BAJRAKTARI

Anëtarë korrespondentë:

I. Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë:

1. Bardh RUGOVA

2. Kujtim SHALA

II. Seksioni i Shkencave Shoqërore:

1. Frashër DEMAJ

2. Gjyljeta MUSHKOLAJ

3. Justina PULA

4. Muhamedin KULLASHI

III. Seksioni i Shkencave të Natyrës:

1. Fetah PODVORICA

2. Myzaferë LIMANI

Anëtarë të jashtëm:

1. Bahri BECI

2. Kristaq PRIFTI

3. Matteo MANDALA

4. Mentor PETRELA



VJETARI

2016

Botues

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Mr. Shefqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 7.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 16x24 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup